

**STRATEGJIA
NDËRSEKTORIALE
E REFORMËS NË
ADMINISTRATËN
PUBLIKE**

2024-2030

Falenderime

Strategjia Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike është hartuar nën drejtimin e Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, me punën teknike të Departamentit të Administratës Publike. Kjo Strategji reflekton vizionin ambicioz të Qeverisë Shqiptare për reformimin e thellë dhe transformativ të administratës publike shqiptare, në përputhje me standardet dhe praktikatat më të mira evropiane dhe ndërkombëtare. Në rrugën historike të Shqipërisë drejt Bashkimit Evropian, ne jemi palëkundshmërisht të angazhuar për ta fuqizuar dhe shndërruar administratën publike në një motor të zhvillimit të qëndrueshëm dhe në një shërbyes efikas dhe të përgjegjshëm ndaj qytetarëve, duke garantuar një hap të sigurt për integrimin e Shqipërisë në BE.

Në kuadër të procesit të negociatave për anëtarësimin në Bashkimin Evropian, Shqipëria ka hapur negociatat për dy grupe Kapitujsh kyçë, Grupkapitujt I “Themeloret” dhe Grupkapitujt IV “Politika e Jashtme. Reforma e Administratës Publike është thelbësore për arritjen e qëllimeve të këtyre kapitujve dhe për përafrimin e Shqipërisë me standardet e BE-së. Qeveria Shqiptare mbetet e vendosur për ta udhëhequr këtë reformë dhe për të siguruar që administrata publike të jetë një pasqyrë e suksesit të Shqipërisë drejt mishërimit në rritje të standardeve evropiane. Paketa strategjike e garanton përputhjen me këto standarde duke qenë plotësisht e harmonizuar me Udhërrëfyesin për Reformën në Administratën Publike 2023-2030, si dhe me gjetjet dhe rekomandimet e Raportit të fundit të Vlerësimit të vitit 2024 nga OECD/SIGMA, si partneri më reputativ i Shqipërisë në avancimin e kësaj reforme.

Strategjia është finalizuar falë një bashkëpunimi të ngushtë me të gjithë aktorët përkatës, falënderimi i të cilëve është me rëndësi të veçantë, veçanërisht për ekspertizën dhe angazhimin e tyre për të ndihmuar në planifikimin e detajuar të ndërtimit të një administrate publike të përgatitur për sfidat bashkëkohore. Ky dokument nuk është thjesht një plan, por një angazhim i fortë dhe një parakusht për të realizuar vizionin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian në vitin 2030, si një vend ku administrata publike udhëheq me shembull agjendën transformuese të vendit.

Një falënderim i veçantë shkon për Shkollën Rajonale të Administratës Publike (ReSPA) për ofrimin e ekspertizës dhe mbështetjes në hartimin e draftit të parë të strategjisë, duke ofruar një platformë profesionale për asistencë të avancuar dhe shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira në punën e përditshme për avancimin e Reformës në Administratën Publike.

Gjithashtu, mirënjohja shkon edhe për mbështetjen e Projektit “BE për Mirëqeverisjen” (EU4Good Governance), i financuar nga fondet IPA 2020. Ky projekt ka siguruar një mbështetje të fortë në pasurimin e draftit të dokumentit dhe kostimin e paketës strategjike, duke garantuar që çdo hap të jetë në përputhje me normat më të larta evropiane.

Megjithatë, përgjegjësia kryesore dhe pronësia e qëndrueshme dhe afatgjatë e rezultateve të këtij procesi qëndron tek Qeveria Shqiptare dhe, më gjerë, tek të gjitha institucionet e angazhuara për zbatimin e kësaj strategjie. Me këtë plan të qartë dhe me angazhimin e të gjithë aktorëve të përfshirë, mbetemi besimplotë se do të arrijmë të konsolidojmë një administratë publike që u shërben denjësisht qytetarëve dhe që është plotësisht e përgatitur për sfidat e ardhshme të integritimit në Bashkimin Evropian.

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin

Adea Pirdeni

Tabela e përmbajtjes

Lista e shkurtimeve	4
PJESA I	
1. Hyrja dhe qëllimi i Strategjisë	6
1.1 Fusha dhe qëllimi i Strategjisë.....	6
1.2 Procesi i Hartimit të Strategjisë Ndërsektoriale të RAP	7
1.3 Struktura e Strategjisë Ndërsektoriale të RAP.....	8
1.4 Korniza ligjore dhe institucionale e reformës së administratës publike	9
1.5 Ndërlidhja me Kornizën Strategjike Kombëtare për Zhvillimin, Integrimin Evropian, Reformat Ekonomike dhe Qeverisjen e Mirë	11
2. Konteksti politik dhe strategjik: arritjet dhe sfidat.....	18
2.1 Arritjet dhe sfidat në zhvillimin dhe koordinimin e politikave	19
2.2 Arritjet dhe sfidat në shërbimin civil dhe menaxhimin e burimeve njerëzore.....	23
2.3 Arritjet dhe sfidat në ofrimin e shërbimeve të digjitalizuara	29
2.4 Arritjet dhe sfidat në organizimin, llogaridhënien dhe mbikëqyrjen e administratës.....	32
2.5 Arritjet dhe sfidat drejt një administrate të gjelbër publike	36
3. Vizioni i Strategjisë.....	39
PJESA II	
Qëllimi i Politikës 1 - Zhvillimi dhe Koordinimi i Politikave	41
Qëllimi i Politikës 2: Shërbimi Civil dhe Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	53
Qëllimi i Politikës 3: Ofrimi i Shërbimeve dhe Digjitalizimi	68
Qëllimi i Politikës 4: Organizimi, llogaridhënia dhe mbikëqyrja e administratës	73
Qëllimi i Politikës 4 do të arrihet përmes këtyre Objektivave Specifikë:	73
Qëllimi i Politikës 5: Administrata e gjelbër.....	86
4. Zbatimi, Llogaridhënia, Monitorimi dhe Analiza	91
5. Financimi i Strategjisë	92

Lista e shkurtimeve

AKR	Agjenda Kombëtare e Reformave
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
BE	Bashkimi Evropian
BNJ	Burimet Njerëzore
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DPP	Dokumenti i Politikave Prioritare
GMIP	Grupi i Menaxhimit të Integruar të Politikave
INSTAT	Instituti i Statistikave
IPA	Instrumenti i Asistencës së Para-Aderimit
KE	Komisioni Evropian
KM	Këshillit të Ministrave
KPS	Komiteti i Planifikimit Strategjik
LDI	Ligji për të drejtën e informimit
MBNJ	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
MD	Ministria e Drejtësisë
MSSKB	Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit
MF	Ministria e Financave
ML	Ministri Linje
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
NC	Nëpunës Civil
NJVQV	Njësia e Vetëqeverisjes Vendore
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OSHC	Organizata të Shoqërive Civile
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PKABE	Programi Kombëtar për Aderimin në Bashkimin Evropian
PKIE	Programi Kombëtar i Integritimit Evropian
PSZ	Programi i Statistikave Zyrtare 2022–2026
PPAP	Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve
PRE	Programi i Reformës Ekonomike
QSH	Qeveria e Shqipërisë
RAP	Reforma e Administratës Publike
RIA	Vlerësimi i Ndikimit Rregullator (VNR)
RQP	Regjistri Qendror i Personelit
SASPAC	Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës
SIMBNJ	Sistemi i Informativ i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
SIMFSH	Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar Shqiptar
SKZHIE	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian
SIPI/IPSIS	Sistemi Informatik i Planifikimit të Integruar
SNRAP	Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike

SPI	Sistemi i Planifikimit të Integruar
SQDNE	Sistemi i Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik
TI	Teknologjia e Informacionit
TND	Trupa e Nivelit të Lartë Drejtues
VNR	Vlerësimi i Ndikimit Rregullator (RIA)
VNT	Vlerësim i Nevojave për Trajnim

PJESA I

1. Hyrja dhe qëllimi i Strategjisë

1.1 Fusha dhe qëllimi i Strategjisë

Reforma në Administratën Publike (RAP) është një ndër prioritet kryesore të Qeverisë Shqiptare për jetëzimin e vizionit të Shqipërisë 2030 si anëtare e Bashkimit Evropian, përmes forcimit të mëtejshëm të të gjithë mekanizmave për një administratë publike eficiente që vepron me profesionalizëm dhe transparencë.

Përgjatë viteve të fundit, Shqipëria ka ndërmarrë disa reforma të thella në fushën e administratës publike, të cilat janë planifikuar dhe monitoruar përmes Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike. Në një këndvështrim rajonal, performanca e përgjithshme e Shqipërisë në këto reforma është vlerësuar si shumë pozitive në krahasim me vendet e tjera të rajonit, sikurse konfirmohet në raportet e fundit të monitorimit të OECD/SIGMA të viteve 2021 dhe 2024, ku Shqipëria konfirmohet si lider në rajon në 32 indikatorë.

Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike 2024-2030 (SNRAP) shërben si korniza strategjike që do të udhëheqë zbatimin e reformave të Qeverisë Shqiptare dhe të gjithë institucioneve të tjera të përfshira për RAP deri në fund të vitit 2030. Kjo reformë është prioritet i qartë kombëtar, në përputhje me qasjen e rivitalizuar të Komisionit Evropian ndaj politikës së zgjerimit. Me metodologjinë e re të zgjerimit, Reforma në Administratën Publike, pjesë e Grupkapitujve “Themeloret”, mbart rëndësi kritike në përparimin e procesit të negociatave, si shtyllë thelbësore për mirëfunksionimin e shtetit dhe si parakusht për avancimin e agjendës evropiane.

Për këtë qëllim parashikimet e Strategjisë Ndërsektoriale të RAP janë linjëzuar plotësisht me vizionin e agjendës kombëtare të integritimit dhe në mënyrë të veçantë, me zotimet e parashtruara në Udhërrëfyesin për Reformën në Administratën Publike 2023-2030. Ky i fundit u miratua nga Qeveria Shqiptare në dhjetor 2023, me qëllim orientimin në drejtimin e duhur të të gjitha politikave që kushtëzojnë integrimin në BE dhe për të nxitur zhvillimin e qendrueshëm të vendit dhe shërben si një gur themeli në përmirësimin e performancës së administratës publike, garantimin e shërbimeve publike të standardizuara, dhe forcimin e llogaridhënies institucionale.¹

Kjo strategji është gjithashtu plotësisht e harmonizuar me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian dhe me strategjitë e tjera brenda kornizës së qeverisjes së mirë. Në përputhje me SKZHIE 2022 - 2030, **qëllimi kryesor i Qeverisë Shqiptare për Reformën në Administratën Publike është adresimi i nevojave të qytetarëve dhe të biznesit, duke ndërtuar dhe konsoliduar një administratë publike të përgjegjshme dhe transparente, që shërben me profesionalizëm dhe efikasitet, ndërsa vendi përparon në rrugën drejt Bashkimit Evropian.**

Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike 2024-2030 është gjithashtu e harmonizuar me Agjendën 2030 dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ). Zbatimi i angazhimeve dhe masave specifike të planifikuara në Strategjinë e RAP 2024-2030 ndikon drejtpërdrejt në arritjen e qëllimeve të përcaktuara në Strategjinë e Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030, përmes fokusit që SNRAP vendos në forcimin e besimit të publikut në sistemin demokratik, përmirësimin në mënyrë të matshme të

¹ Udhërrëfyesi për Reformën në Administratën Publike 2023-2030, miratuar me VKM nr. 737, date 13.12.2023.

performancës së administratës publike dhe rritjen e pjesëmarrjes të qytetarëve dhe grupeve të interesit në procesin politikëbërës. Në këtë drejtim, RAP kontribuon në mënyrë direkte në progresin drejt zbatimit të Agjendës 2030 përmes përmirësimit të transparencës, llogaridhënies dhe efikasitetit të administratës publike në shërbimet ndaj qytetarëve dhe bizneseve si në nivel vendor ashtu edhe kombëtar.

Për të siguruar përmbushjen e prioriteteve në kuadër të integritimit në Bashkimin Evropian, Strategjia shoqërohet nga Plani i Veprimit dhe Pasaporta e Treguesve. Këto instrumente detajojnë hapat për zbatimin e Strategjisë për periudhën afatmesme, si dhe shtrojnë terrenin për miratimin e një Plani të ri Veprimi për periudhën pasuese, duke siguruar që Strategjia të zbatohet në përshtatje të plotë me dinamikat e kohës.

1.2 Procesi i Hartimit të Strategjisë Ndërsektoriale të RAP

Hartimi i Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2024 - 2030 filloi me ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës për hartimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2024 - 2030 dhe Planit të Veprimit, me miratimin e Urdhrit të Kryeministrit Nr. 92, datë 01.08.2023. Ky grup përfshin përfaqësues nga Ministrinë dhe institucionet qendrore, ekspertë të pavarur, përfaqësues të shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare. Përgjatë fazave të ndryshme të procesit, Grupi i Punës ka zhvilluar takime të vazhdueshme me qëllim identifikimin e sfidave dhe adresimin e tyre përmes hartimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit.

Hartimi i Strategjisë është kryer në konsultim të ngushtë me grupet e interesit. Një pjesë e konsiderueshme e konsultimeve është zhvilluar në kuadër të takimeve të Grupit Tematik “Shërbimi Civil dhe Strategjia Ndërsektoriale e PAR”, i cili drejtohet nga Departamenti i Administratës Publike (DAP) dhe përfshin ekspertë nga institucione të ndryshme, shoqëria civile, bota akademike, sektori privat dhe partnerë të tjerë. Gjatë këtyre takimeve, janë diskutuar arritjet e reformës, sfidat institucionale për zbatimin e saj me efikasitet, si dhe zgjidhjet për adresimin e tyre. Një takim i dedikuar u zhvillua edhe në bashkëpunim me OECD/SIGMA-n në maj 2023 për konsultimin përgatitor për hartimin e Strategjisë së RAP, me qëllimin për të garantuar adresimin e sfidave dhe rekomandimeve të evidentuara në Raportin e Monitorimit të SIGMA-s për kapacitetet dhe performancën e administratës publike të Shqipërisë për vitin 2021.

Hartimi i Strategjisë Ndërsektoriale ka kaluar nëpër një analizë të thellë të arritjeve të reformës kundrejt rezultateve të synuara, duke u mbështetur në gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e:

- Raporteve 6-mujore dhe vjetore të Monitorimit për nivelin e zbatimit të Planit të Veprimit dhe arritjen e synimeve dhe rezultateve të planifikuara të Strategjisë Ndërsektoriale të RAP 2015-2022;
- Raporteve të Monitorimit të OECD/SIGMA për Shqipërinë për vitet 2021 dhe 2024;
- Raporteve më të gjera vlerësuese të progresit të reformës në administratën publike, si Raporti i Komisionit Evropian (KE) për Shqipërinë për vitin 2023 dhe Raporti i Komisionit Evropian hartuar në përfundim të procesit të Shqyrtimit Analitik (*Screening*) për Grupkapitujt I “Themeloret” publikuar në 24 korrik 2023,

si dhe

- dokumenteve të tjera relevante që trajtojnë fushat e ndërhyrjes në kuadër të reformës së administratës publike.

Në fillim të vitit 2024, përmes VKM Nr. 29, datë 17.1.2024, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësishë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin”, Qeveria Shqiptare miratoi krijimin e një pozicioni të ri ministror me përgjegjësinë për udhëheqjen e reformës në administratën publike, bashkërisht me kompetencën për garantimin e zbatimit të parimeve të qeverisjes së mirë. Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin udhëhoqi punën për finalizimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës së Administratës Publike 2024–2030 dhe procesin e konsultimit publik të paketës së finalizuar strategjike.

1.3 Struktura e Strategjisë Ndërsektoriale të RAP

Struktura e Strategjisë Ndërsektoriale të RAP është hartuar në përputhje me Kuadrin Strukturor për Hartimin e Strategjive Sektoriale/Strategjive Ndërsektoriale në Përputhje me Standardet e Sistemit IPSIS. Dokumenti është strukturuar në pesë Qëllime të Politikës sektoriale, të cilat pasqyrohen në Objektivat Specifikë të reformës në administratën publike dhe komponentët e përcaktuar në funksion të realizimit të tyre.

Figura 1.1 Struktura e Strategjisë Ndërsektoriale të RAP

Qëllimi i Politikës 1 Zhvillimi dhe koordinimi i politikave	Qëllimi i Politikës 2 Shërbimi civil dhe menaxhimi i burimeve njerëzore	Qëllimi i Politikës 3 Ofrimi i shërbimeve dhe digjitalizimi	Qëllimi i Politikës 4 Organizimi, llogaridhënia dhe mbikëqyrja e administratës	Qëllimi i Politikës 5 Administrata e gjelbër publike
<i>Planifikimi dhe koordinimi efikas i politikave në nivel kombëtar</i>	<i>Pranimi meritokratik, konkurrues dhe transparent në shërbimin civil</i>	<i>Ri-inxhinierimi i shërbimeve dhe thjeshtimi i procedurave administrative</i>	<i>Mirëorganizimi i administratës publike, me institucione që performojnë mbështetur në kritere të qarta organizative dhe në përputhje me kuadrin ligjor ekzistues.</i>	<i>Angazhimi i administratës publike drejt vetëgjelbërimit të veprimitarisë institucionale</i>
<i>Koordinimi efikas i procesit të integritetit evropian</i>	<i>Pozicionimi i administratës publike si një punëdhënësi i besueshëm, tërheqës dhe konkurrues në tregun e punës.</i>	<i>Aftësitë digjitale të shoqërisë së gjerë</i>	<i>Rritja e llogaridhënies së brendshme në administratën publike</i>	<i>Partneriteti për administratën e gjelbër</i>
<i>Ligjbërje dhe politibërje gjithëpërfshirëse dhe transparente, bazuar në të dhëna dhe që garanton përputhje me acquis-në dhe standardet evropiane</i>	<i>Rritja e kapaciteteve të administratës publike</i>		<i>Institucione publike transparente</i>	

Strategjia Ndërsektorale për RAP mbështetet në një analizë të hollësishme për secilin Qëllim të Politikës, të cilat detajohen më tej në një Plan Veprimi me masa konkrete, afate të përcaktuara kohore, përgjegjësi të mirëidentifikuara institucionale dhe sistem të qartë monitorimi me qëllim optimizimin e arritjes së objektivave përmes koordinimit ndërinstitutional efektiv.

1.4 Korniza ligjore dhe institucionale e reformës së administratës publike

Ndër vite, korniza ligjore dhe institucionale e Shqipërisë në reformimin e administratës publike është përmirësuar ndjeshëm. Kjo kornizë gjithëpërfshirëse ka synuar rritjen e qëndrueshmërisë në detyrë të punonjësve të administratës publike, përmes miratimit të procedurave të përshtatshme dhe efikase për menaxhimin e burimeve njerëzore, si dhe nëpërmjet forcimit të kapaciteteve njerëzore përmes programeve të trajnimit të thelluar dhe të vazhdueshëm të nëpunësve të administratës publike qendrore dhe vendore, veçanërisht në fushën e përmirësimit të aftësive menaxhuese dhe drejtuese.

Korniza ligjore për Reformën në Administratën Publike përfshin Kushtetutën, ligjet procedurale, ligjet e organizimit dhe funksionimit të institucioneve, kuadrin rregullator në procesin e hartimit legjislativ, kuadrin ligjor për llogaridhënien dhe krijimin e institucioneve në varësi të Kryeministrit dhe Ministrave, si dhe kornizën ligjore dhe rregulatore për qeverisjen elektronike dhe ofrimin e shërbimeve. Disa prej ligjeve kryesore që përbëjnë kornizën ligjore të reformës në administratën publike renditen si më poshtë:

- **Kodi i Procedurave Administrative**², me miratimin e të cilit është krijuar një kuadër ligjor modern për funksionimin e administratës publike dhe menaxhimin e kërkesave dhe ankesave të qytetarëve dhe bizneseve nga administrata publike si dhe zhvillimin e procedimit administrativ në përputhje me të gjitha standardet e qeverisjes së mirë;
- **Ligji 9000/2003 për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave**³ dhe **VKM 584/2003 për miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave**⁴, të cilët përcaktojnë qartë funksionet kryesore të Qendrës së Qeverisë (CoG), si dhe përcaktojnë rregulla dhe procedura të qarta për proceset vendimmarrëse të Qeverisë;
- **Ligji nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”**⁵, përcakton kornizën e përgjithshme për krijimin, funksionimin dhe ndërtimin e brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore. Në zbatim të këtij ligji, Këshilli i Ministrave ka miratuar si akte nënligjore përkatësisht: (i) VKM Nr. 867, datë 10.12.2014, “Për Procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore”, që ka si synim rregullimin e mënyrës së bashkëpunimit nëpërmjet kërkimit të të dhënave, informacionit, ndihmës së nevojshme, ngritjes së grupeve të përbashkëta të punës për hartimin e strategjive, politikave, akteve dhe krijimit të njësive të përbashkëta për të kryer

² Ligji Nr. 44/2015 datë 30.4.2015, Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë.

³ Ligji 9000/2003 datë dt.30.01.2003, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Ministrave”

⁴ VKM 584/2003 datë 28.08.2003, “Për Miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave”, përditësuar

⁵ Ligji Nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, Miratuar në datën 27.9.2012

detyra administrative ndërmjet institucioneve të administratës shtetërore me qëllim mirëfuzionimin e aparatit dhe veprimtarisë shtetërore, si edhe realizimin e detyrave administrative me shpejtësi, efikasitet dhe besueshmëri; dhe (ii) **VKM nr. 893, datë 17.12.2014**,⁶ të ndryshuar që përcakton rregullat e organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe procedurat për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm. Ndërkohë, janë planifikuar edhe përmirësime të ligjit ekzistues, me objektiv përafrimin me standardet e BE-së.

- **Ligji 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”** dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij, të cilat kanë mundësuar zhvillimin e një shërbimi civil profesional dhe të bazuar në meritë. Kjo kornizë ligjore përcakton në mënyrë të detajuar strukturat përgjegjëse për menaxhimin e shërbimit civil dhe ka krijuar një sistem karriere për nëpunësit e shërbimit civil;
- **Ligji 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”**⁷ dhe Udhëzuesi për Procesin e Konsultimit Publik, miratuar në janar 2021,⁸ të cilët përcaktojnë kriteret dhe procedurat e konsultimit publik për aktet ligjore dhe dokumentat strategjikë;
- **Ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit”**,⁹ i ndryshuar, i cili modernizon kornizën rregullatore kombëtare në këtë fushë. Ligji ndan të njëjtën frymë dhe qasje me Konventën e Këshillit të Europës “Për aksesin në dokumentet zyrtare”, miratuar nga Kuvendi me ligjin 45/2022;
- **Ligji nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”**, i cili parashikon për të drejtën e ripërdorimit të të dhënave të hapura për qëllime fitimi ose jo të dokumenteve që mbahen nga organet e sektorit publik ose sipërmarrjet publike në Republikën e Shqipërisë. Ky ligj i shtoi zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale edhe kompetencën e mbikëqyrjes dhe promovimit të kësaj të drejte duke garantuar një politik të qartë për inkurajimin e disponueshmërisë dhe ripërdorimit të informacionit të sektorit publik për qëllime private dhe tregtare. Në këtë mënyrë, korniza e plotë dhe bashkëkohore ligjore e së drejtës së informimit e rendit Shqipërinë ndër vendet e para në botë që ofrojnë garancitë maksimale për zbatimin praktik të kësaj të drejte;
- **Ligji nr. 107/2021 “Për bashkëqeverisjen”**,¹⁰ i cili rregullon bashkëqeverisjen me qytetarët përmes mekanizmave të posaçëm që synojnë garantimin e gjithëpërfshirjes së tyre në politikëbërje. Përmes këtij ligji përcaktohet mënyra e organizimit dhe funksionimit, si dhe kompetencat e Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje;
- **Ligji nr. 43/2023 “Për qeverisjen elektronike”**¹¹, i cili përcakton të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e autoriteteve publike dhe subjekteve private në lidhje me krijimin, zhvillimin dhe menaxhimin e sistemeve të infrastrukturës së informacionit, standardeve të sigurisë elektronike dhe teknologjisë së informacionit;

⁶ VKM nr. 893, datë 17.12.2014, "Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm", i ndryshuar

⁷ Ligji nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

⁸ Udhëzues për Procesin e Konsultimit Publik, miratuar me Urdhrin e Sekretarit të Përgjithshëm të KM nr. 3, datë 29 janar 2021.

⁹ Ligji nr. 119, datë 18.9.2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar në 2023 me ligjin 78/2023, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” të datës 18 shtator 2023)

¹⁰ Ligji nr. 107/2021, datë 04.11.2021, “Për bashkëqeverisjen”.

¹¹ Ligji nr. 43/2023, datë 15.06.2015, “Për Qeverisjen Elektronike”.

- **Ligji nr. 15/2015, “Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”,¹²** i cili përcakton rregullat për marrëdhëniet e Kuvendit me institucionet e tjera që gëzojnë kompetenca dhe detyrime në procesin e integrimit të Shqipërisë në BE. Ligji ka për qëllim rritjen e rolit të Kuvendit në fazën aktuale dhe në fazat vijuese të procesit të integrimit të vendit në Bashkimin Evropian, duke i dhënë Kuvendit një rol të shtuar në përputhje me frymën e Metodologjisë së re të Zgjerimit.

1.5 Ndërlidhja me Kornizën Strategjike Kombëtare për Zhvillimin, Integrimin Evropian, Reformat Ekonomike dhe Qeverisjen e Mirë

Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike 2024-2030 është zhvilluar në përputhje me kornizat strategjike kombëtare për zhvillimin, integrimin evropian, reformat ekonomike dhe qeverisjen e mirë, të cilat detajohen përkatësisht në dokumentat e mëposhtëm strategjikë:

- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE) 2022-2030;¹³
- Programi Kombëtar për Aderimin në Bashkimin Evropian (PKABE) 2024-2030;
- Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE);
- Dokumenti i Politikës “Agjenda Kombëtare e Reformave (AKR) 2024-2027”;¹⁴
- Programi i Reformës Ekonomike (PRE);
- Udhërrëfyese për Reformën në Administratën Publike 2023-2030;
- Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030;¹⁵
- Strategjia Ndërsektoriale “Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2022-2026” dhe Plani i Veprimit;¹⁶
- Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike 2023-2030 dhe Plani i Veprimit;¹⁷
- Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024 -2030 dhe Plani i Veprimit 2024-2026;¹⁸
- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030;¹⁹
- Plani Kombëtar i Veprimit ‘Partneriteti për Qeverisjen e Hapur (2023-2025)’;
- Agjenda e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030.

Ndërlidhja e SNRAP 2024-2030 me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022 - 2030

Parimet e administratës publike mbështeten nga një kornizë strategjike e konsoliduar e RAP, në kulmin e së cilës qëndron Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE) 2022–2030²⁰.

¹² Ligji nr. 15/2015, datë 05.03.2015, “Për Rolin e Kuvendit në Procesin e Integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 19/2023, datë 16.03.2023.

¹³ Miratuar me VKM Nr. 88, datë 22.2.2023

¹⁴ Miratuar me VKM Nr. 621, datë 10.10.2024

¹⁵ Miratuar me VKM Nr.252, datë 20.4.2023

¹⁶ Miratuar me VKM Nr. 370, datë 1.6.2022

¹⁷ Miratuar me VKM Nr. 390, datë 12.6.2024

¹⁸ Miratuar me VKM Nr. 859, datë 26.12.2024

¹⁹ Miratuar me VKM Nr. 400, datë 30.6.2021

²⁰ Miratuar me VKM nr. 88 datë 22 shkurt 2023

Prioritetet e Reformës në Administratën Publike qëndrojnë në themelet e “Programit Qeverisës 2021-2025”,²¹ SKZHIE dhe dokumenteve të planifikimit horizontal.

SKZHIE 2023 - 2030 përcakton drejtimin e zhvillimit të Shqipërisë deri në vitin 2030 me synim parësor integrimin e plotë në Bashkimin Evropian. Një ndër shtyllat kryesore të SKZHIE është “*Demokracia e fuqizimi i institucioneve dhe qeverisjes së mirë*”. Në seksionin “*Qeverisja e hapur dhe administrimi publik*”, SKZHIE planifikon një objektiv të dedikuar për planifikimin strategjik efektiv dhe politikëbërjen e bazuar në të dhëna, gjithëpërfshirëse dhe transparente në qeverisjen qendrore dhe vendore. Njëherësh, një seri objektivash dhe reformash në fushat e RAP parashtrihen në Strategji, të tilla si rritja e pagave të punonjësve të sektorit publik, dhe digjitalizimi e rritja e transparencës së administratës publike, të cilat janë linjëzuar dhe reflektuar në parashikimet e SNRAP 2024-2030.

Ndërlidhja e SNRAP me Programin Kombëtar për Aderimin në Bashkimin Evropian dhe Planin Kombëtar për Integrimin Evropian

Integrimi Evropian është synimi politik dhe strategjik më i rëndësishëm i Shqipërisë dhe i sistemeve të saj ligjore, ekonomike dhe institucionale. Procesi i integritimit në BE përfaqëson mbështetjen për demokratizimin e Shqipërisë, forcimin e shtetit të së drejtës, konsolidimin e institucioneve publike dhe vazhdimin e proceseve reformuese, duke përshpejtuar zhvillimin ekonomik dhe përfaqësimin me nivelet më të mira evropiane të mirëqenies, konvergencës dhe gjithëpërfshirjes sociale.

Programi Kombëtar për Aderimin në Bashkimin Evropian (PKABE) 2024 - 2030 dhe Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE), si pjesë përbërëse e tij, synojnë të bashkërendojnë procesin e përafrimit të politikave shtetërore dhe legjislacionit kombëtar me *acquis*-në dhe standardet e BE-së për përmbushjen e detyrimeve nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit dhe detyrimeve që dalin si pjesë e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Reforma e Administratës Publike është pjesë përbërëse e PKABE dhe PKIE-së, e trajtuar në kuadër të *Kriterit Politik*.

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2025-2027 ka një objektiv të dyfishtë. Së pari, ai do të shërbejë si instrument i planifikimit të plotësimit të detyrimeve të lindura nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit. Kjo marrëveshje, ratifikuar me ligjin nr.9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve evropiane e shteteve të tyre anëtare”, përcakton në nenin 70 të saj, detyrimin e Republikës së Shqipërisë për përafrimin e legjislacionit kombëtar me legjislacionin e Bashkimit Evropian, në përputhje me afatet e përcaktuara nga kjo marrëveshje.

Së dyti, PKIE 2025-2027 ka si pikësynim final përafrimin e plotë të legjislacionit shqiptar me *acquis*-në e Bashkimit Evropian, si një nga kriteret e anëtarësimit në Bashkimin Evropian, një sision pas hapjes së negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Evropian në korrik 2022, mbajtjes së Konferencës së dytë Ndërqeveritare në tetor 2024 e cila zyrtarizoi hapjen e negociatave për Grupkapitullin I-rë “Themeloret”, si dhe mbajtjes së Konferencës së tretë ndërqeveritare (dhjetor 2024) që zyrtarizoi hapjen e negociatave të anëtarësimit për Grupkapitullin VI-të “Marrëdhëniet me jashtë”, Anëtarësimi në Bashkimin Evropian përbën një hap më të avancuar nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit.

PKIE 2025-2027 përfshin masat politiko - ligjore, institucionale - administrative dhe zbatuese që do të miratohen nga institucionet shqiptare gjatë kësaj periudhe. Çështjet e parashikuara në Kapitullin “*Reforma*

²¹ https://kryeministria.al/wp-content/uploads/2021/10/Programi_Qeverises_2021-2025.pdf

e *Administratës Publike (RAP)*” lidhen me shërbimin civil, menaxhimin e burimeve njerëzore, si dhe me zhvillimin dhe koordinimin e politikave.

PKIE-ja është e lidhur me ciklin e programimit të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) dhe në të njëjtën linjë me PBA mbulon një periudhë 3-vjeçare buxhetimi dhe përditësohet çdo vit. Gjithashtu, çdo projektvendim i Këshillit të Ministrave dhe çdo projektligj i planifikuar në PKIE, është pjesë e listës së akteve që janë parashikuar për miratim në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve (PPAP).

Ndërlidhja e SNRAP 2024-2030 me Dokumentin e Politikës “Agjenda Kombëtare e Reformave 2024 – 2027”

Dokumenti i Politikës “Agjenda Kombëtare e Reformave 2024-2027 (AKR 2024-2027)” mundëson vënien në zbatim të instrumentit të BE-së “Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor” AKR 2024 - 2027 do të jetë një instrument kyç për nxitjen e përgatitjes ekonomike të orientuar nga tregu për hyrjen e ekonomisë shqiptare në tregun e përbashkët të BE-së, në bashkërendim me vendet anëtare të BE-së.

AKR 2024 – 2027 mbështet projektet investuese në sektorin publik dhe atë privat për përmirësimin e konkurrencës ekonomike dhe cilësisë së jetës. Agjenda fokusohet në disa fusha prioritare, si ekonomia e gjelbër, digjitalizimi, inovacioni dhe zhvillimi i teknologjisë, zhvillimi i infrastrukturës fizike dhe kapitalit njerëzor, kohezioni social dhe shteti i së drejtës. Investimet e parashikuara në AKR 2024-2027 për digjitalizimin e shërbimeve dhe zhvillimin teknologjik janë parakushte për zhvillimin dhe rritjen ekonomike të vendit. Pajtueshmëria me Strategjinë e RAP-it, përmes masave dhe aktiviteteve që do të kontribuojnë në digjitalizimin e përsheptuar të proceseve administrative dhe ofrimit të shërbimeve, do të ndihmojë në krijimin e kushteve për rritje ekonomike.

Ndërlidhja e SNRAP 2024-2030 me Programin e Reformave Ekonomike 2024 - 2026

Programi i Reformave Ekonomike 2024 - 2026 përmbledh reformat strukturore prioritare që Shqipëria po zbaton në periudhën afatshkurtër me synim rritjen e prodhimit vendas, nxitjen e investimeve të reja dhe rritjen e konkurrencës së qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Një numër parashikimesh të Programit targetojnë reformën në administratën publike, përfshirë (i) parashikimet për shpenzimet e personelit për vitin 2024, të cilat reflektojnë koston aktuale të administratës publike dhe politikën e re të rritjes së pagave; (ii) forcimin e përgjegjshmërisë menaxheriale përmes përmirësimit të kornizës rregullatore, vlerësimit të vazhdueshëm të sistemit të kontrollit të brendshëm, ofrimit të asistencës teknike, ngritjes së kapaciteteve dhe rritjes e ndërgjegjësimit në lidhje me nevojën e përmirësimit të mekanizmave të llogaridhënies menaxheriale.

Ndërlidhja e SNRAP 2024-2030 me Udhërrëfyesin për Reformën në Administratën Publike 2023-2030

Në vitin 2020, Qeveria Shqiptare përqafoi metodologjinë e re të zgjerimit të prezantuar nga Bashkimi Evropian, e cila forcon fokusin mbi reformat themelore. Në këtë drejtim, konsolidimi i shtetit të së drejtës, funksionimi i institucioneve demokratike dhe reforma në administratën publike mbeten parakusht për progresin e suksesshëm të ndërhyrjeve të nevojshme përgjatë tërësisë së procesit negociator. Një nga risitë kryesore të kësaj Metodologjie është krijimi i Grupkapitujve tematikë të *acquis*-së (*Clusters*), që përfshijnë

disa kapituj negociues, me synimin për të përshpejtuar zbatimin e linjësuar të reformave të kërkuara për përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit në BE.

“Udhërrëfyesi për Reformën në Administratën Pulike 2023-2030” u miratua nga Qeveria Shqiptare më 13 dhjetor 2023, si pjesë integrale e procesit të shqyrtimit analitik të legjislacionit (*Screening*) për anëtarësimin e Shqipërisë në BE. Ky dokument politikash shtetërore mbështet avancimin e reformës në administratën publike përmes një plani konkret masash të qarta dhe me afate të mirëpërcaktuara për realizim përgjatë periudhës 2023-2030. Në kontekstin e negociatave për anëtarësim në BE, ky Udhërrëfyesh shërben si Piketë për hapjen e negociatave për Grupkapitullin e parë “Themeloret”.

Masat e përcaktuara në këtë dokument organizohen në 5 shtylla kryesore, bazuar në parimet e Bashkimit Evropian mbi mirëfunksionimin e administratës publike:

- (1) Zhvillimi dhe koordinimi i politikave;
- (2) Shërbimi civil dhe menaxhimi i burimeve njerëzore;
- (3) Organizimi, llogaridhënia dhe transparencia;
- (4) Ofrimi i shërbimeve;
- (5) Menaxhimi i financave publike.

Secila prej shtyllave të mësipërme përmban masa të dedikuara që adresojnë (i) fushat dhe nënfushat/parimet përkatëse; (ii) kornizën strategjike, ligjore dhe institucionale përkatëse, (iii) zbatimin e reformave dhe forcimin e kapaciteteve institucionale, dhe (iv) përmirësimin e funksionimit dhe performancës së administratës publike. Duke ofuar kështu një kornizë të qartë strategjike dhe një hartëzim të detajuar të ndërhyrjeve kryesore të planifikuara për prioritetet e reformës në administratën publike deri në vitin 2030, Udhërrëfyesi qëndron në themel të Strategjisë Ndërsektoriale të RAP 2024-2030.

Ndërlidhja e SNRAP 2024-2030 me Strategjinë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030

Në vitin 2023, Qeveria Shqiptare miratoi Strategjinë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore për periudhën 2023-2030. Kjo Strategji përcakton gjashtë qëllime kyçe politike, në funksion të forcimit të qeverisjes vendore dhe decentralizimit, përkatësisht:

- (1) Nxitja dhe forcimi i zhvillimit të qëndrueshëm vendor;
- (2) Përmirësimi i cilësisë, standardeve dhe ofrimit të shërbimeve vendore;
- (3) Zgjerimi i qeverisjes digjitale në nivel vendor për të ofruar shërbime dhe programe qeveritare në mënyrë më të efektshme, transparente dhe me kosto efektive;
- (4) Rritja e autonomisë financiare vendore përmes konsolidimit të sistemit të të ardhurave të veta;
- (5) Përmirësimi i demokracisë vendore dhe përparimi i agjendës së integritit evropian në nivel vendor;
- (6) Zhvillimi dhe forcimi i kapaciteteve të nevojshme vendore dhe qendrore dhe i koordinimit të qeverisjes funksionale gjithëpërfshirëse të aktorëve të decentralizimit.

Qëllimet Politike (3) dhe (6) vlerësohen si përshpejtuese për përmbushjen e Qëllimeve të tjera të Strategjisë, duke shërbyer si katalizatorë horizontalë drejt një qeverisjeje vendore që nxit vlerat demokratike dhe është e orientuar drejt rritjes së qëndrueshme ekonomike.

Ndërlidhja e SNRAP 2024-2030 me Strategjinë e Reformës së Menaxhimit të Financave Publike 2023-2030

Strategjia Sektoriale e Reformës së Menaxhimit të Financave Publike 2023-2030 përfaqëson dokumentin kyç strategjik për zhvillimin e sistemit të menaxhimit të financave publike, duke u mbështetur në përvojën dhe reformat e zbatuara përmes Strategjisë pararendëse (2014-2022). Strategjia thekson rëndësinë e përmirësimit të menaxhimit të financave publike jo vetëm për të arritur konsolidimin fiskal dhe për të zbatuar reformat strukturore, por edhe për përmirësimin e cilësisë së performancës së administratës publike dhe për të siguruar një mjedis tërheqës për investitorët.

Mbështetur në Parimet e Administratës Publike të SIGMA-s, menaxhimi i financave publike përbën një nga fushat prioritare ku zbatohet reforma e administratës publike. Përgatitja dhe monitorimi i zbatimit të Qëllimeve Politike dhe masave të Strategjisë Sektoriale të Menaxhimit të Financave Publike është përgjegjësi e Ministrisë së Financave, ndërsa përputhshmëria dhe komplementariteti i tyre me masat në fushat e tjera prioritare të reformës në administratën publike janë garantuar përmes një procesi të integruar planifikimi dhe monitorimi përgjatë përgatitjes së Strategjisë Ndërsektoriale të RAP.

Ndërlidhja e SNRAP 2024-2030 me Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2024-2030

Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (SNKK) 2024-2030 garanton linjëzimin e plotë të angazhimeve të ndërmarra nga autoritetet e përfshira në luftën kundër korrupsionit në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës, miratuar në dhjetor 2023.²² Mes masave të parashikuara për parandalimin dhe ndëshkimin e korrupsionit, Udhërrëfyesi parashtron paralelisht edhe zbatimin e vazhdueshëm të objektivave të ndërgjegjësimit të parashikuara në SNKK 2024-2030, duke vendosur fokus veçanërisht në ndërgjegjësimin antikorrupsion, si dhe promovimin e kulturës së integritetit dhe transparencës brenda institucioneve të administratës publike. Garantimi dhe promovimi i integritetit në administratën publike janë gjithashtu elemente themelore në këtë strategji, masat për arritjen e të cilave linjëzohen plotësisht me parashikimet e SNRAP 2024-2030 për zbatimin e rregullave të etikës në administratë përmes ngritjes së kapaciteteve të stafit në njësitë që monitorojnë etikën dhe menaxhojnë burimet njerëzore.

Më konkretisht, SNKK parashikon forcimin e integritetit të institucioneve publike në të gjitha nivelet e qeverisjes përmes disa masave të rëndësishme. Këto masa përfshijnë vlerësimin e detajuar të numrit të institucioneve që kanë kryer vlerësimin e riskut të korrupsionit dhe kanë miratuar Plane Integriteti, si dhe përgatitjen dhe shpërndarjen e një manuali praktik për hartimin e planeve të integritetit. Po ashtu, parashikohet një vlerësim i detajuar i numrit të institucioneve që kanë miratuar Kodin e Etikës ose Kodet e Sjelljes, paralelisht me zbatimin e Planeve të Integritetit dhe monitorimin e tyre të rregullt. Në bazë të këtyre parashikimeve, regjistri i riskut të korrupsionit do të integrohet në regjistrin e riskut të çdo institucioni publik, dhe do të krijohet një databazë qendrore për nëpunësit civilë që kanë marrë masa disiplinore për shkelje etike ose janë larguar nga shërbimi civil për shkak të një dënimi penal me vendim të formës së prerë.

Përmes sinergjizimit të masave të të dyja strategjive për etikën dhe integritetin në institucionet e të gjitha niveleve të qeverisjes, synohet avancimi i përgjegjshmërisë institucionale dhe konsolidimi i integritetit si të punonjësve, ashtu edhe të procedurave administrative.

²² Miratuar me VKM Nr. 736, datë 13.12.2023.

Ndërlidhja e SNRAP 2024-2030 me Strategjinë “Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2022-2026”

Vijimi i punës për transformimin digjital të Shqipërisë mbështetet nga Strategjia “Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2022-2026”, si edhe Strategjia e re Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2024-2030. Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2022-2026 synon të nxisë investimet në fushat kyçe të informatikës së avancuar dhe përpunimit të të dhënave, inteligjencës artificiale, sigurisë kibernetike dhe aftësive të përparuara digjitale të nevojshme për t’i zhvilluar ato, me qëllimin për të afruar bizneset, administratën publike dhe qytetarët me teknologjitë më të fundit.

Strategjia Agjenda Digjitale e Shqipërisë dhe Plani i Veprimit parashikojnë projekte konkrete për zhvillimin e mëtejshëm të sistemeve ekzistuese dhe ngritjen e platformave moderne që u përgjigjen nevojave të qytetarit apo administratës, si dhe iniciativa konkrete për adresimin e mungesës së burimeve njerëzore në fushën digjitale, duke avancuar më tej vizionin për digjitalizimin e shërbimeve publike dhe zhvillimin e aftësive kibernetike të shoqërisë së gjerë. Masat që përfshihen në SNRAP 2024-2030 synojnë ofrimin e shërbimeve digjitale gjithëpërfshirëse dhe përtej kufijve për qytetarët dhe bizneset, si dhe ri-inxhinierimin e shërbimeve si një proces që ka hyrë tashmë në një fazë të avancuar zbatimi. Aktivitetet e parashikuara në të dyja strategjitë janë komplementare dhe shmangin mbivendosjen e përpjekjeve institucionale drejt digjitalizimit të synuar të shërbimeve të ofruara në vend.

Ndërlidhja e SNRAP me Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030

Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030 përbën një udhërrëfyes për përfshirjen e perspektivës gjinore në zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave publike, ngritjen e mekanizmave për barazinë gjinore në sistemin e administratës publike dhe forcimin e atyre ekzistuese. Integrimi gjinor në politikat e ndërmarra mbështet qeverinë në vendimmarrjen e bazuar në të dhëna për politikat që synojnë arritjen e barazisë gjinore. Për këtë qëllim, një numër angazhimesh të qarta dhe mekanizmesh efektivë parashikohen edhe në SNRAP për të përfshirë perspektivën gjinore në analizën, zhvillimin, zbatimin dhe vlerësimin e politikave dhe buxheteve publike. Strategjia Ndërsektoriale e RAP siguron kështu përputhshmëri të plotë me zotimet dhe kërkesat kombëtare që rrjedhin nga Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030.

Ndërlidhja e SNRAP me Planin Kombëtar të Veprimit “Partneriteti për Qeverisjen e Hapur 2023 - 2025”

Plani Kombëtar i Veprimit “Partneriteti për Qeverisjen e Hapur 2023-2025” është Plani i 6-të Kombëtar i Veprimit që prej anëtarësimit të Shqipërisë në nismën ndërkombëtare të Partneritetit të Qeverisjes së Hapur (OGP) në 2011. Ky Plan pasqyron vendosmërinë e Qeverisë Shqiptare për të mbështetur dhe zhvilluar politika të dedikuara për një qeverisje të hapur, në të cilën transparenca, digjitalizimi, lufta kundër korrupsionit, aksesit në drejtësi, fuqizimi i qytetarëve dhe përdorimi i teknologjive të reja rrisin efikasitetin dhe përgjegjshmërinë e administratës publike në të gjitha nivelet, duke ofruar shërbime publike më efikase dhe në mënyra më innovative, si dhe duke menaxhuar më mirë burimet publike. Në këtë drejtim dhe në përputhje me këtë qëllim, masat e parashikuara në SNRAP synojnë të rrisin efikasitetin e administratës publike për të përmbushur nevojat e qytetarëve dhe të ekonomisë, si dhe të forcojnë transparençën, llogaridhënien dhe integritetin e administratës publike, duke qenë kështu plotësisht në përputhje me Planin Kombëtar të Veprimit “Partneriteti për Qeverisjen e Hapur 2023-2025”.

Ndërlidhja e SNRAP me Agjendën e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030

Agjenda e Kombeve të Bashkuara 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) ofrojnë një qasje gjithëpërfshirëse të veprimit të nevojshëm global për çrrënjosjen e varfërisë, mbrojtjen e mjedisit dhe sigurimin e paqes e prosperitetit për të gjithë. Paqja dhe drejtësia janë dy fusha prioritare të Agjendës 2030. Në këtë drejtim, Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike 2024-2030 është plotësisht e harmonizuar me Agjendën 2030 dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, duke kontribuar drejtpërdrejt në arritjen e qëllimeve të saj, si forcimi i besimit të publikut në sistemin demokratik, përmirësimin në mënyrë të matshme të performancës së administratës publike dhe rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe grupeve të interesit në vendimmarrje. Specifikisht, Strategjia Ndërsektoriale e RAP mbështet arritjen e Objektivit 8 – *Punë e denjë dhe rritje ekonomike*, Objektivit 11 – *Qytete dhe komunitete të qëndrueshme*, Objektivit 16 – *Paqe, drejtësi dhe institucione të forta* (veçanërisht Treguesit 16.6 “*Ndërtimi i institucioneve efikase, llogaridhënëse dhe transparente në të gjitha nivelet e qeverisjes*) dhe Objektivit 17 – *Partneritet për OZhQ-të*.

Strategjia Ndërsektoriale e RAP kontribuon veçanërisht në arritjen e OZhQ 16 – *Paqe, drejtësi dhe institucione të forta*, i cili targeton promovimin e shoqërive paqësore dhe përfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimin e aksesit në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimin e institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet. Në veçanti, Strategjia Ndërsektoriale e RAP i adreson këto synime të Objektivit 16 duke mbështetur zhvillimin e institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe transparente; sigurimin e vendimmarrjes reaguese, përfshirëse dhe përfaqësuese; garantimin e aksesit të publikut në informacion dhe mbrojtjen e lirive themelore; forcimin e kapaciteteve të institucioneve kombëtare për parandalimin e dhunës dhe luftimin e terrorizmit e krimit; dhe promovimin e ligjeve dhe politikave jodiskriminuese për një zhvillim të qëndrueshëm.²³

Përputhja kohore e Strategjisë së RAP 2024-2030 dhe afatit të Agjendës 2030 lehtëson bashkërendimin e veprimeve për arritjen e rezultateve të synuara dhe monitorimin e progresit në zbatimin e tyre.

²³ Këto synime shprehen në Treguesit e mëposhtëm të OZHQ 16:

“16.6 Zhvillimi i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe transparente në të gjitha nivelet;

16.7 Sigurimi i vendimmarrjes reaguese, përfshirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet;

16.8 Zgjerimi dhe forcimi i pjesëmarrjes së vendeve në zhvillim në institucionet e qeverisjes globale;

16.10 Sigurimi i aksesit të publikut në informacion dhe mbrojtja e lirive themelore, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe marrëveshjet ndërkombëtare;

16.a Forcimi i institucioneve përkatëse kombëtare, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkombëtar, për ndërtimin e kapaciteteve në të gjitha nivelet, veçanërisht në vendet në zhvillim, për të parandaluar dhunën dhe për të luftuar terrorizmin dhe krimin;

16.b Promovimi dhe zbatimi i ligjeve dhe politikave jodiskriminuese për zhvillim të qëndrueshëm.”

2. Konteksti politik dhe strategjik: arritjet dhe sfidat

Konferenca e Parë Ndërqeveritare e mbajtur midis Shqipërisë dhe BE-së në 19 korrik 2022 shenoi nisjen zyrtare të një rrugëtimi tejet sfidues, që vijoi menjëherë me procesin e shqyrtimit analitik të legjislacionit dhe gjendjes aktuale (*Screening*). Përgjatë këtij procesi intensiv 1–vjeçar të gjitha institucionet e administratës publike u angazhuan në raportimin mbi hapat e ndërmarra në drejtim të përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis*-në e BE-së dhe plotësimit të kushteve të aderimit, duke ritheksuar arritjet në zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA), si dhe duke shprehur qartësisht seriozitetin dhe angazhimin për të thelluar reformat në të gjitha fushat.

Sipas Raportit më të fundit të Komisionit Evropian për Shqipërinë²⁴ dhe Raportit të hartuar në përfundim të procesit të shqyrtimit analitik për Grupkapitujt I “Themeloret”,²⁵ vendi ynë është mesatarisht i përgatitur në fushën e administratës publike. Komisioni Evropian thekson nevojën për të përfunduar procesin e riorganizimit të roleve dhe përgjegjësi brenda aparatit të Kryeministrit, krijimin e një kuadri ligjor që rregullon në mënyrë ezauresive tipologjinë dhe kriteret për krijimin e organeve vartëse dhe linjat e qarta të llogaridhënies, zbatimin e plotë të kornizës ligjore të shërbimit civil për pozicionet e nivelit të lartë drejtues, rritjen e atraktivitetit të administratës dhe rritjen e motivimit të punonjësve të administratës, aksesin në shërbimet publike të digjitalizuara për personat me njohuri apo mundësi të kufizuara, si dhe nevojën për më tepër siguri digjitale dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Në këtë drejtim, Shqipëria duhet të vijojë përpjekjet për përmirësimin e ndjeshëm të përgatitjes së vendit në fushën e reformës në administratën publike.

Rekomandimet e Komisionit Evropian mbështeten gjerësisht në Parimet e Administratës Publike të OECD/SIGMA, të cilat ofrojnë udhërrëfyesin më reputativ dhe të detajuar për të identifikuar elementet që mundësojnë hartimin dhe zbatimin në praktikë të politikave drejt garantimit të qeverisjes së mirë publike. Në këtë mënyrë, këto parime hartëzojnë qartësisht edhe kërkesat kryesore që shtrohen për zbatim nga Shqipëria përgjatë procesit të integritimit në BE në drejtim të reformimit të administratës publike në përputhje me standardet më të mira evropiane. Vlerësimi më i fundit i OECD/SIGMA për vitin 2024 analizoi statusin aktual të punës për reformën në administratën publike në Shqipëri, duke evidentuar arritjet dhe sfidat për adresim sa i përket përmirësimit të performancës së administratës publike në përputhje me agjendën kombëtare të vendit për integrimin evropian. Përgjithësisht, performanca e Shqipërisë në të gjitha fushat e veprimit të RAP vlerësohet pozitivisht në krahasim me vendet e tjera të rajonit, duke u pozicionuar mbi mesataren rajonale në 5 nga 6 shtyllat e vlerësimit.

Në 15 tetor 2024, u mbajt Konferenca e Dytë Ndërqeveritare Shqipëri-Bashkimi Evropian, në të cilën u vendos zyrtarisht çelja e negociatave për Grupkapitujt I “Themeloret”, e cila përfshin, mes të tjerash, edhe Reformën në Administratën Publike si një element thelbësor i suksesit të procesit tërësor të negociatave të anëtarësimit.

²⁴ Komisioni Evropian, Raporti për Shqipërinë 2024, Tetor 2024, i aksesueshëm në https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania%20Report%202024.pdf.

²⁵ Komisioni Evropian, Raporti i Shqyrtimit Analitik për Shqipërinë – Grupkapitujt I “Themeloret”, Korrik 2023, i aksesueshëm në: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/screening-report-albania_en

Për një shtesë në vendimin nr. 568, datë 6.10.2021, të këshillit të ministrave, “për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar

Në zbatim të detyrimeve që parashtrihen në këtë kuadër, Strategjia Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2024-2030 mbulon pesë fusha prioritare në përputhje me Parimet e Administratës Publike të përcaktuara nga SIGMA.²⁶ Të gjitha gjetjet dhe rekomandimet e ofruara nga vlerësimi i OECD/SIGMA janë analizuar dhe reflektuar në Strategjinë e re Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike për periudhën 2024-2030, duke shërbyer si udhërrëfyes për parashikimin e angazhimeve konkrete të parashikuara në Strategji. Në këtë drejtim, institucionet bashkëpërgjegjëse për zbatimin e këtyre angazhimeve kanë punuar për të harmonizuar në mënyrë optimale zotimet e marra përsipër në kuadër të prioritetëve ekzistuese, vlerësimet e brendshme institucionale, si dhe analizat e partnerëve ndërkombëtarë dhe rekomandimet e lëna prej tyre. Ky linjëzim synon të sigurojë sinergji maksimale mes tyre, për të bërë të mundur orientimin efikas të burimeve drejt arritjes së objektivave të synuara strategjike.

Gjithashtu, në kuadër të punës për rritjen e ekspertizës në administratën publike, në nëntor 2024 Shqipëria mori zyrtarisht statusin e Vëzhguesit në Rrjetin Evropian të Administratës Publike (EUPAN). Dhënia e këtij statusi do të përshpejtojë agjendën e integritit të vendit në BE në fushën e reformës në administratën publike, duke ndjekur rekomandimin e qartë nga Komisioni Evropian në Raportin e Shqyrtimit Analitik për Grupkapitujt I “Themeloret”. Pjesëmarrja e Shqipërisë si Vëzhgues në EUPAN do të lehtësojë shkëmbimin e ndërsjellë të njohurive dhe përvojave me vendet anëtare të BE-së, duke mundësuar përfitime të shumta nga ekspertiza e përbashkët e Rrjetit, mes të tjerash, edhe në zbatimin e suksesshëm të SNRAP 2024-2030.

2.1 Arritjet dhe sfidat në zhvillimin dhe koordinimin e politikave

Anëtarësimi në Bashkimin Evropian (BE) është synimi madhor politik dhe strategjik i Republikës së Shqipërisë dhe i sistemit të saj ligjor, ekonomik dhe institucional. Në këtë aspekt është prioritet ngritja e instrumentave të nevojshëm për forcimin e kapaciteteve dhe përmirësimin e strukturave integruese për të përmbushur të gjitha kërkesat e procesit negociator për anëtarësimin në BE. Përgatitjet teknike për fazën e shqyrtimit analitik të legjislacionit dhe kapaciteteve institucionale janë bashkërenduar dhe drejtuar metodologjikisht nga Departamenti i Politikave dhe Integritit Evropian në Kryeministri, në rolin e Sekretariatit të Integritit Evropian, me synimin për të mbështetur strukturat negociuese gjatë procesit të integritit.

Progresi i Shqipërisë në reformën në administratën publike, i reflektuar edhe në vlerësimin më të fundit të vitit 2024 nga OECD/SIGMA, krijon bazat për konsolidimin e një sistemi politikëbërës të mirëorganizuar, të qëndrueshëm dhe kompetent, i cili është jetik për zhvillimin dhe koordinimin e politikave në administratën publike.

Prej vitit 2015, koordinimi i politikave zhvillohet përmes Mekanizmit të Menaxhimit të Integruar të Politikave (IPMG), i krijuar nga Qeveria Shqiptare me synim zbatimin e qasjes sektoriale/ndërsektoriale

²⁶ Shtyllat e Vlerësimit sipas Parimeve të Administratës Publike të OECD/SIGMA janë:

1. Kuadri Strategjik dhe përmirësimi i vazhdueshëm i administratës publike;
2. Zhvillimi dhe koordinimi i politikave;
3. Shërbimi publik dhe menaxhimi i burimeve njerëzore;
4. Organizimi, llogaridhënia dhe mbikëqyrja;
5. Ofrimi i shërbimeve dhe digjitalizimi;
6. Menaxhimi i financave publike.

për menaxhimin dhe bashkërendimin efektiv të politikave në fushat prioritare dhe në sektorët strategjikë.²⁷ Ky Mekanizëm zbatohet përmes Grupeve të Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP) dhe Ekipeve të dedikuara Tematike. GMIP-të janë krijuar të garantojnë bashkëpunim dhe vendmarrje të përbashkët në nivele të larta politike dhe menaxheriale, me qëllim planifikimin dhe koordinimin e ekzekutimit dhe monitorimit të politikave dhe programeve ndërsektoriale dhe kombëtare në fushat prioritare. Paralelisht, ekipet tematike pritet të veprojnë për të siguruar bashkëpunim në nivel sektorial dhe me partnerët e angazhuar në agjendën për zhvillim. Në përgjigje të sfidave të evidentuara ndër vite për rritjen e efikasitetit të këtij mekanizmi, në vitin 2023 u miratua një strukturë e rishikuar për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, me synimin për të përmirësuar funksionimin e Mekanizmit. Struktura e rishikuar dhe aktualisht në fuqi përfshin 6 GMIP dhe 42 Ekipet Tematike.²⁸

Komiteti i Planifikimit Strategjik (KPS), i kryesuar nga Kryeministri, është struktura kyçe për përcaktimin e përparësive të zhvillimit të vendit dhe për harmonizimin e planifikimit të integruar me jetësimin e këtyre përparësive. KPS-ja luan një rol vendimtar në miratimin e vizionit, objektivave, afateve dhe kalendarëve të përgatitjes për çdo dokument strategjik, qoftë sektorial apo ndërsektorial. Përpara miratimit në Këshillin e Ministrave, dokumentet e projekt-strategjisë duhet të vlerësohen dhe të aprovohen nga KPS-ja, duke siguruar përputhshmërinë me prioritetet kombëtare. Agjencia Shtetërore për Programimin Strategjik dhe Koordinimin e Ndihmës (SASPAC) shërben si Sekretariati Teknik për KPS-në dhe ka për detyrë koordinimin e përgjithshëm të punës për funksionimin e Grupeve të Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP-ve).²⁹ Këto të fundit raportojnë te KPS përmes Sekretariatit të Përgjithshëm, duke mbështetur kështu procesin e vendimmarrjes. Çdo GMIP mbështetet nga një sekretariat teknik (Sekretariati Teknik), i cili krijohet me urdhër të ministrit ose drejtuesit të institucionit përkatës dhe është pjesë e institucioneve qeverisëse përgjegjëse për GMIP-të dhe Ekipet Tematike. Sekretariatet teknike raportojnë periodikisht mbi progresin e procesit dhe paraqesin çështjet që kërkojnë vendimmarrje te Sekretariati Teknik Qendror, i cili, në koordinim me sekretariatit e KPS-së, i përcjell këto çështje për vendimmarrje te KPS. SASPAC gjithashtu informon KPS-në çdo gjashtë muaj mbi ecurinë e GMIP-ve.

Sistemi Informatik i Planifikimit të Integruar të Politikave (IPSI)³⁰ është krijuar si sistemi kryesor për planifikimin dhe përgatitjen e të gjitha tipologjive të dokumenteve strategjike, si dhe për monitorimin e progresit në zbatimin e tyre, në përputhje me objektivat e synuara. Ky sistem ka për qëllim të sigurojë një kornizë gjithëpërfshirëse monitorimi dhe raportimi, ku të gjitha politikat dhe proceset kryesore të planifikimit funksionojnë në mënyrë koherente, efikase dhe të integruar.

Përmirësimi i mëtejshëm i platformës IPSIS është një angazhim i vazhdueshëm i cili do të adresojë si sfidat aktuale të identifikuara përgjatë viteve në garantimin e funksionalitetit të plotë të Sistemit, ashtu edhe përfshirjen e aktiviteteve të Grupeve të Menaxhimit të Integruar të Politikave në modulet e IPSIS.

Një tjetër zhvillim i rëndësishëm në koordinimin e politikave është hartimi dhe miratimi i Dokumentit të Politikave Prioritare (DPP), i cili ka për qëllim të ofrojë një orientim më të qartë dhe efektiv mbi politikat prioritare. Ky dokument synon të garantojë shpërndarjen më efektive të burimeve dhe linjëzimin e vendimmarrjes strategjike.³¹ DPP-ja është një nga komponentët kyç të procesit të planifikimit të integruar, duke garantuar një ndërlidhje më të mirë ndërmjet strategjive kombëtare dhe burimeve financiare të

²⁷ Urdhër Nr. 157, datë 22.10.2018, i Kryeministrit "Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar".

²⁸ Urdhër Nr. 90, datë 07.08.2023, i Kryeministrit.

²⁹ Në zbatim të VKM Nr. 642, datë 29.10.2021, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Shtetërore për Programimin Strategjik dhe Koordinimin e Ndihmës" (SASPAC).

³⁰ Miratuar me VKM nr. 290, datë 11.04.2020.

³¹ Miratuar me VKM Nr. 161, datë 20.03.2024 "Për miratimin e Dokumentit të Politikave Prioritare 2025-2027".

disponueshme. Një element i rëndësishëm i DPP-së dhe njëherësh pjesë integrale e procesit të vendimmarrjes, është edhe Lista Unike e Projekteve me Rëndësi Kombëtare (*National Single Pipeline Project*), e cila përditësohet në baza vjetore. Kjo listë ka për qëllim forcimin e procesit të menaxhimit të financave publike, si dhe procedurave që lidhen me propozimin dhe miratimin e projekteve të investimeve publike, të cilat janë klasifikuar si projekte strategjike. Prej miratimit të saj fillestar në vitin 2023, kjo listë është përditësuar për herë të fundit në Gusht 2024.³²

Ngjashëm, sa u përket funksioneve të Qendrës së Qeverisë (CoG), funksionet kritike i janë caktuar Qendrës së Qeverisë përmes Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Ministrave³³ dhe Rregulloren e Këshillit të Ministrave.³⁴ Krahas tyre, një seri Udhëzimesh janë në dispozicion për Ministrinë dhe organet e tjera qeveritare për t'i mbështetur ato në hartimin e legjisllacionit, zhvillimin e Planit të Akteve, monitorimin e zbatimit të buxhetit të shtetit dhe investimeve publike, si dhe në përgatitjen e dokumentave politikë në kuadër të integritimit evropian.

Perceptimi i efektivitetit të Qendrës së Qeverisë në koordinimin e politikave sipas nëpunësve civilë




Figura 3. Perceptimi i efektivitetit të Qendrës së Qeverisë (CoG) në koordinimin e politikave sipas nëpunësve civilë në Shqipëri krahasuar me rajonin e Ballkanit Perëndimor (SIGMA 2024)

Sa i takon politikëbërjes së bazuar në të dhëna, si një dimension i rëndësishëm i cilësisë së planifikimit dhe koordinimit të politikave, Shqipëria pozicionohet mjaft mirë krahasuar me mesataren rajonale. Në vitet e fundit, zbatimi i kuadrit rregullator të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (VNR/RIA) ka ndikuar në rritjen e cilësisë dhe efektivitetin e hartimit të politikave dhe legjisllacionit në vend, duke mundësuar që ndërhyrja rregullatore e Qeverisë të fokusohet aty ku është e nevojshme. Ky proces ka mundësuar rezultate më të mira me një barrë dhe kosto minimale rregullatore e administrative, përmes analizave *ex-ante* të vlerësimit të projektligjeve paraprakisht miratimit të tyre.

Megjithatë, në kuadër të përpjekjeve për përmirësimin e mëtejshëm të procesit, disa elemente të identifikuar që duhet të priorizohen janë përmirësimi i aftësive analitike dhe ekspertizës mbi procesin RIA në ministrinë e linjës, rritja e aftësive dhe njohurive të rrjetit të nëpunësve të ngarkuar me procesin RIA sa i takon gjetjes së të dhënave, si dhe përmirësimi i zbatimit praktik të aspekteve të ndryshme të Metodologjisë së Vlerësimit të Ndikimit.

³² Miratuar me VKM Nr. 533, datë 12.08.2024.

³³ Ligji 9000/2003 Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Ministrave datë 30.01.2003.

³⁴ VKM 584/2003 Për Miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave, date 28.08.2003, përditësuar.

Përmirësimi i cilësisë së raporteve RIA është rezultat i drejtpërdrejtë i asistencës dhe punës koordinuese të kryer nga Njësia e Programimit të Akteve Rregullatore dhe RIA në Kryeministri, si dhe i njohurive që kanë mbi këtë proces zyrtarët e përfshirë në hartimin e këtyre raporteve.

Konsultimi publik përbën një komponent thelbësor të kriterëve për përmbushjen e reformave të kërkuara si pjesë e detyrimeve të Shqipërisë në kuadër të Grupkapitujve I “Themeloret”. Ky proces është parakusht jo vetëm për përmirësimin e performancës së administratës publike, por edhe me funksionimin e institucioneve demokratike.

Me qëllim adresimin e rekomandimeve të procesit të shqyrtimit analitik të legjislacionit dhe kapaciteteve institucionale, si edhe ndërgjegjësimin dhe forcimin e kulturës rreth këtij procesi, përmirësimi i konsultimit publik është integruar në Udhërrëfyesit përkatës të Reformës së Administratës Publike dhe Funksionimit të Institucioneve Demokratike 2023-2030. Sigurimi i një qasjeje gjithëpërfshirëse për fuqizimin e shoqërisë civile dhe rritjen e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së institucioneve qëndrojnë në themel të masave të ndërmarra në këtë drejtim.

Garantimi i transparencës dhe frymës së bashkëpunimit mes autoriteteve publike luan një rol thelbësor në rritjen e pjesëmarrjes së publikut dhe aktorëve të tjerë në procesin e konsultimit publik. Për këtë qëllim, monitorimi i publikimit të projekt-akteve dhe dokumenteve shoqëruese për konsultim kryhet periodikisht në baza javore nga Njësia e Programimit të Akteve Rregullatore në Kryeministri, në kuadër të përpjekjeve të vazhdueshme për përmirësimin dhe promovimin e këtij procesi, dhe në zbatim të rekomandimeve të Komisionit Evropian. Gjithashtu, Njësia është angazhuar për organizimin e seancave trajnuese në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, me qëllim rritjen e kapaciteteve të funksionarëve publikë përgjegjës për të kryer këtë proces me efikasitet dhe në përmbushje të kriterëve ligjore dhe rregullatore.

Sfidat

Performanca e administratës publike shqiptare është përmirësuar ndjeshëm në vitet e fundit, falë priorizimit të reformës në administratën publike dhe miratimit të një kuadri të detajuar ligjor, rregullator dhe institucional. Për të mbështetur më tej këto arritje dhe për të përballuar sfidat e identifikuar në proces, nevojiten disa përmirësime të mëtejshme. Këto sfida identifikohen si nga vlerësimet e brendshme ndërinstitucionale për progresin e zbatimit të reformës në administratën publike, ashtu edhe bazuar në raportet ndërkombëtare, ku Raportet e Komisionit Evropian dhe OECD/SIGMA-s zënë rolin qëndror.

Sikurse reflektuar edhe më sipër, në përgjithësi strukturat organizative dhe menaxhuese për RAP janë krijuar dhe janë operacionale. Megjithatë, masat e ardhshme duhet të vlerësojnë mundësinë për thjeshtimin dhe rritjen e efikasitetit të arkitekturës së përgjithshme të Grupeve të Menaxhimit të Politikave të Integruara (GMIP) për të koordinuar dhe udhëhequr zbatimin në nivel administrativ të reformës në administratën publike.

Një nga prioritetet kryesore është garantimi i një vendimmarrjeje të qëndrueshme dhe të mirëkoordinuar për zhvillimin e politikave, përmes plotësimit të kuadrit ekzistues ligjor dhe institucional. Ky përmirësim do të mundësojë një cilësi më të lartë në planifikimin dhe zbatimin e politikave në nivel kombëtar. Një tjetër objektiv është krijimi i një funksioni të dedikuar për kontrollin e cilësisë, që do të mbështesë përmirësimin e kornizës strategjike dhe zbatimin e dokumenteve ligjore e strategjike të rëndësishme, duke u mbështetur në të dhëna dhe në Vlerësime të Ndikimit Rregullator. Kjo do të lehtësojë harmonizimin e dokumenteve të ndryshme strategjike dhe përafrimin e tyre me standardet evropiane.

Gjithashtu, është thelbësor përmirësimi i monitorimit të zbatimit të Planeve të Veprimit të RAP dhe publikimi i raporteve të monitorimit për transparencë dhe akses më të gjerë publik. Për të garantuar

efikasitetin në këtë drejtim, riaktivizimi i mekanizmave të koordinimit është një hap vendimtar që do të mbështesë zbatimin efektiv të reformave dhe adresimin e sfidave të reja.

Për një integrim më të thellë të politikave, përmirësimi i koherencës ndërmjet planifikimit strategjik dhe buxhetimit është një objektivi tjetër i rëndësishëm, që do të kontribuojë në një buxhetim të qëndrueshëm dhe në prioritizimin e ndërhyrjeve të RAP. Gjithashtu, përmirësimi i kapaciteteve administrative të ministrive dhe Kryeministrit për planifikimin dhe monitorimin e politikave mbetet një përparësi për të garantuar një qasje të koordinuar dhe profesionale në procesin e integritimit evropian.

Për të përmirësuar më tej efektivitetin e hartimit të legjislacionit të ri, adresimi i sfidave teknologjike të Sistemit të Integruar të Planifikimit dhe rritja e cilësisë së Vlerësimit të Ndikimit Rregullator mbetet parësor, paralelisht me përfshirjen më të gjerë e publikut në konsultimet ligjore. Këto ndërhyrje premtojnë të avancojnë transparencën dhe cilësinë në vendimmarrje, arsye për të cilën përpjekjet do të përqendrohen veçanërisht në rritjen e përqindjes së akteve ligjore që kalojnë në konsultim publik dhe përmirësimin e procesit të konsultimeve me aktorët e interesuar.

Në përbushjen e këtyre sfidave, synimi madhor është garantimi i një qasjeje të hapur dhe gjithëpërfshirëse, duke përmirësuar komunikimin me qytetarët dhe garantuar transparencën në vendimmarrjen e qeverisë.

2.2 Arritjet dhe sfidat në shërbimin civil dhe manaxhimin e burimeve njerëzore

Fillimi i zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale për RAP 2015-2022 përkoji pothuajse me hyrjen në fuqi të legjislacionit të shërbimit civil i cili është ende në fuqi. Zbatimi i këtij legjislacioni që solli ndryshime thelbësore në sistemin e shërbimit civil, u shoqërua me sfida të lidhura me krijimin dhe konsolidimin e praktikave administrative për zbatimin e tij efikas. Realizimi i objektivave të Strategjisë Ndërsektoriale të RAP 2015-2022 për institucionet publike kontribuoi në adresimin e këtyre sfidave, duke mundësuar që Shqipëria të marrë vlerësime pozitive nga institucionet ndërkombëtare në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore. Në vitet e fundit, shërbimi civil shqiptar është vlerësuar si i pjekur, fleksibël dhe i qëndrueshëm sipas standardeve rajonale.³⁵ Bazuar në treguesit e monitoruar periodikisht në këtë fushë, Shqipëria konsiderohet nga SIGMA si vend kryesues në nivel rajonal, duke kryesuar ndjeshëm dhe në mënyrë të qëndrueshme që prej vitit 2021 renditjen e vendeve të Ballkanit Perëndimor, thuajse në të gjithë kriteret e vlerësimit.

Përgjatë viteve 2023-2024, Qeveria Shqiptare rishikoi sistemin e pagave si kriterin e vetëm për të cilin Shqipëria renditej që prej vitit 2021 pas vendeve të rajonit, duke e adresuar këtë çështje me reformën e pagave të implementuar në dy faza, përkatësisht në vitin 2023 dhe vitin 2024.

Shqipëria ruan të njëjtin pozicion lider në Ballkanin perëndimor edhe në rezultatet e vlerësimit të kryer gjatë vitit 2024, të cilat i janë komunikuar Qeverisë Shqiptare në tetor 2024.³⁶

Rekrutimi i mbështetur në meritë

Në vlerësimin e Komisionit Evropian në Raportin e Shqyrtimit Analitik për Grupkapitujt I “Themeloret”, kadri ligjor shqiptar vlerësohet si gjerësisht i harmonizuar me parimet themelore të rekrutimit të bazuar në meritë dhe transparencë, me kritere të qarta dhe të mirëpërcaktuara për uljen në detyrë dhe lirin nga

³⁵ OECD/SIGMA, Raport Monitorimi: Parimet e Administratës Publike – Shqipëria, 2021, www.sigmaweb.org

³⁶ OECD/SIGMA, Raport Monitorimi: Parimet e Administratës Publike – Shqipëria, 2024, www.sigmaweb.org

shërbimi civil.³⁷ Përmes ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” u mundësua krijimi i një sistemi ku ngritja në karrierë merr një peshë qendrore dhe promovimi është kryesisht i hapur vetëm për nëpunësit ekzistues, me përjashtim të rasteve të veçanta të promovimit që përbëjnë maksimalisht 20% të promovimeve totale.

Modeli i zbatuar eliminon të drejtën diskrecionare të drejtuesve të institucioneve për të zgjedhur kandidatët fitues dhe mundësoi kalimin në një sistem të ri ku kandidati i renditur i pari zgjedh nga lista e pozicioneve të lira. Gjatë këtyre viteve të zbatimit të ligjit, si rezultat i reformave të ndërmarra u ndërtua për herë të parë një sistem elektronik i testimit, mbështetur në një bankë pyetjesh për të gjitha fushat e testimit, duke duke rritur kështu objektivitetin dhe meritokracinë në procesin e përzgjedhjes. Gjithashtu, u vu rishtazi në funksionim një sistem elektronik për aplikimin e kandidatëve dhe dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm, duke e kthyer DAP në një pararendës të vizionit të “*administratës së gjelbër*”.

Masat e ndërmarra dhe përdorimi i hershëm i teknologjisë në proces mundësoi funksionimin e plotë të procedurës së rekrutimit edhe përgjatë periudhës së pandemisë Covid-19, duke lehtësuar ndjeshëm kalimin drejt menaxhimit në distancë të proceseve krahasimisht me fusha të tjera të veprimtarisë administrative. Si pjesë e fleksibilitetit të aplikuar gjatë kësaj periudhe u eksperimentua me sukses edhe zhvillimi i testimit në distancë, përfshirë intervistimin.

Ligji mundësoi gjithashtu ngritjen e Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues (TND), e cila përzgjidhet përmes një procedure të veçantë që synon vlerësimin e kapaciteteve menaxheriale dhe drejtuese për pozicionet e rëndësishme drejtuese në administratën publike. Kandidatët e kualifikuar përmes vlerësimit nga një Komision i posaçëm përzgjedhjeje bëhen pjesë e listës nga e cila institucionet me pozicione drejtuese vakante mund të zgjedhin drejtuesit e tyre.

Këto ndërhyrje u shoqëruan me rritjen e kapaciteteve menaxhuese të DAP, si qendra e sistemit të rekrutimit, si dhe të institucioneve që gëzojnë kompetenca të zgjeruara në zbatimin e procedurave të ngritjes në detyrë. Stoku prej 480 vendimesh gjyqësore të formës së prerë lidhura me proceset e menaxhimit të BNJ (për periudhën 2013 – 2023), në fund të vitit 2023, u reduktua në 76 vendime të mbetura për ekzekutim.

Në këtë drejtim, Raporti i vitit 2024 i OECD/SIGMA për Shqipërinë vlerëson përgjithësisht se kuadri ligjor, përfshirë atë dytësor dhe tretësor mbi rekrutimin, vlerësimet e performancës, zhvillimin profesional, procedurat disiplinore dhe shkarkimet, garanton që nëpunësit civilë të kenë bazën e nevojshme për të kryer detyrat e tyre me profesionalizëm, neutralitet dhe përgjegjshmëri, duke kufizuar ndërhyrjet politike në proceset e menaxhimit të burimeve njerëzore.³⁸

Sistemi i pagave dhe motivimi

Sistemi i pagave për nëpunësit civilë është i rregulluar qartë. Paga llogaritet sipas pozicionit të punës së nëpunësit civil, sistem që tashmë është i njëjti edhe për institucionet e qeverisjes vendore. Përgjatë viteve, Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë vazhdimisht reforma në sistemin e pagave të administratës publike, prej të cilave kanë përfituar kryesisht punonjësit e administratës publike në ministri dhe në sektorët e shëndetësisë, arsimit, sigurisë dhe forcave të armatosura.

Rritja e fundit e pagave për nëpunësit civilë është zbatuar nga Qeveria Shqiptare gjatë viteve 2023 dhe 2024, me synimin për të rritur nivelin e kënaqësisë dhe motivimit të nëpunësve të administratës publike, si dhe për të pozicionuar shërbimin publik si një punëdhënës konkurrues në tregun e punës. Krahas rritjes së

³⁷ Komisioni Evropian, Raporti i Shqyrtimit Analitik – Grup-Kapitujt I “Themeloret”, Korrik 2023, f. 29, https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/b83313ef-48c5-4bef-9f00-f5d66509572e_en?filename=AL%20Cluster%20Draft%20screening%20report_external%20version.pdf

³⁸ OECD/SIGMA, Raport Monitorimi: Parimet e Administratës Publike – Shqipëria, 2024, www.sigmaweb.org

pagave, reforma mundësoi edhe një rregullim në strukturën e pagës. Krahasuar me vitin 2013, pagat e nëpunësve civilë janë rritur mesatarisht nga 35% deri në 65%, sipas kategorive. Paralelisht, është rritur edhe indeksi i shkallës së komprimimit të pagave dhe është rritur pesha e elementit të vjetërsisë në pagën totale. Këto ndryshime janë realizuar në dy faza përmes nismave ligjore të miratuara në vitin 2023, dhe vendimeve të qeverisë gjatë viteve 2023-2024.

Si rezultat i të gjitha ndërhyrjeve, Qeveria Shqiptare ka mundur jo vetëm të arrijë objektivin e caktuar për pagë mesatare në administratën publike në mbi 900 euro sipas Udhërrëfyesit të Reformës në Administratën Publike, por të sigurojë një pagë mesatare në nivelin e 1.050 euro, nga 530 euro në fillim të vitit 2023, si një rritje që vlerësohet domethënëse edhe nga Komisioni Evropian në vlerësimin më të fundit për Shqipërinë.³⁹

Qeveria Shqiptare miratoi në gusht 2024 një reformë të plotë të pagave edhe për punonjësit e njësisve të vetëqeverisjes vendore, duke ndryshuar metodën e llogaritjes së vjetërsisë për ta përshtatur me atë të nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe duke barazuar kështu pagën nëpunësve lokalë me atë të klasës përkatëse në administratën shtetërore. Ndryshimet ligjore mundësuan rritjen e pagave nga 40% deri në dyfishimin e pagës për disa pozicione/profesionet specifike, si dhe standardizimin e pagave në të 61 bashkitë e vendit.⁴⁰

Ndërkohë, sipas sondazhit rajonal të kryer nga OECD/SIGMA në 2024, reforma e pagave ka ndikuar në rritjen e kënaqësisë në punë dhe atraktivitetit të sektorit publik si punëdhënës konkurrues në treg, duke shënuar një rritje të nëpunësve të kënaqur me pagën e tyre nga 13% në vitin 2022 në 47% deri në prill 2024.⁴¹

Një tjetër zhvillim i rëndësishëm ishte edhe organizimi për herë të parë nga Qeveria Shqiptare i “*Javës së Administratës Publike*” nga 27 deri më 31 maj 2024, me temën “*Modernizimi në Veprim*”, duke shënuar një moment të rëndësishëm në njohjen dhe festimin e shërbimit publik. Gjatë javës u zhvilluan një sërë ngjarjesh, si Panairi i Administratës Publike, Forumi i Inovacionit në Administratën Publike, Forumi i Strukturave të Burimeve Njerëzore në Ministri, Turneu i Volejbollit, dhe iniciativa “*Sill Fëmijën në Punë!*” dhe përzgjedhja nga vetë punonjësit e administratës publike të punonjësit më të mirë në çdo ministri. Aktivitetet synuan promovimin e kapitalit njerëzor, rritjen e aksesit të qytetarëve në veprimtarinë e institucioneve, si dhe forcimin e frymës së ekipit në administratë.

Krahas këtyre zhvillimeve, Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të forcuar koordinimin, punën në ekip dhe motivimin e stafit. Në maj 2024, Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Anti-Korrupsion prezantoi një “*Paketë Motivimi*”, e ideuar për të rritur motivimin e punonjësve dhe për të përmirësuar kulturën organizative në administratën publike. Paketa u zhvillua me Asistencën Teknike të Projektit “*BE për Mirëqeverisjen*”, bazuar në praktikat më të mira evropiane për ekselencën e administratës publike dhe duke u përshtatur posaçërisht për aplikim në mjedisin e administratës publike shqiptare. Paketa përbëhet nga katër shtylla kryesore: (i) përshtatja me sfidat bashkëkohore dhe mirëqenia; (ii) akses në

³⁹ Komisioni Evropian, Raporti për Shqipërinë 2024, Tetor 2024, f. 27. https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania%20Report%202024.pdf

⁴⁰ Miratuar me VKM Nr. 503, datë 01.08.2024 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 328, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, ‘Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësisve të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësisve të vetëqeverisjes vendore’”.

⁴¹ OECD/SIGMA, Raport Monitorimi: Parimet e Administratës Publike – Shqipëria, 2024, https://www.oecd.org/en/publications/public-administration-in-albania-2024_5577d117-en.html

shërbime dhe aktivitete; (iii) fryma e ekipit dhe konkurrenca e shëndetshme në punë; dhe (iv) motivimi financiar.⁴²

Nga lançimi i Paketës deri në tetor 2024 është zbatuar shtylla e parë e Paketës, përmes dy ndryshimeve kryesore në kornizën ligjore dhe rregullatore:

- Është tashmë në fuqi fleksibiliteti i orarit të punës, përmes miratimit të ndryshimeve në VKM-në rregullatore për orarin e punës dhe periudhat e pushimit për administratën shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore. Ndryshimet e miratuara synojnë të ofrojnë më shumë fleksibilitet në orarin e punës, duke përmirësuar balancën punë-jetë, veçanërisht për prindërit, duke u mundësuar atyre përshtatjen e orarit të punës me shërbimet sociale për fëmijët (çerdhe/shkollë), ndërkohë që ruhet produktiviteti brenda institucioneve publike.⁴³
- Është shtuar fleksibiliteti mbi pushimet vjetore, përmes ndryshimeve më të fundit të miratuara në Kodin e Punës, të cilat kanë hequr kufizimin që ndalonte punonjësit e administratës publike të marrin pushime vjetore më pak se një javë kalendrike. Dispozitat në fuqi tashmë përcaktojnë qartë se pushimet vjetore janë 22 ditë pune, me 2 ditë shtesë të dhëna për të gjithë punonjësit.⁴⁴

Zbatimi i orarit fleksibël shihet si një hap i parë drejt aplikimit të punës hibride dhe në distancë, e aplikuar gjerësisht me sukses gjatë periudhës së pandemisë. Gjithashtu, zgjedhja dhe shpallja e punonjësve të vitit në institucione synohet të kthehet në një traditë dhe element motivues për stafin. Në reflektim të angazhimit të Qeverisë Shqiptare për të krijuar një mjedis pune dinamik, mbështetës dhe motivues për punonjësit e administratës publike, dialogu me nëpunësit për mbledhjen e nevojave dhe vlerësimeve të tyre për ndërhyrjet e planifikuara vijon të udhëheqë punën për zhvillimin dinamik të paketës, për të siguruar zbatimin e saj progresiv dhe efikas, në përgjigje të nevojave reale të nëpunësve publikë.

Zhvillimi i shërbimit civil dhe forcimi i kapaciteteve

Gjatë periudhës së zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale të RAP 2015-2022 janë shënuar një sërë arritjesh dhe risish në menaxhimin e shërbimit civil dhe përmirësimin e efikasitetit të disa proceseve të punës për administratën. Në këtë drejtim, OECD/SIGMA vlerëson veçanërisht ekzistencën e një komunikimi të

⁴² Më gjerësisht:

(i) Shtylla e parë fokusohet në përshtatjen me sfidat bashkëkohore dhe promovimin e mirëqenies. Kjo përfshin ofrimin e fleksibilitetit në oraret e punës (me orë të detyrueshme midis 09:30 – 15:30) si dhe rishikimin e dispozitave ligjore mbi pushimet vjetore, duke hequr kufizimet e Kodit të Punës për periudhat e pushimit.

(ii) Shtylla e dytë siguron akses në shërbime dhe aktivitete, duke ofruar trajtim preferencial për punonjësit në aktivitetet kulturore dhe akses në hapësirat sportive publike.

(iii) Shtylla e tretë thekson forcimin e frymës së ekipit dhe konkurrencën e shëndetshme përmes praktikave vjetore të vlerësimit të integritetit dhe performancës profesionale në çdo ministri, organizimit të konkurseve për inovacion dhe zbatimin të një Programi të Zhvillimit të Liderimit.

(iv) Shtylla e katërt adreson motivimin financiar përmes një sistemi shpërblimesh për performancë të mirë, duke njohur dhe inkurajuar kontributet e veçanta.

⁴³ Ndryshimet parashikojnë që punonjësit mund të zgjedhin të fillojnë ditën e punës më herët dhe ta përfundojnë më herët, ose të fillojnë më vonë dhe të përfundojnë më vonë, përderisa plotësojnë orët e punës të kërkuara (8.5 orë nga e hëna deri në enjten dhe 6 orë të premtën). Po ashtu, është vendosur një orar i detyrueshëm nga ora 09:30 deri në 15:30 (dhe deri në 13:00 të premtën) gjatë të cilit të gjithë punonjësit duhet të jenë të pranishëm në punë. Ndryshimet janë miratuar me VKM Nr. 530, datë 01.08.2024 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 568, datë 6.10.2021, të Këshillit të Ministrave, ‘Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore’”.


⁴⁴ Miratuar me ligjin Nr. 91/2024 “Për disa ndryshime në ligjin Nr. 7961, datë 12.7.1995, ‘Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë’, i ndryshuar”.

rrjedhshëm dhe efikas të DAP me njësitë të menaxhimit të burimeve njerëzore, si dhe me Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.⁴⁵ Një rol të rëndësishëm në këtë koordinim ka luajtur përdorimi i platformës së integruar “*administrata.al*” duke përmirësuar ndërveprimin e institucioneve publike, duke lehtësuar komunikimin dhe raportimin e informacionit në kohë reale, duke unifikuar praktikat administrative dhe duke përmirësuar cilësinë e proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore. Një numër voluminoz dokumentesh dhe praktikash janë ngarkuar në platformë për t’u përdorur nga nëpunësit dhe institucionet.

Regjistri Qendror i Personelit (RQP) për menaxhimin e burimeve njerëzore është vënë në funksionim dhe aktualisht përdoret nga të gjitha institucionet. Numri i dosjeve të personelit të regjistruara deri në tetor 2024 rezulton të jetë 60.000. Gjithashtu, është rritur numri i institucioneve që përdorin sistemin për gjenerimin e listës së pagave, në një proces që ka hasur në një numër sfidash gjatë zbatimit. Aktualisht RQP po kalon në një proces modernizimi dhe shtimi funksionalitetesh për ta bërë përdorimin më të thjeshtë dhe më efikas për përdoruesit në menaxhimin e burimeve njerëzore.

Rritja e kapaciteteve të brendshme është një prioritet vijues i administratës publike. Me këtë synim, përgjatë viteve të fundit janë zbatuar një seri programesh me synim tërheqjen e talentëve të reja në administratë, si dhe mbajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të burimeve njerëzore ekzistuese, mes të cilave edhe programi “*Administrata që duam*”, Programi i Ekselencës në administratë⁴⁶ dhe programi “*Qelizat e Reja/Young Cells*”.

Paralelisht ka vijuar zhvillimi i programeve të trajnimit për hyrjen në administratë, si dhe programe të tjera trajnimi sipas kërkesave të institucioneve dhe bazuar në rezultatet e Vlerësimit të Nevojave për Trajnim, të referuara nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) si ofruesi kryesor i trajnimeve për administratën publike. Krahas kësaj, janë zhvilluar edhe trajnime të organizuara nga vetë institucionet dhe ofrues të tjerë trajnimesh. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim ka pasur edhe Shkolla Rajonale e Administratës Publike (ReSPA), e cila ka ndihmuar në organizimin e shkëmbimeve të eksperiencave rajonale, seminareve dhe vizitave studimore të zhvilluara përgjatë kësaj periudhe.



⁴⁵ OECD/SIGMA, Raport Monitorimi: Parimet e Administratës Publike – Shqipëria, 2024, www.sigmaweb.org

⁴⁶ Miratuar me VKM Nr. 586, datë 30.08.2019, “Për punësimin e përkohshëm të studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore”, i ndryshuar.

Platforma online e trajnimit është pasuruar në vazhdimësi me module trajnimi. Aktualisht, platforma LMS (*Learning Management System*) është në proces përmirësimi, mbështetur financiarisht nga Këshilli i Evropës, me synim garantimin e ofritit të përmirësuar të kurrikulave të trajnimit, si dhe mundësimin e vlerësimit të nevojave për trajnim në mënyrë digjitale për zhvillimin e vazhduar profesional të nëpunësve.

Si pjesë e prioriteteve të Qeverisë Shqiptare për zhvillimin e kapaciteteve në administratën publike dhe në kuadër të Paketës së Motivimit, përgjatë vitit 2024 u organizua për herë të parë edhe një program i dedikuar për Zhvillimin e Liderimit. Programi i konceptuar për drejtuesit e lartë menaxherialë (TND) mundësoi trajnimin e 267 drejtuesve të Administratës Shtetërore, duke përfshirë Drejtorët e Drejtorive dhe Drejtorët e Përgjithshëm të institucioneve të varësisë së ministrive të linjës, me synimin për të sjellë një ndikim të qëndrueshëm në kulturën e udhëheqjes dhe menaxhimit të burimeve njerëzore në administratën publike.⁴⁷

Sfidat

Duke konsideruar rëndësinë e menaxhimit efikas të shërbimit civil dhe burimeve njerëzore në institucionet shtetërore, si një prioritet dhe parakusht për suksesin e negociatave për anëtarësim në BE, për këtë Qëllim të Politikës shtrohen një sërë sfidash për adresim në vitet në vijim.

Një ndër sfidat kryesore mbetet zbatimi i qëndrueshëm dhe efektiv i ligjit të shërbimit civil, me synimin për të garantuar që rekrutimet dhe promovimet të kryhen bazuar në meritë, konkurrencë dhe transparencë për të gjitha nivelet e nëpunësve, me fokus të veçantë Trupën e Nivelit të Lartë Drejtues. Ndryshimet ligjore të ligjit nr. 152/2023 “Për nëpunësin civil”, të parashikuara në zbatim të këtij Qëllimi të Politikës do të adresojnë këto sfida, si dhe do të garantojnë rritjen e efikasitetit të menaxhimit të shërbimit civil në përputhje me zhvillimet më të fundit të kornizës ligjore dhe institucionale në vend, mes të tjerash edhe si rrjedhojë e procesit intensiv të integritimit evropian.

Gjithashtu, me ritmin e shpejtë të digjitalizimit të qeverisjes, është e nevojshme që administrata publike të rrisë kapacitetet për të menaxhuar proceset e punës me efikasitet dhe për të ofruar shërbime elektronike cilësore për publikun. Automatizimi i sistemit të pagave dhe implementimi i sistemeve elektronike për menaxhimin e burimeve njerëzore janë hapa të rëndësishëm drejt arritjes së këtij qëllimi, bashkërisht me përmirësimin e ndërveprueshmërisë dhe komplementaritetit midis platformave ekzistuese. Këto përpjekje do të garantojnë që politikat kombëtare të burimeve njerëzore të bazohen në të dhëna, si dhe do të mundësojnë mbledhjen e të dhënave të sakta nga Njësitë përkatëse të Burimeve Njerëzore për të gjithë nëpunësit publike.

Krijimi i një shërbimi publik tërheqës, inovativ dhe konkurrues në treg mbetet një prioritet kryesor, i cili do të adresohet më tej përmes integritimit të mëtejshëm të inovacionit në punën e përditshme të administratës publike, si dhe përmes rritjes së motivimit të punonjësve, duke promovuar kapitalin njerëzor me profesionalizëm dhe integritet. Në vazhden e këtyre përpjekjeve, reforma e suksesshem e rritjes së pagave në shërbimin civil duhet të avancojë me adresimin e çështjeve sistematike në klasifikimin e vendeve të punës, progresionin e pagave dhe shtesat e veçanta.

Vëmendje e posaçme duhet të kushtohet gjithashtu për zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator të etikës dhe integritetit, si pjesë e procesit më të gjerë të menaxhimit të përmirësuar të burimeve njerëzore, në

⁴⁷ Programi përfshinte katër module themelore që fokusoheshin në zhvillimin e aftësive drejtuese dhe praktikave menaxheriale efektive: Moduli 1 – Parimet themelore të liderimit; Moduli 2 – Teknikat e Menaxhimit Strategjik; Moduli 3 – Zhvillimi i kulturës së liderimit; dhe Moduli 4 – Fuqizimi dhe mbështetja e ekipit.

përputhje me Udhërrëfyesin e Reformës në Administratën Publike 2023-2030, bazuar në një analizë gjithëpërfshirëse të burimeve njerezore.

Përmes adresimit të këtyre sfidave përgjatë viteve në vijim, synohet që administrata publike shqiptare të pajiset me aftësitë e nevojshme për të përballur suksesshëm kërkesat e procesit të integritimit evropian, përfshirë harmonizimin e politikave dhe proceseve me standardet e BE-së. Fuqizimi i koordinimit ndërinstitucional do të jetë një aspekt kyç në këtë drejtim për përmbushjen e angazhimeve që lindin nga ky proces historik dhe transformativ për sektorin publik shqiptar.

2.3 Arritjet dhe sfidat në ofrimin e shërbimeve të digjitalizuara

Shqipëria ka bërë përpjekje serioze për të digjitalizuar një sërë aspektesh të shërbimeve publike, duke përfshirë një numër projektesh që lidhen me qeverisjen elektronike, të cilat synojnë rritjen e efikasitetit, transparencës dhe qasjes së publikut. Në përgatitjen e Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2015-2022, iu dedikua vëmendje e posaçme edhe komponentit teknologjik, që u integrua me të gjitha shtyllat e Strategjisë. Në përfundim të zbatimit të Strategjisë për periudhën 2015-2022, zhvillimet në mënyrën e ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve dhe bizneseve përmes teknologjisë së informacionit janë të matshme dhe të prekshme në lehtësimin e kontaktit të përditshëm të qytetarëve me institucionet publike.

Përgjatë kësaj periudhe, Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë një seri nismash ligjore dhe investimesh të konsiderueshme për të implementuar sistemet elektronike, për të rritur numrin e sistemeve elektronike të lidhura në platformën qeveritare të ndërveprimit, për të shtuar shërbimet elektronike në platformën qeveritare e-Albania dhe infrastrukturat fizike, si dhe për të mundësuar vënien në funksion të nënshkrimit dhe vulës elektronike. Puna në këtë drejtim udhëhiqet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) dhe nga Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje (ADB).

Në raportin më të fundit të vitit 2024, Komisioni Evropian ka njohur se zbatimi i Agjendës Digjitale 2022-2026 dhe Planit të Veprimit po vijon me sukses.⁴⁸ Deri në tetor 2024, platforma unike qeveritare e-Albania ofron 1247 shërbime publike (rreth 95% e të gjitha shërbimeve publike), krahasuar me vetëm 14 të tilla apo 1% që ofroheshin në vitin 2013. Ky transformim është përkthyer në ulje të konsiderueshme të kostove të marrjes së shërbimeve, lehtësim të procedurave burokratike, reduktim të kohës së marrjes së shërbimeve, rritjes së transparencës dhe cilësisë së ofrimit. Të gjitha shërbimet elektronike të ofruara aktualisht janë të kategorizuara “Nivel 4”, sipas niveleve të automatizimit të shërbimeve të UNPAN-it. Platforma mundëson edhe shkarkimin në kohë reale të 92 dokumenteve administrative me vulë elektronike dhe vlerë ligjore. Mbi 3.2 milionë qytetarë dhe biznese janë të regjistruar në Portalin e-Albania dhe shërbehen çdo ditë përmes platformës e-Albania.

Digjitalizimi është tashmë një proces i pakthyeshem i punës së përditshme të çdo institucioni shqiptar. Viti 2022 shënoi një ndryshim rrënjësor në shërbimin e administratës publike ndaj qytetarëve dhe bizneseve, kur prej majit u mundësua që për të gjitha shërbimet publike për të cilat aplikohet në portalin e-Albania, përgjigja/dokumenti administrativ final të dërgohet elektronikisht në llogarinë e çdo qytetari/biznesi në e-Albania me vulë ose nënshkrim elektronik, përmes Sistemit të Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik (SQDNE). Shërbimet publike ofrohen elektronikisht, pa kosto shtesë, pa pritje në radhët e sporteve të institucioneve, dhe pa pasur asnjë kontakt fizik me punonjësit e administratës publike. Në këtë

⁴⁸ Komisioni Evropian, Raporti për Shqipërinë 2024, tetor 2024, f. 27. https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania%20Report%202024.pdf

mënyrë shmanget plotësisht kontakti i drejtpërdrejtë fizik i qytetarëve dhe bizneseve me institucionet publike dhe rrjedhimisht shmangen mundësitë për korrupsion.

Eliminimi i sporteve fizike solli një rritje të ndjeshme të numrit të shërbimeve të marra përmes portalit e-Albania. Për vitin 2023, janë marrë përmes e-Albania 13.5 milionë shërbime publike, si dhe janë gjeneruar 8.7 milionë dokumente me vulë elektronike. Në të njëjtën kohë, çdo shërbim dhe përgjigje e administratës monitorohet në kohë reale dhe sportelet janë reduktuar në mënyrë drastike. Të vetmet që mbeten të hapura janë ato ku prezenca fizike e qytetarit është e detyrueshme (në rastet e martesave, regjistrimi i shenjave të gishtave gjatë aplikimit për pasaportë ose kartë identiteti, dhe kontrolli i automjetit). Gjithashtu përmes sistemit SQDNE është bërë i mundur monitorimi në kohë reale i punës së administratës për kthimin e përgjigjeve dhe afatet e ofrimit të shërbimeve, duke mundësuar gjithashtu matjen e punës së administratës me transparencë të plotë. Aktualisht, në modulën e Administratës Publike dhe Sistemit të Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik për gjenerimin e dokumenteve me vulë elektronike dhe marrjen e dokumenteve shoqëruese për plotësimin e dosjes së aplikantëve, janë të konfiguruar 186 institucione dhe mbi 7000 përdorues. Gjithashtu, Qeveria Shqiptare është duke punuar paralelisht për përfshirjen e *life events dhe shërbimeve proaktive si modalitete të ofruara në portalin e-Albania*.

Portali e-Albania është i ndërlidhur edhe me Platformën Qeveritare të Ndërveprimit, që është arkitektura bazë që mundëson ndërlidhjen e regjistrave elektronikë me njëri-tjetrin dhe shkëmbimin e të dhënave në kohe reale në formë të sigurt dhe të besueshme. Përgjatë këtyre viteve, kjo Platformë ka bërë të mundur thjeshtimin e shërbimeve që institucionet publike ofrojnë për qytetarët, bizneset dhe administratën publike, si dhe uljen ndjeshëm të numrit të dokumenteve që i kërkojnë qytetarit apo biznesit për marrjen e shërbimeve publike.

Përparimi domethënës i viteve të fundit në drejtim të digjitalizimit të regjistrave bazë dhe ndërveprueshmërisë, si dhe të gjitha elementeve kryesorë që mundësojnë qeverisjen digjitale vlerësohet si një aspekt pozitiv nga OECD/SIGMA në raportin e saj të fundit të monitorimit të vitit 2024.⁴⁹ Falë integritit të 63 regjistrave elektronikë deri më tani, Platforma Ndërqeveritare e Ndërveprimit mundëson që aktualisht 68% e fushave në formularët e aplikimeve në shërbimet publike në e-Albania të parambushen nga komunikimi në kohë reale i regjistrave elektronike të institucioneve të ndryshme me njëri-tjetrin. Në tetor 2023, Qeveria Shqiptare përafroi Kornizën Kombëtare të Ndërveprueshmërisë me Kornizën Evropiane të Ndërveprueshmërisë (EIF) të miratuar në vitin 2017, në një proces përafrimi që Komisioni Evropian inkurajon të vijojë më tej me harmonizimin me Aktin e ri të Evropës Ndërvepruese të hyrë në fuqi në prill 2024.⁵⁰

Që prej vitit 2017, kur u njoh ligjërisht vlera e vulës elektronike, e deri në gusht 2024 janë gjeneruar mbi 34 milionë dokumente me vulë elektronike, përkthyer kjo në kursime në kohë dhe kosto për qytetarët dhe bizneset. Konkretisht Portali e-Albania u ka kursyer qytetarëve dhe bizneseve mbi 1,110 vite pritje në radhë për marrjen e dokumenteve shtetërore me vulë elektronike, si dhe rreth 13.8 milionë EUR kosto nga heqja e tarifave të këtyre dokumenteve që ofrohen tashmë pa pagesë në platformë në version elektronik. Ky transformim rrënjësor vlerësohet edhe nga OECD/SIGMA, e cila thekson se cilësia e ofrimit të shërbimeve është rritur gjatë viteve të fundit falë digjitalizimit dhe thjeshtësimit të procedurave, teksa shumica e

⁴⁹ OECD/SIGMA, Raport Monitorimi: Parimet e Administratës Publike – Shqipëria, 2024, www.sigmaxweb.org

⁵⁰ Komisioni Evropian, Raporti për Shqipërinë, 2024, f. 27, https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania%20Report%202024.pdf

qytetarëve të anketuar nga SIGMA kanë raportuar se janë të kënaqur me ndërveprimin e tyre të fundit me shërbimet publike.⁵¹

Paralelisht këtyre zhvillimeve, në qershor të vitit 2023 u miratua ligji nr. 43/2023 “Për Qeverisjen Elektronike”, i cili përcakton të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e autoriteteve publike dhe subjekteve private në lidhje me krijimin, zhvillimin dhe manaxhimin e sistemeve të infrastrukturës së informacionit, detyrimin e tyre për zbatimin e standardeve të teknologjisë së informacionit, përcaktimin e rregullave për krijimin dhe ofrimin e shërbimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë, si dhe aksesin, përpunimin dhe protokollimin e dokumentit elektronik.

Një prioritet kyç i Qeverisë Shqiptare në thellimin e agjendës për shërbime publike të aksesueshme dhe efikase mbetet thjeshtimi administrativ dhe reduktimi i barrës administrative në marrjen e shërbimeve. Në këtë drejtim, një Grup i dedikuar Ndërinstitucional Pune për Rregullimin e Procedurave Administrative në Funksion të Shërbimeve Publike të Ofruara për Qytetarët dhe Bizneset u krijua me vendim të Këshillit të Ministrave në dhjetor 2023. Grupi i Punës bashkëkryesohet nga Ministria e Drejtësisë (MD) dhe Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit (MSSKB), duke reflektuar angazhimin e lartë qeveritar për ri-inxhinierimin e suksesshëm administrativ. Procesi i derregullimit ka përfunduar tashmë për tre ministri, me 81 nga 151 shërbime të thjeshtuara dhe 134 nga 379 kërkesa administrative të eliminuara.

Zhvillimet e mësipërme kanë mundësuar garantimin e një performance shumë të kënaqshme të Shqipërisë në Indeksin e Zhvillimit të Qeverisjes Elektronike (EGDI), si i vetmi indeks global mbi qeverisjen elektronike, i cili e rendit Shqipërinë në vendin e 62-të në rang botëror për vitin 2024, një përmirësim i ndjeshëm nga renditja në vendin e 82-të në vitin 2016.⁵² Gjithashtu, Shqipëria renditet e 46-ta në botë sa i përket indikatorit *Online Service Index (OSI)*.

Sfidat

Raporti më i fundit nga Komisioni Evropian për vitin 2024 njeh përpjekjet që janë bërë nga Shqipëria në për zgjerimin e digitalizimit të shërbimeve publike, si dhe thekson nevojën për të siguruar qasje të barabartë në këto shërbime për qytetarët me njohuri të kufizuara në fushën e teknologjisë së informacionit apo qasje të kufizuara në mjetet teknologjike, të cilat e vështirësojnë marrjen e këtyre shërbimeve.⁵³ Në këtë drejtim, objektivat dhe masat e parashikuara nën këtë shtyllë të Strategjisë kanë për qëllim pikërisht përmirësimin e këtyre gjetjeve dhe minimizimin e hendekut mes qytetarëve e bizneseve dhe aksesit të tyre në shërbime.

Gjithashtu, masat synojnë të adresojnë edhe fragmentarizimin e kuadrit për politikën e ofrimit të shërbimeve si një gjetje e evidentuar në Raportin e vitit 2024 nga SIGMA.⁵⁴ Ndër masat prioritare që duhet të ndërmerren në këtë drejtim theksohet nevoja për krijimin e një mekanizmi të përhershëm koordinimi ndërinstitucional, i cili do të sigurojë një qasje të integruar për hartimin dhe ofrimin e shërbimeve publike në tërësi. Një tjetër prioritet i rëndësishëm është përmirësimi i platformës e-Albania, duke garantuar, mes të tjerash, edhe mbledhjen dhe analizimin e rregullt të të dhënave mbi përdorimin e saj bazuar në përkufizime dhe kritere të mirëpërcaktuara, përfshirë shkallën e përfundimit të proceseve, kohën e kërkuar për navigim drejt shërbimeve të duhura dhe kohën e nevojshme për plotësimin e formularëve. Këto

⁵¹ OECD/SIGMA, Raport Monitorimi: Parimet e Administratës Publike – Shqipëria, 2024, www.sigmaxweb.org

⁵² United Nations, E-Government Development Index 2024, <https://publicadministration.un.org/egovkb/en-us/Data/Country-Information/id/2-Albania/dataYear/2024>

⁵³ Komisioni Evropian, Raporti për Shqipërinë, 2024, f. 27, https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania%20Report%202024.pdf

⁵⁴ SIGMA 2024, f. 90, <https://www.sigmaxweb.org/publications/Public-administration-in-Albania-2024.pdf>

përpyqje do të garantojnë përmirësimin e qëndrueshëm dhe të matshëm në sistemin e qeverisjes digjitale, duke kontribuar në rritjen e efikasitetit dhe përvojës së përdoruesve.

Me qëllim ri-inxhinierimin e shërbimeve, suksesi i deritanishëm i Grupit ekzistues Ndërinstitucional të Punës duhet të konsolidohet në një mekanizëm të përhershëm dhe të dedikuar për reduktimin e barrës administrative përmes analizave të detajuara *ex-ante* të ligjeve dhe rregulloreve dytësore dhe analizave *ex-post* për të identifikuar dhe eliminuar pengesat aktuale që vërehen në praktikë.

Si një tjetër hap drejt konsolidimit të një administrate gjithëpërfshirëse dhe të aksesueshme, aksesimi në ndërtesat publike duhet të garantohet për të gjithë qytetarët përmes politikave të dedikuara për qasje të barabartë në shërbimet publike dhe mbështetje adekuate për grupet e pafavorizuara si në marrjen e shërbimeve digjitale, ashtu edhe për ndërveprimet e nevojshme fizike për marrjen e tyre.

Puna për adoptimin e portofolit elektronik (*e-wallet*) dhe mjeteve të tjera inovative mbetet një tjetër angazhim prioritar që premtion të lehtësojë qasjen e qytetarëve në shërbime të personalizuar dhe të sigurta, duke fuqizuar më tej harmonizimin e vendit me standardet digjitale europiane. Paralelisht, mbetet një sfidë për adresim edhe garantimi i ripërdorimit të zgjidhjeve digjitale nga institucionet publike që aktualisht janë jashtë fushës së kompetencave të AKSHI-t, me synim mundësimin e ripërdorimit të tyre në mënyrë sa më efikase dhe të mirëkoordinuar.

Gjithashtu, për të garantuar një përdorim të plotë dhe efektiv të shërbimeve digjitale, duhet të ndërmerren hapa për fuqizimin e aftësive digjitale të qytetarëve dhe punonjësve të administratës publike, duke siguruar rritjen e ndërgjegjësimit për higjienën kibernetike, si dhe avantazhet dhe rreziqet e përdorimit të teknologjisë. Një masë e rëndësishme dhe komplementare në këtë drejtim paraqitet forcimi i masave për sigurinë digjitale, duke vendosur standarde më të larta në sigurinë kibernetike dhe duke garantuar privatësinë e qytetarëve në të gjitha ndërveprimet e tyre digjitale.


2.4 Arritjet dhe sfidat në organizimin, llogaridhënien dhe mbikëqyrjen e administratës

Organizimi dhe funksionimi i administratës publike mbështetet dhe rregullohet nga ligji nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, i cili përcakton tipologjinë e institucioneve dhe marrëdhëniet e funksionimit mes tyre. Ligji ka parashikuar mekanizmin për garantimin e efikasitetit të strukturave organizative, nëpërmjet centralizimit të funksionit të përgatitjes së mënyrës së organizimit të institucioneve të administratës shtetërore në një institucion të vetëm, përkatësisht Departamentin e Administratës Publike. Ligji gjithashtu përcakton Kryeministrin si autoritetin që gëzon përgjegjësinë shtetërore për miratimin e strukturave organizative. Ky mekanizëm synon të unifikojë mënyrën e organizimit të Ministrive të linjës, të garantojë respektimin e rregullave të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe të shmangë përsëritjen e funksioneve.

Përgjatë kësaj periudhe zbatimi nga miratimi i tij, ligji ka mundësuar disiplinimin e mënyrës së organizimit dhe funksionimit të institucioneve shtetërore dhe janë bërë disa ndërhyrje të mëdha në disa sisteme ministrore (shëndetësia, arsimit, turizmi dhe mjedisi, bujqësia). Mekanizmi parashikon edhe procedurat që zbatohen për monitorimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve, kryesisht përmes miratimit të programeve dhe raporteve vjetore për institucionet e varësisë nga ministrinë përgjegjëse.

Zbatimi rigoroz sa i takon mënyrës së organizimit dhe funksionimit të institucioneve dhe disa ndërhyrje të thella në disa sisteme ministrore të shëndetësisë, arsimit, turizmit dhe mjedisit, dhe bujqësisë parashikojnë procedura për mbikëqyrjen kryesisht përmes detyrimit për miratime paraprake nga to të programeve dhe raporteve vjetore të institucioneve të tyre të varësisë.

Mekanizmat e prezantuara nga miratimi i ligjit nr. 107/2021 “Për Bashkëqeverisjen” sollën një numër risish për bashkëqeverisjen me qytetarët nëpërmjet gjithëpërfshirjes së tyre në politikëbërje, garantimin e pjesëmarrjes së tyre në procedurat administrative vendimmarrëse, si dhe rritjen e llogaridhënies së administratës shtetërore përmes platformës “Me ty për Shqipërinë që duam”. Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje (ADB) ndjek dhe menaxhon ankesat e depozituara nga qytetarët përmes platformës eshqipëriaqeduam.al. Rubrika “Denonco korrupsionin” në platformë shërben si një nga mekanizmat në dispozicion të qytetarëve dhe bizneseve për të raportuar praktikatat korruptive në administratën publike. Pas filtrimit paraprak të bazueshmërisë në prova, raportimet përcillen pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit pranë Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit për hetime të mëtejshme. Grafiku i mëposhtëm pasqyron ankesat/kërkesat e depozituara në platformën Shqipëriaqeduam.al dhe trajtimin e tyre:



Me reformimin tërësor të procesit të ofrimit të shërbimeve për publikun dhe kalimin në shërbime elektronike, është zhvilluar edhe një sistem monitorimi lidhur me cilësinë e ofrimit të shërbimit, afatet kohore të ofrimit dhe raportimin për praktikat e parregullta, apo korruptive. Këto funksione i ka zbatuar Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje (ADB), e cila ka si mision edhe zhvillimin e praktikave të mira dhe përdorimin e tyre në të gjithë administratën shtetërore me qëllim gjithëpërfshirjen e çdo qytetari në politikëbërje.

Në përputhje me Ligjin Nr. 107/2021 “Për Bashkëqeverisjen”, ofrimi i shërbimeve nga të gjitha institucionet ofruese të shërbimeve, aplikimet e të cilave paraqiten përmes platformës e-Albania, realizohet vetëm në mënyrë elektronike, duke garantuar lëshimin e dokumentit zyrtar përfundimtar me nënshkrim ose vulë elektronike. Administrata publike përdor tashmë suksesshëm prej vitit 2020 Sistemin e Qarkullimit të Dokumenteve të Nënshkruara Elektronikisht (SQDNE), i cili është zgjeruar dhe përfshin më shumë funksionalitete që nga maji 2022, për të ofruar dokumente të nënshkruara elektronikisht për qytetarët, të cilat mund të shkarkohen nga llogaria e qytetarit në *e-Albania*.⁵⁵ Sistemi pakëson barrën e qytetarëve dhe bizneseve për të marrë dokumente dhe vërtetime nga institucionet e administratës publike, të cilat sigurojnë tashmë plotësimin me dokumentacion të të gjithë dosjes së aplikimit. Gjithashtu, ky sistem mundëson mbikëqyrjen e përditshme të shërbimeve që ofrohen nga institucionet shtetërore dhe respektimit të afateve administrative.

Kodi i Procedurave Administrative (KPA), miratuar me ligjin Nr. 44/2015, ofron një kornizë ligjore moderne për funksionimin e administratës publike, si dhe për menaxhimin e ankesave dhe kërkesave që paraqiten kundrejt institucioneve publike. Miratimi i Kodit solli si nevojë përshtatjen e legjislacionit të posaçëm me procedurat dhe afatet e reja kohore. Përgjatë periudhës së zbatimit të strategjisë u hartua një metodologji për vlerësimin e përputhshmërisë dhe u analizuan rreth 1500 akte ligjore dhe nënligjore. Teksa pjesa madhore e akteve është përshtatur me dispozitat e Kodit, janë identifikuar edhe 65 akte të mbetura në

⁵⁵ Miratuar me VKM Nr. 43, datë 15.01.2020 “Për funksionimin e procesit të shkëmbimit të dokumenteve ndërmjet institucioneve, nëpërmjet Sistemit të Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik”.

nevojë për harmonizim, për të cilat është hartuar një program i detajuar me afatet kohore për të siguruar përputhshmërinë e plotë të tyre me KPA brenda vitit 2025, në zbatim të angazhimit të ndërmarrë në Udhërrëfyesin për Reformën në Administratën Publike 2024-2030.

Në drejtim të transparencës institucionale, korniza ligjore vendase vlerësohet nga Komisioni Evropian si gjerësisht e përafuar me standardet evropiane.⁵⁶ Gjithashtu, sipas Indeksit të Transparencës 2024 të publikuar nga Qendra Kërkimore Evropiane për Antikorrupsionin dhe Shtetndërtimi, Shqipëria ka një rezultat prej 73%, duke tejkaluar mesataren globale prej 61% dhe mesataren rajonale prej 67% në drejtim të përmbushjes së detyrimeve dhe standardeve të transparencës. E drejta e çdo qytetari për të kërkuar informacion nga institucionet e administratës publike rregullohet nga ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (LDI). Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave mbikëqyr dhënien e informacionit publik dhe adreson ankesat në lidhje me aksesin në informacion.

Ndryshimet më të fundit të ligjit të miratuara me ligjin nr. 78/2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 ‘Për të drejtën e informimit’” janë fokusuar në elementet më jetike për efikasitetin e procesit. Konkretisht, ndryshimet ligjore kanë sanksionuar shtesën e pagës për punonjësit e caktuar si koordinatorë për të drejtën e informimit, për të siguruar motivimin e tyre për kryerjen në mënyrë efektive të kësaj detyre që u shtohet kompetencave të tyre funksionale. Gjithashtu, është rishikuar kufiri minimal i sanksioneve, duke vendosur një marrëdhënie më të drejtë dhe proporcionale me të ardhurat në administratën publike. Mes risive më domethënëse, ligji ka zgjeruar listën e rrethanave që shkaktojnë përgjegjësi për titullarin e institucionit, duke kufizuar përgjegjësinë e koordinatorit për informim vetëm për shkeljet e procesit që varen drejtpërdrejt nga detyrimet e tij. Ky ndryshim adreson edhe gjetjen e përsëritur të Raportit të Komisionit Evropian dhe njëherësh Misionit të Vlerësimit (*Peer Review Mission*) që ka asistuar institucionin e Komisionerit për procesin amendues lidhur me ndarjen më të mirë menduar të përgjegjësisë për shkeljet në garantimin e së drejtës për akses në informacion. Ndryshimet ligjore kanë shtruar kështu terrenin për garantim më efikas të së drejtës së informimit përmes përshtatjes së ligjit me realitetin institucional dhe hierarkinë e proceseve brenda administratës publike shqiptare.

Në vijim të punës për përafrimin me standardet evropiane, Shqipëria ratifikoi me ligjin nr. 45/2022 Konventën e Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumentet zyrtare”, si dhe miratoi ligjin Nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik” duke i shtuar një kompetencë të re Zyrës së Komisionerit për mbikëqyrjen dhe promovimin e kësaj të drejte.⁵⁷ Përmes këtij ligji, garantohet një politikë e qartë dhe specifike në këtë drejtim, duke nxitur disponueshmërinë e gjerë dhe mundësinë e ripërdorimit të informacionit të sektorit publik për qëllime private dhe komerciale. Në këtë drejtim, kuadri i plotë dhe bashkëkohor ligjor e rendit Shqipërinë të gjashtë në rang botëror për cilësinë e garancive maksimale që ai ofron për ushtrimin e saj në praktikë.⁵⁸

Krahas portalit të qeverisjes elektronike *e-Albania*, i cili ofron mundësinë për të kërkuar informacion publik dhe për të paraqitur ankesa në rast të refuzimit të dhënies së tij, qasja në informacion mundësohet edhe përmes Regjistrisë Elektronike të Kërkesave dhe Përgjigjeve mbi të Drejtën për Informim, i cili mundëson

⁵⁶ Komisioni Evropian, Raporti për Shtetin e së Drejtës – Shqipëria, 2024, f. 18, https://commission.europa.eu/document/download/0154dce1-5026-45de-8b37-e3d56eff7925_en?filename=59_1_58088_coun_chap_albania_al.pdf

⁵⁷ Ligji mund të aksesohet në linkun <https://www.idp.al/wp-content/uploads/2024/02/Per-te-dhenat-e-hapura-dhe-riperdorimin-e-informacionit-te-sektorit-publik.pdf>

⁵⁸ Country Economy, Global Right to Information Rating, <https://countryeconomy.com/government/global-right-information-rating/albania>

qasjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve dhe palëve të interesuara në informacionin publik, i ngritur në vitin 2018 dhe i instaluar në 247 autoritete publike deri në vitin 2024.

Gjithashtu, në përputhje me nenin 7 të ligjit nr. 119/2014, i ndryshuar, numri i autoriteteve publike që kanë detyrim të zbatojnë Programin e Transparencës është rritur nga 145 institucione në vitin 2015 në 332 në vitin 2024. Programet e Transparencës përditësohen periodikisht, në përputhje me Nenin 5/pika 2 të LDI-së. Informacioni i publikuar në këtë program synon të garantojë transparencën e punës së institucioneve përmes pasqyrimin të detajuar të informacionit të përditësuar në faqet zyrtare të autoriteteve publike.

Në drejtim të integritetit dhe etikës së nëpunësve të administratës publike, ligji kryesor është ligji rr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, i cili zbatohet për të gjithë nëpunësit e administratës publike, përveç rasteve kur ligjet e tjera parashikojnë përjashtime, dhe po ashtu përfshijnë personat e punësuar nga sektorët privatë që ofrojnë shërbime publike. Procedimet disiplinore rregullohen gjithashtu nga ligji nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Sipas rezultateve të anketës së nëpunësve civilë të realizuar nga SIGMA në vitin 2024, udhëzimet etike janë të qarta dhe të kuptueshme.⁵⁹

Në zbatim të ligjit nr. 9131/2003, ka hyrë në fuqi në vitin 2021 Vendimi Nr. 874, datë 29.9.2021, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për zbatimin e parimeve të etikës, klasifikimin e aktiviteteve të jashtme dhe përcaktimin e vlerës së dhuratave të pranueshme gjatë punësimit në administratën publike”, i cili shfuqizoi VKM Nr. 714, datë 22.10.2004, “Për veprimtarinë e jashtme dhe dhënien e dhuratave gjatë veprimtarisë së nëpunësit në administratën publike”. VKM Nr. 874/2021 vendos standarde për të rregulluar aktivitetet e jashtme, përfshirë edhe punësimin dytësor.

Në përputhje me kornizën ekzistuese ligjore, një numër institucionesh kanë miratuar Kodet e tyre përkatëse të Etikës/Sjelljes për të standardizuar dhe përforcuar sjelljen etike të nëpunësve. Në zbatim të Udhërrëfyesit për Reformën në Administratën Publike 2023-2030, përgjatë zbatimit të masave të parashikuara nën SNRAP 2024-2030, do të miratohen aktet rregullatore në zbatim të VKM nr. 874/2021 që do të konsolidojnë kuadrin rregullator dhe do të sigurojnë një proces të standardizuar për monitorimin dhe zbatimin e rregullave etike në administratën publike.

Mbikëqyrja e administratës nga institucionet e pavarura është zhvilluar sipas praktikave tashmë të konsoliduara. Avokati i Popullit dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit luajnë një rol jetik në sigurimin e administrimit dhe mbikëqyrjes së mirë, bashkërisht me institucionet e tjera të pavarura si Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Autoriteti i Konkurrencës.

Gjithashtu, sikurse evidentuar në Raportin e Monitorimit nga SIGMA (2024), janë ngritur të gjitha procedurat për të garantuar një kontroll efektiv parlamentar mbi vendimmarrjen e qeverisë.⁶⁰ Në zbatim të Vendimit Nr. 49/2017 të Kuvendit “Për Krijimin e një Mekanizmi për Monitorimin Sistematik të Ndjekjes dhe Zbatimit të Rekomandimeve të Institucioneve Kushtetuese të Pavarura dhe atyre të Krijuara me Ligj”, si dhe Vendimit Nr. 134/2018 “Për Miratimin e Manualit të Monitorimit Vjetor dhe Periodik”, është rritur edhe roli i Parlamentit në ushtrimin e mbikëqyrjes ndaj ekzekutivit për këto çështje. Në emër të pushtetit ekzekutiv, Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin monitoron zbatimin e rekomandimeve të institucioneve të pavarura pjesë të këtij Mekanizmi, duke nxitur dhe monitoruar periodikisht zbatimin e rekomandimeve të institucioneve të pavarura për administratën publike.

⁵⁹ SIGMA 2024, f. 88, <https://www.sigmaxweb.org/publications/Public-administration-in-Albania-2024.pdf>

⁶⁰ SIGMA 2024, f. 39, <https://www.sigmaxweb.org/publications/Public-administration-in-Albania-2024.pdf>

Sfidat

Për të adresuar me sukses sfidat dhe për të përmbushur objektivat ambicioze drejt një administrate publike të standardeve evropiane, raportet periodike të organizatave partnere si Komisioni Evropian dhe OECD/SIGMA ofrojnë një pasqyrë të qartë të aspekteve që kërkojnë përmirësim dhe nxisin nevojën për reforma të qëndrueshme në kuadër të rritjes së llogaridhënies, organizimit efikas dhe mbikëqyrjes efektive të administratës publike.

Me qëllim organizimin e administratës publike në mënyrë efikase në të gjitha nivelet e qeverisjes, përmes rishikimit të nisur tashmë të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të administratës publike”, duhet të përcaktohet një tipologji e qartë organizative për organet e qeverisë qendrore dhe institucioneve të varësisë. Njëherësh, rishikimi i ligjit nr. 90/2012 duhet të adresojë në mënyrë ezauruese krijimin e një kuadri të qartë llogaridhënieje dhe transparence për planifikimin e punës dhe raportimin mbi progresin e saj për ministrinë dhe për institucionet e varësisë, me fokus të veçantë nevojën për përmirësimin e kuadrit ligjor për garantimin e llogaridhënies menaxheriale. Puna duhet të vijojë edhe në drejtim të garantimit të llogaridhënies së jashtme nga institucionet e pavarura mbikëqyrëse, duke nxitur institucionet publike që dështojnë sistematikisht të përgjigjen ose të zbatojnë rekomandimet e tyre. Në këtë proces, Kuvendi dhe administrata publike duhet të rrisin bashkëpunimin, me synim rritjen e numrit të rekomandimeve të zbatuara.

Në kuadër të punës për institucione publike të hapura dhe transparente, vëmendje e vijueshme duhet t’i dedikohet plotësisht të kuadrit rregullator për garantimin në praktikë të së drejtës për informim, si dhe konsolidimit të qasjes proaktive të autoriteteteve publike për publikimin e informacionit zyrtar dhe kthimin e përgjigjeve kundrejt kërkesave të qytetarëve dhe bizneseve. Funksionimi i procedurave administrative duhet të trajtohet si një tjetër dimension kyç, përmes mbledhjes dhe analizimit të rregullt të të dhënave mbi kohëzgjatjen, numrin e apelimeve dhe rezultatet e çështjeve gjyqësore, me synim identifikimin e sfidave dhe ndërmarrjen e masave të nevojshme për t’i adresuar ato.

Duke konsideruar rëndësinë e integritetit dhe etikës së stafeve dhe proceseve në vizionin e gjerë të ndërtimit të institucioneve llogaridhënese, masat e parashikuara nën SNRAP 2024-2030 duhet të garantojnë komplementaritet me parashikimet e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030 për të adresuar sfidat ndaj integritetit të sektorit publik. Plotësimi i kuadrit rregullator për zbatimin e rregullave të etikës dhe rritja e kapaciteteve institucionale të Njësive të Burimeve Njerëzore për të monitoruar zbatimin e tyre duhet të marrin fokus të veçantë në këtë drejtim.

2.5 Arritjet dhe sfidat drejt një administrate të gjelbër publike

Koncepti i “*Administratës së Gjelbër Publike*” u referohet proceseve të vendimmarrjes në të gjitha nivelet e qeverisjes (ndërkombëtare, kombëtare dhe lokale) të cilat integrojnë çështjet mjedisore dhe të ndryshimeve klimatike, me synimin për të kontribuar në arritjen e një mjedisi të pastër, të shëndetshëm dhe që zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme për të gjithë, në përputhje me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe detyrimet e vendit sipas Marrëveshjes së Parisit. Vetë termi është pjesë integrale e Rekomandimit të Këshillit të Evropës CM/Rec(2023)5 mbi “*Parimet e Qeverisjes së Mirë Demokratike*”,⁶¹ ku parimi i qëndrueshmërisë dhe qasja afatgjatë (Parimi 11) parashikon shprehimisht se vendet duhet të

⁶¹ <https://rm.coe.int/0900001680abeb87>

përpiqen të maksimizojnë vendimet dhe veprimet e qëndrueshme të qeverisë, institucioneve publike dhe zyrtarëve publikë, duke marrë në konsideratë ndikimin e tyre te brezat e ardhshëm.

Në këtë këndvështrim, reduktimi i gjurmës mjedisore të aseteve, investimeve dhe burimeve nën menaxhim nga shteti mund të ketë ndikim thelbësor në klimë dhe qëndrueshmëri. Menaxhimi i gjelbër i financave publike shërben si një lehtësues thelbësor për një strategji të unifikuar të Qeverisë Shqiptare në adresimin e ndryshimeve klimatike. Një përdorim më i madh i mjeteve të buxhetimit të gjelbër do të ndihmojë në ridrejtimin e investimeve publike, konsumit dhe taksave drejt prioriteteve të gjelbra dhe larg subvencioneve të dëmshme. Krahas kësaj, gjelbërimi i administratës publike ka potencialin të ketë efekte të ndjeshme në promovimin e inovacionit, efikasitetit, efektivitetit, reduktimit të kostove, si dhe ofrimin të shërbimeve më cilësore për qytetarin.

Në Shqipëri, ligji aktual nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar në vitin 2024, vendos detyrime për autoritetet kontraktore që të respektojnë kërkesat e legjislacionit mjedisor, social dhe të punës. Për sa i përket aspektit të politikave, Agjencia e Prokurimit Publik publikoi një Udhërrëfyes të prokurimit të Gjelbër (që përshkruan rregullat për zbatimin vullnetar), si dhe një metodologji të dedikuar⁶² në lidhje me GPP-të, e cila ofron udhëzime të përgjithshme dhe udhëzime për kërkesat minimale që duhet të plotësohen. Këto dokumente udhëzuese u miratuan në zbatim të Strategjisë së parë gjithëpërfshirëse Kombëtare të Prokurimit Publik 2020-2023 të miratuar në nëntor 2020.

Gjithashtu, me rishikimin e kuadrit kombëtar strategjik për prokurimin publik, Strategjia Kombëtare e Prokurimit Publik 2024-2030 përfshin objektiva dhe masa të qarta për promovimin dhe zbatimin e prokurimit të gjelbër. Kuadri ligjor në fuqi mbështet kryerjen e prokurimeve të gjelbra, sociale dhe inovative, duke lejuar autoritetet kontraktore të marrin në konsideratë një gamë të gjerë aspektesh gjatë prokurimit të mallrave dhe shërbimeve. Këto aspekte përfshijnë mbrojtjen e mjedisit, përkrahjen e perspektivës sociale, nxitjen e inovacionit dhe rritjen e efikasitetit energjetic. Prokurimi i qëndrueshëm mbetet një objektivi qendror në Strategjinë Kombëtare të Prokurimit Publik 2024-2030,⁶³ në zbatim të të cilit do të ndërmerren përpjekje të targetuara për ndërgjegjësimin dhe mbështetjen e autoriteteve kontraktore në zbatimin efektiv të kritereve të prokurimit të gjelbër.

Teksa Shqipëria përparon drejt anëtarësimit në BE, përafrimi në mënyrë strategjike i politikave dhe praktikave e saj mjedisore me standardet dhe rregulloret e BE-së vijon intensivisht. Përpjekjet për të rritur efikasitetin e përdorimit të energjisë dhe të burimeve, reduktimin e mbetjeve, promovimin e riciklimit dhe zbatimin e nismave miqësore me mjedisin po marrin vemendje të shtuar me çdo cikël politikëbërës, duke reflektuar një angazhim kolektiv për të zbutur gjurmën mjedisore të çdo veprimtarie publike dhe private. Megjithatë, nevojitet që këto përpjekje të intensifikohen për të garantuar përafrimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor me standardet e BE-së (ekoetiketimi, vendosjen e kërkesave të projektimit ekologjik për produktet që lidhen me energjinë, skemat EMAS) për të mbështetur sektorin privat në ofrimin e mallra dhe shërbimeve me një ndikim të reduktuar mjedisor gjatë gjithë ciklit të tyre jetësor, si dhe duke ndihmuar sektorin publik të bëjë zgjedhje vërtet të qëndrueshme.

Për të përfituar nga fuqia blerëse e autoriteteve publike duke rritur ofertën e produkteve dhe shërbimeve miqësore ndaj mjedisit, masat e ndërmarra në vijim do të duhet të përqendrohen në drejtim të trajnimit dhe

⁶² Agjencia e Prokurimit Publik, “Metodologji Udhëzuese për Zbatimin e Prokurimit Publik të Gjelbër në Shqipëri”, e aksesueshme në <https://www.app.gov.al/GetData/DownloadDoc?documentId=92c25399-7384-45d8-8358-613148b7165c>

⁶³ Miratuar me VKM Nr. 304, datë 22.05.2024, dhe e aksesueshme në <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2024/05/22/304/71f1dc00-5677-409d-a3a2-869041ab60db>.

rritjes së shtuar të kapaciteteve institucionale, si dhe zhvillimit të mëtejshëm të kuadrit ligjor që mbështet sektorin privat, me qëllimin afatgjatë krijimin e një sistemi efektiv të prokurimit të gjelbër publik.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm që kërkon vëmendje në drejtim të përpjekjeve për konsolidimin e dimensionit të gjelbër të veprimtarisë së institucioneve publike është edhe përdorimi i teknologjisë së informacionit. Digjitalizimi i proceseve të brendshme të qeverisjes mund të zvogëlojë ndjeshëm konsumin e letrës, energjisë, dhe transportit që shoqëron procedurat administrative. Për një sektor publik që redukton përdorimin e letrës fizike vetiu lind detyra për t'iu përgjigjur më shpejt kërkesave të qytetarëve dhe biznesit, në mënyrë më efikase dhe duke shpenzuar më pak burime. Megjithatë, nga ana tjetër digjitalizimi mund të çojë në nevojën për më shumë pajisje teknologjike dhe konsum më të lartë të energjisë, dhe për rrjedhojë edhe rritje të emetimeve të gazeve me efekt serra. Për këtë arsye, është thelbësore që përpjekjet e ndërmarra dhe ato të parashikuara në drejtim të rritjes së digjitalizimit të veprimtarisë institucionale të shoqërohen edhe me veprime zbutëse për të promovuar, së pari, zgjerimin e përdorimit të energjisë së rinovueshme për të gjeneruar energji elektrike në sektorin TIK, dhe së dyti, përdorimin e zgjidhjeve digjitale të gjelbra më efikase për konsumimin e energjisë në institucionet publike.

3. Vizioni i Strategjisë

Vizioni i Strategjisë Ndërsektorale të Reformës në Administratën Publike 2024-2030 është **konsolidimi i një administratë publike profesionale, efikase, inovative dhe e motivuar, që vepron në përputhje me standardet evropiane dhe parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, dhe që ka aftësinë dhe mjetet e nevojshme në dispozicion për ta përgatitur Shqipërinë për procesin historik të aderimit në Bashkimin Evropian.**

Misioni i Qeverisë Shqiptare drejt realizimit të këtij vizioni është avancimi strategjik i Reformës në Administratën Publike drejt brendësimit gradual të standardeve evropiane në funksionimin e përditshëm të institucioneve publike. Ky mision do të përmbushet përmes zbatimit të një harte masash nën 5 Qëllime kryesore të Politikës, detajuar në pjesën e dytë të këtij dokumenti.

PJESA II – QËLLIMI I POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE TË STRATEGJISË

Strategjia Ndërsektorale e Reformës në Admnsitratën Publike 2024-2030 mbështetet në 5 shtylla kryesore që pasqyrojnë Qëllimet e Politikave përmes të cilave synohet të jetëzohet Vizioni i strategjisë, përkatësisht:

- 1. Qëllimi i Politikës 1: Zhvillimi dhe Koordinimi i Politikave;**
- 2. Qëllimi i Politikës 2: Shërbimi Civil dhe Menaxhimi i Burimeve Njerëzore;**
- 3. Qëllimi i Politikës 3: Ofrimi i Shërbimeve dhe Digjitalizimi;**
- 4. Qëllimi i Politikës 4: Organizimi, Llogaridhënia dhe Mbikëqyrja e Administratës;**
- 5. Qëllimi i Politikës 5: Administrata e Gjellbër Publike.**

Qëllimi i Politikës 1 - Zhvillimi dhe Koordinimi i Politikave

Qëllimi i Politikës 1 synon të sigurojë që zhvillimi dhe koordinimi i politikave, si dhe hartimi, monitorimi dhe vlerësimi i legjislacionit të jenë të rregulluar qartë dhe të lidhur ngushtë me prioritetet e qeverisë dhe planifikimin buxhetor, duke rritur kështu efikasitetin e politikave transparente dhe gjithëpërfshirëse.

Kjo shtyllë mbulon komponentët e planifikimit dhe koordinimit të politikave në nivel kombëtar, koordinimit efikas të procesit të integritetit evropian dhe hartimit të një legjislacioni gjithëpërfshirës, bazuar në të dhëna.

Masat që parashikohen nën shtyllën e Zhvillimit dhe Koordinimit të Politikave pasqyrojnë përpjekjet e Qeverisë për të siguruar që politikat dhe buxhetet të jenë të harmonizuara, të planifikuara në mënyrë efektive dhe të bashkërenduara. Synimi final është të garantohet zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi rigorozi i politikave, duke siguruar rezultate të qendrueshme.

Objektivat e mëposhtëm Specifikë dhe masat për secilin prej tyre do t'i shërbejnë arritjes së qëllimit të politikave.

PËRMBLEDHJE E QËLLIMIT TË POLITIKËS 1 – ZHVILLIMI DHE KOORDINIMI I POLITIKAVE

Komponenti 1.1 Planifikimi dhe koordinimi efikas i politikave në nivel kombëtar

OBJEKTIVI SPECIFIK A1: Përmirësimi i koordinimit, përafrimit dhe buxhetimit të politikave me objektivat kombëtare dhe globale të zhvillimit përgjatë gjithë ciklit të planifikimit të integruar të politikave.

Masat për vitet 2024 - 2030:

- **Masa A.1.1** - Rishikimi dhe garantimi i funksionimit efikas të mekanizmit të koordinimit të politikave, me synim thjeshtimin e koordinimit ndërinstitucional.
- **Masa A.1.2** - Përmirësimi i Sistemit Informatik të Planifikimit Strategjik të Integruar, me synim përmirësimin e monitorimit dhe raportimit të politikave.
- **Masa A.1.3** – Garantimi i shpërndarjes efektive të burimeve dhe vendimmarrjeve strategjike, në përputhje të plotë me zhvillimet shoqërore.
- **Masa A.1.4** - Linjëzimi i dokumentave strategjikë sektorialë dhe ndërsektorialë me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ)-të.

Komponenti 1.2 Koordinimi efikas i procesit të integrimit evropian

OBJEKTIVI SPECIFIK A2: Zbatimi i një procesi të mirëkoordinuar dhe gjithëpërfshirës për integrimin evropian, duke fuqizuar kapacitetet e strukturave negociuese për të përballuar me sukses kërkesat e procesit

Masat për vitet 2024 - 2030:

- **Masa A.2.1** – Sigurimi i kryerjes së procesit të planifikimit gjithëpërfshirës shumëvjeçar për Integrimin Evropian.
- **Masa A.2.2** – Forcimi i Sekretariatit të BE-së, në rolin e qendrës së qeverisjes (CoG) për monitorimin, garantimin e cilësisë dhe rritjen e kapaciteteve dhe aftësive në kuadër të procesit të integrimit evropian, si dhe Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian për përsheptimin e procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në BE.
- **Masa A.2.3** – Përgatitja dhe konsolidimi i programit të kapaciteteve dhe aftësive për Integrimin Evropian.

Komponenti 1.3 Ligjëbërje dhe politibërje gjithëpërfshirëse dhe transparente, bazuar në të dhëna dhe që garanton përputhje me acquis-në dhe standardet evropiane.

OBJEKTIVI SPECIFIK A3.1: Hartimi i politikave mbështetur në të dhëna dhe vlerësim cilësor të ndikimit rregullator, përgjatë një procesi mirëplanifikimi ligjor dhe konsultimi gjithëpërfshirës publik, që garanton përputhje me acquis-në dhe praktikatat e mira ndërkombëtare.

Masat për vitet 2024 - 2030:

- **Masa A.3.1** – Harmonizimi i programimit ligjor dhe procesit të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (VNR/RIA), përmes shoqërimit të projektakteve me një raport të thjeshtuar paraprak të ndikimit rregullator (RIA) para planifikimit të tyre në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve (PPAP).
- **Masa A.3.2** - Përmirësimi i përputhshmërisë së politikave të propozuara me politikat e përgjithshme dhe prioritetet qeveritare.
- **Masa A.3.3** - Përmirësimi i zbatimit të planifikimit ligjor në nismën ligjvënëse të Këshillit të Ministrave.
- **Masa A.3.4** - Përafrimi efikas me acquis-në dhe standardet evropiane përgjatë përgatitjes së nismave të reja ligjore dhe politike.
- **Masa A.3.5** - Përmirësimi i cilësisë së kryerjes dhe monitorimit të procesit RIA, përmes rritjes së burimeve dhe kapaciteteve në Kryeministri dhe institucionet përkatëse.
- **Masa A.3.6** - Zgjerimi i procesit RIA tek aktet e legjislacionit dytësor me interes të lartë publik, përmes rishikimit dhe plotësimit të kuadrit normativ, si dhe zbatimit të tij në praktikë.
- **Masa A.3.7** - Harmonizimi i procesit të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator me procesin e konsultimit publik.
- **Masa A.3.8** - Përmirësimi cilësor dhe sasior i procesit të konsultimit publik, përmes rritjes së numrit të akteve që konsultohen, si dhe rritjes së pjesëmarrjes qytetare në proces.
- **Masa A.3.9** - Zgjerimi i procesit të konsultimit publik tek aktet e legjislacionit dytësor me interes të lartë publik, përmes rishikimit të kuadrit ligjor dhe normativ dhe zbatimit të tij në praktikë.
- **Masa A.3.10** - Plotësimi i procesit të vlerësimit të ndikimit rregullator përmes vlerësimit ex-post, për të siguruar monitorim dhe përmirësim të vazhdueshëm të kuadrit ligjor.
- **Masa A.3.11** - Rritja e transparencës së agjendës vendimmarrëse të qeverisjes qendrore.

OBJEKTIVI SPECIFIK A1: Përmirësimi i koordinimit, përafrimit dhe buxhetimit të politikave me objektivat kombëtare dhe globale të zhvillimit, përmes një qasjeje të integruar dhe bashkëpunimit efektiv ndërsektorial.

Prioritetet

Një prioritet kryesor për këtë Objektiv Specifik është rishikimi dhe përmirësimi i funksionimit të Sistemit të Planifikimit të Integruar dhe elementeve të tij. Ky përmirësim do të ndihmojë në garantimin e një vendimmarrjeje të qëndrueshme dhe të mirëkoordinuar për zhvillimin e politikave, përmes plotësimit të kornizës ekzistuese ligjore dhe institucionale. Ky përmirësim do të mundësojë një cilësi më të lartë në planifikimin dhe zbatimin e politikave në nivel kombëtar.

Gjithashtu, është thelbësor përmirësimi i monitorimit të zbatimit të Planeve të Veprimit të RAP dhe publikimi i raporteve të monitorimit për transparencë dhe akses më të gjerë publik. Për të garantuar efikasitetin në këtë drejtim, riaktivizimi i mekanizmave të koordinimit është një hap vendimtar që do të mbështesë zbatimin efektiv të reformave dhe adresimin e sfidave të reja. Rishikimi i strukturës dhe funksionimit të strukturave aktuale koordinuese të politikave synon të përmirësojë ndjeshëm procesin e priorizimit të politikave kryesore shtetërore dhe rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit në raport me alokimin më realist të burimeve financiare. Kjo qasje do të forcojë udhëheqjen nga autoriteti përgjegjës shtetëror përmes një kuadri të vetëm gjithëpërfshirës buxhetimi, me procedura të harmonizuara monitorimi dhe raportimi, si dhe koordinimi me donatorët.

Nga ana tjetër, përmirësimi i koherencës ndërmjet planifikimit strategjik dhe buxhetimit, dhe shpërndarja e burimeve në përputhje me objektivat strategjike të Këshillit të Ministrave shtron domosdoshmërinë e miratimit çdo fillimviti të Dokumentit të Politikave Prioritare me shtrirje afatmesme, me vendim nga Këshilli i Ministrave, për përgatitjen e së cilës puna bashkërendohet nga Agjencia Shtetërore e Programit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC). Dokumenti i Politikave Prioritare, si komponent i planifikimit strategjik afatmesëm orienton qartë dhe i paraprin procesit të planifikimit të financimit/programimit buxhetor afatmesëm (PBA) duke siguruar një shkallë më të lartë pajtimi me objektivat strategjike të Këshillit të Ministrave, duke qenë se fokusohet në disa prioritete kyçe/objektiva strategjike, të cilat janë mjaftueshëm specifike (dmth nuk ngelen në nivele aq të përgjithshme) dhe shtrihen në një afat kohor afatmesëm nga ku mund të vlerësohet në mënyrë shumë më domethënëse kërkesa ose nevoja për ndryshime përgjatë zbatimit.

Mekanizmi i qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale dhe Dokumenti i Politikave Prioritare janë pjesë e Sistemit Informatik të Planifikimit të Integruar (SIPI/IPSIS) si sistemi kryesor për planifikimin, analizimin, përgatitjen e të gjitha tipologjive të dokumenteve strategjike, si dhe monitorimin e performancës së arritur kundrejt politikave dhe objektivave të planifikuar. Modul i këtij sistemi është dhe integrimi i masave kombëtare prioritare në të cilën përfshihet Paketa Kombëtare e Projekteve Strategjike. Në sistemin aktual kjo paketë përmban projektet me rëndësi kombëtare, që me ndryshimet e fundit ligjore miratohet si pjesë e Dokumentit të Politikave Prioritare. Rishikimi i planifikuar i instrumentit IPSIS do të mundësojë rritjen e transparencës, qëndrueshmërisë, efikasitetit dhe efektivitetit në përdorimin e burimeve publike.

Lista Unike synon forcimin e lidhjes ndërmjet prioriteteve të qeverisë, Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022-2030, strategjive sektoriale e ndërsektoriale dhe Planit Ekonomik të Investimeve të Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor 2021-2027, me procesin e hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm. Gjithashtu, në kuadër të reformës së administratës publike, si një proces i domosdoshëm dhe i vazhdueshëm, i lidhur ngushtë me procesin e integritimit në Bashkimin Evropian (BE), përditësimi i përvitshëm i listës do të sigurojë rritjen e transparencës dhe qëndrueshmërisë, si dhe rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit në përdorimin e burimeve financiare publike.

Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, në pozicionin e institucionit përgjegjës për koordinimin e politikave dhe prioriteteve në përputhje me synimet kombëtare dhe globale, do të punojë për të përmirësuar mekanizmat e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale dhe planifikimin dhe alokimin e burimeve për arritjen e objektivave kombëtare. Përmirësimi i kapaciteteve administrative për planifikimin dhe monitorimin e politikave mbetet një përparësi për të garantuar një qasje të koordinuar dhe profesionale në procesin e integritimit evropian.

Ky Objektiv Specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme, teksa aktivitetet konkrete për periudhën e parë të zbatimit të SNRAP 2024-2030 mund të gjenden në Planin e Veprimit 2024-2026 (Aneksi nr. 1).

<i>Objekivi Specifik A1: Përmirësimi i koordinimit, përafrimit dhe buxhetimit të politikave me objektivat kombëtare dhe globale të zhvillimit përgjatë gjithë ciklit të planifikimit të integruar të politikave.</i>	
Masa A.1.1	Rishikimi dhe garantimi i funksionimit efikas të mekanizmit të koordinimit të politikave, me synim thjeshtimin e koordinimit ndërinstitutional.
Masa A.1.2	Përmirësimi i Sistemit Informatik të Planifikimit Strategjik të Integruar, me synim përmirësimin e monitorimit dhe raportimit të politikave.
Masa A.1.3	Garantimi i shpërndarjes efektive të burimeve dhe vendimmarrjeve strategjike, në përputhje të plotë me zhvillimet shoqërore.
Masa A.1.4	Linjëzimi i dokumentave strategjike sektoriale dhe ndërsektoriale me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ)-të.

Treguesit e performancës dhe vlerat e synuara

Masa	Treguesi	Aktorët bashkëpërgjegjës
Masa A.1.1 – Rishikimi dhe garantimi i funksionimit efikas të mekanizmit të koordinimit të politikave, me synim thjeshtimin e koordinimit ndërinstitutional.	A.1.1 Strukturat e ngritura të riorganizuara, të thjeshtuara dhe funksionale.	Njësitë përgjegjëse: SASPAC Partnerët: Ministritë e Linjës
Masa A.1.2 - Përmirësimi i Sistemit Informatik të Planifikimit Strategjik të Integruar, me synim përmirësimin e monitorimit dhe raportimit të politikave.	A.1.2.a Plani i Veprimit për operacionalitetin e plotë të IPSIS dhe të gjitha moduleve dhe funksionaliteteve të tij i miratuar. A.1.2.b Përqindja e dokumenteve strategjike dhe Planeve të Veprimit të zhvilluara në përputhje me Metodologjinë dhe udhëzimet e IPSIS.	Njësitë përgjegjëse: SASPAC Partnerët: AKSHI

<p>Masa A.1.3 – Garantimi i shpërndarjes efektive të burimeve dhe vendimmarrjeve strategjike, në përputhje të plotë me zhvillimet shoqërore.</p>	<p>A.1.3.a Dokumenti i Politikave Prioritare (DPP) dhe Lista Unike e Projekteve me Rëndësi Kombëtare e inkomporuar në DPP miratohen rregullisht në baza vjetore.</p> <p>A.1.3.b Strategjitë kombëtare, reformat ekonomike dhe PKIE linjëzohen periodikisht me njëra-tjetrën dhe me DPP.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse: SASPAC</p> <p>Partnerët: Ministritë e Linjës</p>
<p>Masa A.1.4 – Linjëzimi i dokumentave strategjikë sektorialë dhe ndërsektorialë me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ)-të.</p>	<p>A.1.4 Udhërrëfyese për zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Agjendës 2030 të Kombeve të Bashkuara i miratuar dhe i zbatuar.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse: SASPAC</p> <p>Partnerët: Ministritë e Linjës</p>

Komponenti 1.2 *Koordinimi efikas i procesit të integritimit evropian*

OBJEKTIVI SPECIFIK A2: Zbatimi i një procesi të mirëkoordinuar dhe gjithëpërfshirës për integrimin evropian, duke fuqizuar kapacitetet e strukturave negociuese për të përballuar me sukses kërkesat e procesit.

Prioritetet

Procesi i integritimit në Bashkimin Evropian është projekti madhor strategjik i Qeverisë dhe shtetit shqiptar, i cili ofron udhërrëfyesin më të qartë për konsolidimin e institucioneve demokratike, garantimin e shtetit të së drejtës dhe avancimin e reformave themelore drejt përmbushjes së standardeve evropiane. Përmes këtij Objektivit Specifik synohet përshpejtimi i procesit të përmbushjes së kriterëve të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, në përputhje me Metodologjinë e re të Zgjerimit, përmes koordinimit efektiv të strukturave të përfshira në procesin e negociatave dhe forcimit të kapaciteteve institucionale për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Në këtë kontekst, Departamenti i Politikës dhe Integritimit Evropian në Kryeministri luan një rol kyç. Në kuadër të forcimit të Sekretariatit të BE-së në rolin e qendrës së qeverisjes për monitorimin, garantimin e cilësisë dhe rritjen e kapaciteteve dhe aftësive në kuadër të procesit të integritimit evropian, si dhe Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian për përshpejtimin e procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në BE, një sfidë potenciale është nevoja për forcim të sekretariateve teknike të GNPIE me qëllim përmirësimin e punës dhe koordinimin e procesit të integritimit.

Ky Objektiv Specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme, tekta aktivitetet konkrete për periudhën e parë të zbatimit të SNRAP 2024-2030 mund të gjenden në Planin e Veprimit 2024-2026 (Aneksi nr. 1).

<p>Objektivi Specifik A.2: Zbatimi i një procesi të mirëkoordinuar dhe gjithëpërfshirës për integrimin evropian, duke fuqizuar kapacitetet e strukturave negociuese për të përballuar me sukses kërkesat e procesit.</p>	
<p>Masa A.2.1</p>	<p>Kryerja dhe zbatimi efikas i procesit të planifikimit gjithëpërfshirës shumëvjeçar mbi integrimin evropian.</p>

Masa A.2.2	Përmirësimi i bashkëpunimit ndërinstitucional mes strukturave kombëtare përgjegjëse për integrimin në BE.
Masa A.2.3	Forcimi i Sekretariatit të BE-së, në rolin e Qendrës së Qeverisjes (CoG) për monitorimin, garantimin e cilësisë dhe rritjen e kapaciteteve dhe aftësive, si dhe Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian sipas <i>acquis</i> -së dhe standardeve evropiane.
Masa A.2.4	Përgatitja dhe zbatimi i programit për forcimin e kapaciteteve dhe aftësive për integrimin evropian.

Masa	Treguesi	Aktorët bashkëpërgjegjës
Masa A.2.1 - Kryerja dhe zbatimi efikas i procesit të planifikimit gjithëpërfshirës shumëvjeçar mbi integrimin evropian.	<p>A.2.1.a Plani i ri Kombëtar gjithëpërfshirës për Integrimin Evropian 2024-2030 i miratuar, bazuar në Programin Kombëtar të Aderimit në Bashkimin Evropian (PKABE).</p> <p>A.2.1.b Kuadri rregullator për përgatitjen e versionit kombëtar të <i>acquis</i>-së së BE-së i miratuar dhe funksional.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse: KM/DPEI</p> <p>Partnerët: Ministritë e Linjës</p>
Masa A.2.2 – Përmirësimi i bashkëpunimit ndërinstitucional mes strukturave kombëtare përgjegjëse për integrimin në BE.	A.2.2 Ndryshimet në VKM Nr. 749, datë 19.12.2018, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore, përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian” të miratuara.	Njësitë përgjegjëse: KM/DPEI
Masa A.2.3 - Forcimi i Sekretariatit të BE-së, në rolin e Qendrës së Qeverisjes (CoG) për monitorimin, garantimin e cilësisë dhe rritjen e kapaciteteve dhe aftësive, si dhe Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian sipas <i>acquis</i> -së dhe standardeve evropiane.	<p>A.2.3.a Struktura e Sekretariatit e rishikuar.</p> <p>A.2.3.b Analiza për kapacitetet administrative të Sekretariatit të BE dhe GNPIE-ve e kryer.</p>	Njësitë përgjegjëse: KM/DPEI
Masa A.2.4 - Përgatitja dhe zbatimi i programit të kapaciteteve dhe aftësive për Integrimin Evropian.	<p>A.2.4.a Plani Menaxherial i Integritit Evropian për Forcimin e Kapaciteteve Administrative, i pilotuar dhe i hartuar për 33 kapituj.</p> <p>A.2.4.b Planet e ngritjes së kapaciteteve bazuar në nevojat për trajnim të kapaciteteve për të gjitha strukturat përkatëse, të zbatuara.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse: KM/DPEI</p> <p>Partnerët: ASPAA</p>

Komponenti 1.3 Ligjëbërje dhe politibërje gjithëpërfshirëse dhe transparente, bazuar në të dhëna dhe që garanton përputhje me acquis-në dhe standardet evropiane

OBJEKTIVI SPECIFIK A.3: Hartimi i politikave mbështetur në të dhëna dhe vlerësim cilësor të ndikimit rregullator, përgjatë një procesi mirëplanifikimi ligjor dhe konsultimi gjithëpërfshirës publik, që garanton përputhje me acquis-në dhe praktikatat e mira ndërkombëtare.

Prioritetet

Ky Objektiv Specifik synon të garantojë një proces gjithëpërfshirës të hartimit të politikave dhe legjislacionit, duke përdorur metoda të bazuara në të dhëna, i cili garanton përputhshmëri me *acquis*-në dhe standardet evropiane. Masat e parashikuara për zbatimin e këtij Objektivit Specifik do të adresojnë përafrimin ligjor dhe metodologjik me *acquis*-në dhe standardet e BE-së, rritjen e kapaciteteve administrative për përgatitjen dhe monitorimin e raporteve RIA, si dhe përmirësimin e konsultimit publik si një proces efektiv dhe gjithëpërfshirës.

Zbatimi në rritje i kërkesave rregullatore të procesit të vlerësimit të ndikimit (RIA), ka ndikuar në rritjen e cilësisë dhe efektivitetin e hartimit të politikave/legjislacionit në vend, duke bërë të mundur që ndërhyrja e qeverisë të bazohet në të dhëna dhe të jetë e drejtuar aty ku është e nevojshme. Ky prioritetizim do të rritet edhe më tej në përputhje me angazhimet e ndërmarra në Udhërrëfyesin për Reformën në Administratën Publike 2023-2030, përmes investimit në përmirësimin e kapaciteteve dhe njohurive të stafit të angazhuar me kryerjen dhe monitorimin e procesit. Duke konsideruar kompleksitetin që paraqet kryerja cilësore e procesit të vlerësimit të ndikimit rregullator, dhe nevojën për njohuri dhe aftësi të specializuara në këtë drejtim, ndërhyrjet e planifikuara synojnë rritjen e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së raporteve RIA të hartuara nga funksionarët publikë, si dhe për rrjedhojë, edhe rritjen e transparencës dhe besueshmërisë së qytetarëve dhe palëve të tjera të treta në proces.

Në këtë kuadër, në këtë Strategji janë parashikuar masa konkrete për të garantuar transparencën, efikasitetin dhe bazueshmërinë në prova të politikave rregullatore. Qeveria Shqiptare do të përfshijë procesin e vlerësimit të ndikimit rregullator në fazën e programimit ligjor, për të mundur që ndikimet e mundshme të akteve rregullatore në shoqëri dhe ekonomi të identifikohen dhe adresohen përpara zbatimit të akteve në fjalë. Kjo qasje ka për qëllim shmangien paraprake të pasojave të padëshiruara të veprimtarisë rregullatore dhe garanton që aktet rregullatore të jenë efektive dhe të arrijnë objektivat e përcaktuara. Po ashtu, parashikohet që ky proces do të rrisë legjitimitetin e vendimmarrjes dhe besimin e qytetarëve në veprimtarinë e institucioneve publike.

Në kuadër të kësaj strategjie, është parashikuar gjithashtu përmirësimi i procesit të vlerësimit të ndikimit ex-post, i cili do të monitorojë pasojat e akteve rregullatore në fuqi, duke vlerësuar kostot, përfitimet dhe efektivitetin e tyre. Ky vlerësim do të ndihmojë politikëbërësit të identifikojnë nevojat për përmirësime dhe të bëjnë rregullimet e nevojshme për të arritur rezultate më të mira dhe për të plotësuar nevojat e palëve të interesuara.

Një tjetër element i rëndësishëm në procesin e hartimit cilësor e gjithëpërfshirjes të legjislacionit, është edhe kryerja e një procesi të mirëfilltë konsultimi publik, ku palët e prekura e të interesuara të mund të japin kontribut të vlefshëm. Në raportin e saj më të fundit të monitorimit për Shqipërinë, OECD/SIGMA thekson rëndësinë e këtij procesi, publikimin e raporteve dhe rritjen e angazhimit qytetar në procesin e konsultimit publik. Pas një analize të hollësishme të legjislacionit që rregullon këtë proces, si dhe mënyrës së

funksionimit në praktikë të konsultimit publik, institucionet shqiptare do të angazhohen për përmirësimin e mëtejshëm të këtij rregullimi dhe mënyre zbatimi të procesit në përditshmëri.

Nga ana tjetër, edhe numri i akteve ligjore të cilat kalojnë përmes procesit të konsultimit publik duhet të rritet. Në përputhje me këtë objektiv, do t'i kushtohet vëmendje edhe cilësisë së procesit të konsultimit publik, duke e larguar sa më shumë nga një proces formalisht i strukturuar dhe duke e kthyer në një procedurë që nxit gjithëpërfshirjen. Për këtë qëllim, administrata publike do t'i dedikojë më shumë vëmendje reflektimit të rekomandimeve dhe sugjerimeve të bëra gjatë procesit të konsultimit publik dhe, në rastet kur ato nuk pasqyrohen në versionin përfundimtar të legjislacionit, do të bëjë të disponueshme për publikun edhe argumentimet përkatëse. Për këtë, do të priorizohet angazhimi i koordinuar dhe i vazhdueshëm i të gjitha strukturave të përfshira, në mënyrë që të sigurohet një proces konsultimi publik efektiv, si dhe legjislacion dhe politika që reflektojnë më mirë interesat e qytetarëve.

Përmes zbatimit të masave të parashikuara në këtë Strategji për harmonizimin ndërmjet procesit RIA dhe procesit të konsultimit publik, synohet të garantohet që palët e interesuara të jenë në gjendje të japin mendime të mirëinformuara mbi projektaktet e propozuara, më qëllim final rritjen e pranueshmërisë së këtyre kontributeve nga institucionet publike hartuese të politikave, si dhe marrjen e vendimeve rregullatore më të mirëinformuara.

Ky Objektiv Specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme, teksa aktivitetet konkrete për periudhën e parë të zbatimit të SNRAP 2024-2030 mund të gjenden në Planin e Veprimit 2024-2026 (Aneksi nr. 1).

<i>Objektivi Specifik A.3: Hartimi i politikave mbështetur në të dhëna dhe vlerësim cilësor të ndikimit rregullator, përgjatë një procesi mirëplanifikimi ligjor dhe konsultimi gjithëpërfshirës publik, që garanton përputhje me acquis-në dhe praktikën e mira ndërkombëtare.</i>	
Masa A.3.1	Harmonizimi i programimit ligjor dhe procesit të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (VNR/RIA), përmes shoqërimit të projektakteve me një raport të thjeshtuar paraprak të ndikimit rregullator (RIA) para planifikimit të tyre në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve (PPAP).
Masa A.3.2	Përmirësimi i përputhshmërisë së politikave të propozuara me politikat e përgjithshme dhe prioritetet qeveritare.
Masa A.3.3	Përmirësimi i zbatimit të planifikimit ligjor në nismën ligjvënëse të Këshillit të Ministrave.
Masa A.3.4	Përafrimi efikas me <i>acquis</i> -në dhe standardet evropiane përgjatë përgatitjes së nismave të reja ligjore dhe politike.
Masa A.3.5	Përmirësimi i cilësisë së kryerjes dhe monitorimit të procesit RIA, përmes rritjes së burimeve dhe kapaciteteve në Kryeministri dhe institucionet përkatëse.
Masa A.3.6	Zgjerimi i procesit RIA tek aktet e legjislacionit dytësor me interes të lartë publik, përmes rishikimit dhe plotësimit të kuadrit normativ, si dhe zbatimit të tij në praktikë.
Masa A.3.7	Harmonizimi i procesit të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator me procesin e konsultimit publik.
Masa A.3.8	Përmirësimi cilësor dhe sasior i procesit të konsultimit publik, përmes rritjes së numrit të akteve që konsultohen, si dhe rritjes së pjesëmarrjes qytetare në proces.
Masa A.3.9	Zgjerimi i procesit të konsultimit publik tek aktet e legjislacionit dytësor me interes të lartë publik.
Masa A.3.10	Plotësimi i procesit të vlerësimit të ndikimit rregullator përmes vlerësimit <i>ex-post</i> , për të siguruar monitorim dhe përmirësim të vazhdueshëm të kuadrit ligjor.

Masa A.3.11	Rritja e transparencës së veprimtarisë së qeverisjes qendrore.
--------------------	--

Masa	Treguesi	Aktorët bashkëpërgjegjës
Masa A.3.1 – Harmonizimi i programimit ligjor dhe procesit të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (VNR/RIA).	<p>A.3.1.a Kuadri nënligjor i plotësuar me udhëzime të qarta për të garantuar shoqërimin e çdo projektakti të propozuar me Raportin RIA paraprakisht përfshirjes në PPAP.</p> <p>A.3.1.b Trend rritës i numrit të raporteve RIA të thjeshtuara të përgatitura.</p> <p>A.3.1.c Trend rritës i numrit të projektligjeve të planifikuara në PPAP që shoqërohen me Raportin e thjeshtuar RIA.</p> <p>A.3.1.d Numri i vlerësimeve të rregullta dhe raporteve të monitorimit të kryera dhe të përgatitura nga Kryeministria për të përmirësuar procesin e harmonizimit bazuar në reagime – raporte periodike (muajore, tremujore dhe vjetore).</p>	<p>Njësitë përgjegjëse: Njësia e Programimit të Akteve Rregullatore dhe RIA në Kryeministri</p> <p>Partnerët: Ministritë e Linjës Institucionet e qeverisjes qendrore</p>
Masa A.3.2 - Përmirësimi i përputhshmërisë së politikave të propozuara në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve me politikat e përgjithshme dhe prioritetet qeveritare.	A.3.2.a Koordinim i përmirësuar mes SASPAC, Departamentit të Akteve Rregullatore të Këshillit të Ministrave dhe Departamentit të Politikave të Integritimit Evropian në KM për verifikim në përmbajtje, përtej metodologjisë.	<p>Njësitë përgjegjëse: Njësia e Programimit të Akteve Rregullatore dhe RIA në Kryeministri</p> <p>Partnerët: SASPAC Ministritë e Linjës</p>
Masa A.3.3 - Përmirësimi i zbatimit të planifikimit ligjor në nismën ligjvënëse të Këshillit të Ministrave.	<p>A.3.3.a Trend rritës i përqindjes së akteve të miratuara që janë paraprakisht të parashikuara në PPAP.</p> <p>A.3.3.b Trend rritës i harmonizimit të PPAP me PKIE.</p> <p>A.3.3.c Trend ulës i numrit të akteve të parashikuara në PPAP dhe PKIE që shtyhen për realizim përgjatë vitit pasardhës.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse: Njësia e Programimit të Akteve Rregullatore dhe RIA në Kryeministri</p> <p>Partnerët: DPEI, KM Ministritë e Linjës</p>

<p>Masa A.3.4 – Mbështetja në praktika të mira ndërkombëtare dhe përafrimi efikas me <i>acquis</i>-në dhe standardet evropiane përgjatë përgatitjes së nismave të reja ligjore dhe politike.</p>	<p>A.3.4.a Trend rritës i akteve që ndërmarrin harmonizim me <i>acquis</i>-në të cilat shoqërohen me Tabelat e Përputhshmërisë dhe versionin e përkthyer të <i>acquis</i>-së që transpozohet.</p> <p>A.3.4.b Trend rritës i numrit të Raporteve RIA për nisma të cilat transpozojnë <i>acquis</i>-në që përmbajnë referenca ndaj analizave të prodhuara nga Komisioni Evropian dhe/ose Shtetet Anëtare të BE-së kur zhvillojnë dhe/ose transpozojnë të njëjtën direktivë në administratën e tyre përkatëse.</p> <p>A.3.4.c Trend rritës i numrit të Raporteve RIA të cilat referojnë praktika të mira rajonale dhe ndërkombëtare në mbështetje të rregullimit të propozuar.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse: Njësia e Programimit të Akteve Rregullatore dhe RIA në Kryeministri, Departamenti i Politikës dhe Integritimit Evropian në Kryeministri</p> <p>Partnerët: KM Ministritë e Linjës</p>
<p>Masa A.3.5 – Përmirësimi i cilësisë së kryerjes dhe monitorimit të procesit RIA, përmes rritjes së burimeve dhe kapaciteteve në Kryeministri dhe institucionet përkatëse.</p>	<p>A.3.5.a Kurrikula e trajnimit gjithëpërfshirës për nëpunësit publikë për procesin RIA e hartuar.</p> <p>A.3.5.b Numri i seancave periodike trajnuese mbi procesin RIA.</p> <p>A.3.5.c Numri i nëpunësve publikë të trajnuar.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse: Njësia e Programimit të Akteve Rregullatore dhe RIA në Kryeministri</p> <p>Partnerët: - Institucionet e qeverisjes qendrore; - ASPA.</p>
<p>Masa A.3.6 - Zgjerimi i procesit RIA tek aktet e legjislacionit dytësor me interes të lartë publik, përmes rishikimit dhe plotësimit të kuadrit normativ, si dhe zbatimit të tij në praktikë.</p>	<p>A.3.6.a VKM nr. 584, datë 28.3.2003 “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, i ndryshuar, për të pasqyruar listën e kriterëve për përzgjedhjen e akteve nënligjore që do t’i nënshtrohen procesit RIA, bazuar në praktikën më të mira ndërkombëtare.</p> <p>A.3.6.b Metodologjia për kryerjen e procesit RIA e përditësuar me listën e kriterëve për aktet nënligjore që do t’i nënshtrohen procesit RIA.</p> <p>A.3.6.c Numri i trajnimeve të kryera për nëpunësit publikë mbi procesin RIA për legjislacionin dytësor.</p> <p>A.3.6.d Trend rritës i numrit të akteve nënligjore që i nënshtrohen procesit RIA.</p> <p>A.3.6.e Raporte monitorimi të orientuara drejt përmbajtjes dhe cilësisë, të përgatitura periodikisht</p>	<p>Njësitë përgjegjëse: Njësia e Programimit të Akteve Rregullatore dhe RIA në Kryeministri</p> <p>Partnerët: Institucionet e qeverisjes qendrore, ASPA</p>

	nga njësia përgjegjëse e mbikëqyrjes, me synim vlerësimin e nevojave për trajnim mbi procesin për nëpunësit civilë.	
Masa A.3.7 - Harmonizimi i procesit të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator me procesin e konsultimit publik.	<p>A.3.7.a Udhëzimet për integrimin e konsultimit publik në procesin RIA të përmirësuara.</p> <p>A.3.7.b Numri i seancave trajnuese për funksionarët publikë mbi integrimin e rezultateve të procesit të konsultimit publik në raportet RIA.</p> <p>A.3.7.c Koordinim i përmirësuar ndërmjet anëtarëve të rrjetit të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator dhe Konsultimit Publik në ministritë e linjës.</p> <p>A.3.7.d Trend rritës i përqindjes së raporteve të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator që integrojnë informacionin nga procesi i konsultimit publik.</p> <p>A.3.7.e Raporte të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator të përmirësuara.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse: Njësia e Programimit të Akteve Rregullatore dhe RIA në Kryeministri</p> <p>Partnerët: Institucionet e qeverisjes qendrore, ASPA</p>
Masa A.3.8 - Përmirësimi cilësor dhe sasior i procesit të konsultimit publik, përmes rritjes së numrit të akteve që konsultohen, si dhe rritjes së pjesëmarrjes qytetare në proces.	<p>A.3.8.a Trend rritës i numrit të akteve që kalojnë në procesin e konsultimit publik.</p> <p>A.3.8.b Trend rritës i numrit të komenteve të mbërritura nga qytetarët dhe grupet e interesit.</p> <p>A.3.8.c Trend rritës i përdorimit të RENJKP për konsultimin e projektakteve.</p> <p>A.3.8.d Trend rritës i respektimit të afatit të konsultimit publik.</p> <p>A.3.8.e Trend rritës i përdorimit të metodave alternative të konsultimit publik.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse: Njësia e Programimit të Akteve Rregullatore dhe RIA në Kryeministri</p> <p>Partnerët: Institucionet e qeverisjes qendrore</p>

	<p>A.3.8.d Numri i fushatave ndërgjegjësuere të kryera për promovimin e mekanizmave konsultativë në OSHC-të, sektorin privat dhe shoqërinë e gjerë.</p>	
<p>Masa A.3.9 - Zgjerimi i procesit të konsultimit publik tek aktet e legjislacionit dytësor me interes të lartë publik.</p>	<p>A.3.9.a Ndryshimet në ligjin nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” dhe në aktet nënligjore për konsultimin publik – të miratuara.</p> <p>A.3.9.b Metodologjia për konsultimin publik e përditësuar me udhëzimet për kryerjen e procesit mbi aktet e legjislacionit dytësor me interes të lartë publik – e hartuar.</p> <p>A.3.9.c Numri i trajnimeve të kryera për nëpunësit publikë mbi zgjerimin e konsultimit publik për legjislacionin dytësor.</p> <p>A.3.9.d Trend rritës i numrit të akteve nënligjore që i nënshtrohen procesit të konsultimit publik.</p> <p>A.3.9.e Raporte monitorimi të orientuara drejt përmbajtjes dhe cilësisë, të përgatitura periodikisht nga njësia përgjegjëse e mbikëqyrjes, me synim vlerësimin e nevojave për trajnim mbi procesin për nëpunësit civilë.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse: Njësia e Programimit të Akteve Rregullatore dhe RIA në Kryeministri, Departamenti i Akteve Rregullatore në Kryeministri</p> <p>Partnerët: MEKI, Institucionet e qeverisjes qendrore, ASPA</p>
<p>Masa A.3.10 - Plotësimi i procesit të vlerësimit të ndikimit rregullator përmes vlerësimit <i>ex-post</i>, për të siguruar monitorim dhe përmirësim të vazhdueshëm të kuadrit ligjor.</p>	<p>A.3.10.a Lista e kriterëve e miratuar, bazuar në praktikat më të mira, për përzgjedhjen e akteve që do t’i nënshtrohen procesit RIA <i>ex-post</i>.</p> <p>A.3.10.b Metodologjia për kryerjen e procesit RIA e përditësuar me listën e kriterëve për aktet që do t’i nënshtrohen procesit RIA <i>ex-post</i>.</p> <p>A.3.10.c Kurrikula e trajnimit për nëpunësit publikë mbi vlerësimin RIA <i>ex-post</i> e hartuar.</p> <p>A.3.10.d Numri i trajnimeve të kryera për nëpunësit publikë mbi procesin RIA <i>ex-post</i>.</p> <p>A.3.10.e Trend rritës i numrit të akteve që i nënshtrohen procesit RIA <i>ex-post</i>.</p> <p>A.3.10.f Raporte monitorimi të orientuara drejt përmbajtjes dhe cilësisë, të përgatitura periodikisht nga njësia përgjegjëse e mbikëqyrjes,</p>	<p>Njësitë përgjegjëse: Njësia e Programimit të Akteve Rregullatore dhe RIA në Kryeministri</p> <p>Partnerët: Institucionet e qeverisjes qendrore, ASPA</p>

	me synim vlerësimin e nevojave për trajnim mbi procesin për nëpunësit civilë.	
Masa A.3.11 - Rritja e transparencës së vendimmarrjes së qeverisjes qendrore.	<p>A.3.11.a Aktet e miratuara në mbledhjet e Këshillit të Ministrave të publikuara rregullisht në faqen zyrtare të Kryeministritë.</p> <p>A.3.11.b Raportet e Monitorimit të Strategjive Sektoriale dhe Ndërsektoriale të publikuara rregullisht.</p> <p>A.3.11.c Raportet e Monitorimit të zbatimit të PPAP dhe PKIE të publikuara rregullisht.</p> <p>A.3.11.d Urdhrat Ministrorë të karakterit normativ të publikuara rregullisht në Fletoren Zyrtare.</p> <p>A.3.11.e Opsioni për kërkimin e akteve të miratuara, por ende nuk kanë hyrë në fuqi ofrohet në faqen e QBZ.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse: Kryeministria Të gjitha ministritë</p> <p>Partnerët: QBZ</p>

Qëllimi i Politikës 2: Shërbimi Civil dhe Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

Përmes Qëllimit të Politikës 2 synohet konsolidimi i një administrate profesionale, të përzgjedhur me meritë, të painfluencuar nga aktorë dhe faktorë të jashtëm, që punon me efikasitet, motivim dhe llogaridhënie të lartë.

Shërbimi civil dhe menaxhimi i burimeve njerëzore janë një fushë e veçantë ku Qeveria Shqiptare ka treguar angazhim të vazhdueshëm dhe vëmendje të shtuar. Në vijim të arritjeve të evidentuara nga partnerët ndërkombëtare dhe të reflektuara përmbledhtaz në pjesën e parë të këtij dokumenti, Qëllimi i Politikës 2 do të adresojë sfidat e identifikuar në këtë fushë, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të administratës publike dhe performancës së saj përgjatë procesit të integritetit evropian.

Kjo shtyllë detajon një sërë masash lidhur me komponentët e pranimin në shërbimin civil, në zbatim të plotë të parimit të meritës, motivimit dhe trajnimit të punonjësve, si dhe menaxhimin e përmirësuar dhe efikas të burimeve njerëzore, mes të tjerash edhe përmes përdorimit të sistemeve lehtësuese elektronike.

Ky Qëllim i Politikës do të arrihet përmes Objektivave të mëposhtëm Specifikë dhe masave të renditura për secilin Objektiv.

PËRMBLEDHJE E QËLLIMIT TË POLITIKËS 2 – SHËRBIMI CIVIL DHE MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Komponenti 2.1 Pranimi meritokratik, konkurrues dhe transparent në shërbimin civil

OBJEKTIVI SPECIFIK B1: Pranimi në institucionet e administratës publike bazuar në konkurs të hapur, në parimin e meritës dhe duke siguruar përzgjedhjen e kandidatëve më të mirë.

Masat për vitet 2024-2030:

- **Masa B.1.1** – Rishikimi i kuadrit ligjor për nëpunësin civil.
- **Masa B.1.2** – Plotësimi i kuadrit nënligjor për garantimin e një procesi të përmirësuar, objektiv dhe meritokratik rekrutimi.
- **Masa B.1.3** – Miratimi i kornizës së kompetencave për shërbimin civil dhe përshtatja e procedurave të rekrutimit me kompetencat e reja.
- **Masa B.1.4** – Rritja e kapaciteteve të anëtarëve të Komisioneve të Pranimit në shërbimin civil dhe për lëvizjet në karrierë, dhe përditësimi i vazhdueshëm i databazës elektronike të pyetjeve.
- **Masa B.1.5** – Zbatimi i një programi të dedikuar për përshtatjen e nëpunësve të rinj me institucionin punëmarrës dhe pozicionin e punës gjatë periudhës së provës apo në rastet e ngritjes në detyrë.

Komponenti 2.2 Pozicionimi i administratës publike si një punëdhënësi i besueshëm, tërheqës dhe konkurrues në tregun e punës.
OBJEKTIVI SPECIFIK B2: Investimi në motivimin dhe mirëqenien e nëpunësve publikë, me synim rritjen e atraksionit dhe forcimin e pozitës së sektorit publik si punëmarrës i besueshëm, tërheqës dhe konkurrues në tregun e punës.

Masat për vitet 2024-2030:

- **Masa B.2.1** - Ndryshimi i strukturës së pagave, duke synuar thjeshtëzimin e saj dhe rritjen e elementeve motivuese në shpërblimin financiar.
- **Masa B.2.2** - Rritja e transparencës së pagave për nëpunësit publikë, përfshirë edhe në njoftimet për aplikime për vendet vakante.
- **Masa B.2.3** - Miratimi dhe zbatimi i metodologjisë së re për vlerësimin e pozicioneve të punës në administratën publike.
- **Masa B.2.4** - Rishikimi dhe zbatimi praktik i procesit të vlerësimit të performancës individuale, duke garantuar harmonizim me performancën institucionale.
- **Masa B.2.5** - Plotësimi i kuadrit rregullator për etikën, në zbatim të ligjit nr. 152/2013 dhe VKM nr. 874/2021.
- **Masa B.2.6** - Përmirësimi i kapaciteteve të DAP dhe institucioneve publike për monitorimin e zbatimit në praktikë të rregullave të etikës nga nëpunësit e administratës publike.
- **Masa B.2.7** - Zbatimi i programeve të posaçme me synim tërheqjen e nëpunësve civilë të kualifikuar.
- **Masa B.2.8** - Konsolidimi i praktikave të rregullta promovuese të kapitalit njerëzor profesional dhe me integritet të administratës publike.
- **Masa B.2.9** - Zbatimi gradual i modalitetit të punës hibride në institucionet publike, në përputhje me standardet evropiane dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare.
- **Masa B.2.10** - Rritja e atraksionit të shërbimit në sektorin publik, përmes garantimit të aksesit preferencial në shërbime dhe aktivitete për nëpunësit e administratës publike.
- **Masa B.2.11** - Promovimi i shërbimit civil dhe administratës publike si punëdhënësi i besueshëm, tërheqës dhe konkurrues.

Komponenti 2.3 Rritja e kapaciteteve të administratës publike

OBJEKTIVI SPECIFIK B3: Investimi në zhvillimin profesional të nëpunësve të të gjitha niveleve të administratës publike për të mbështetur dhe avancuar agjendën kombëtare të integritit evropian të Shqipërisë.

Masat për vitet 2024-2030:

- **Masa B.3.1** - Hartimi dhe zbatimi efikas i modelit ekonomik të ASPA-s në ofrimin e trajnimeve për të tretët, në përputhje me kuadrin ligjor dhe atë rregullator.
- **Masa B.3.2** - Rishikimi i kriterëve për përzgjedhjen e trajnerëve dhe masës së pagesës së tyre, me synim tërheqjen e ekspertëve më të mirë në fushat përkatëse, si dhe rritjen e atraksionit të ofertës së trajnimit pranë ASPA-s.
- **Masa B.3.3** - Rishikimi i fondit të trajnimeve të ofruara nga ASPA, me fokus forcimin e kapaciteteve analitike, planifikuese dhe digjitale të nëpunësve, si dhe njohurive për procesin e integritit evropian.
- **Masa B.3.4** - Trajnim i dedikuar dhe periodik për përmirësimin e aftësive udhëheqëse dhe menaxheriale të drejtuesve të nivelit të mesëm dhe të lartë, me synim menaxhimin efikas të proceseve dhe burimeve njerëzore.
- **Masa B.3.5** - Ndërveprim i shtuar dhe i përmirësuar i ASPA-s me DAP, në sajë të modelit të ri organizativ të ASPA-s.
- **Masa B.3.6** - Hartimi dhe miratimi i Udhërrëfyesit për Ndërtimin e Kapaciteteve Administrative, me synim garantimin e menaxhimit efikas të fondeve të BE-së nga momenti i aderimit të vendit në BE e në vijim.
- **Masa B.3.8** - Zbatimi i modelit të rishikuar dhe të përmirësuar të trajnimit fillestar.

Komponenti 2.4 Sistemet elektronike për menaxhimin e burimeve njerëzore

OBJEKTIVI SPECIFIK B4: Procedurat e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore facilitohen nga sistemet e gjenerimit të të dhënave të sakta dhe përdorimi i plotë i teknologjisë për thjeshtimin e proceseve të punës në fushën e MBNJ.

Masat për vitet 2024-2030:

- **Masa B.4.1** - Rishikimi i Regjistrit Qendror të Personelit dhe përmirësimi i mëtejshëm i funksionaliteteve të tij.
- **Masa B.4.2** - Gjenerimi automatik i listës së pagave për institucionet publike. Zbatimi me faza deri në arritjen e funksionalitetit të plotë.
- **Masa B.4.3** - Rritja e ndërveprimit online mes institucioneve publike duke përdorur platformat e dedikuara dhe modelevë të miratuara për këtë qëllim.
- **Masa B.4.4** – Trajnim i Njësisë të Burimeve Njerëzore për të gjitha modulet e HRMIS.

Komponenti 2.1

Pranimi meritokratik, konkurrues dhe transparent në shërbimin civil

Objektivi Specifik B.1: Pranimi në institucionet e administratës publike bazuar në konkurs të hapur, në parimin e meritës dhe duke siguruar përzgjedhjen e kandidatëve më të mirë.

Prioritetet

Objektivi konstant i Qeverisë Shqiptare në këtë fushë ka qenë tërheqja dhe mbajtja brenda administratës e nëpunësve të kualifikuar, të rekrutuar mbështetur në meritë e kritere vlerësimi të aplikuara në mënyrë të barabartë për të gjithë, dhe që kanë rezultate të larta në punë. Një sfidë e konsiderueshme përgjatë 10-vjeçarit të zbatimit të ligjit ka qenë krijimi i Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues (TND), ndërsa në të ardhmen do të synohet rritja e efektshmërisë së procedurës së rekrutimit dhe përsosja e testimit të mbështetur në kompetenca. Këto përmirësime do të realizohen përmes ndryshimeve në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”. Ndryshimet në ligj nuk do të çënojnë thelbin e sistemit dhe do të synojnë vetëm adresimin e sfidave të identifikuara përgjatë viteve në zbatimin e procedurave të parashikuara.

Përgjatë periudhës së zbatimit të Strategjisë, synohet hartimi dhe miratimi i kornizës së kompetencave për nëpunësit civilë të të gjitha niveleve, si dhe përshtatja e procedurave të rekrutimit bazuar në këto kompetenca. Procesi i testimit do të përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme, duke synuar përsosjen e mëtejshme të konkurseve, ndryshimin e modalitetit të intervistës verbale dhe aftësive/kompetencave që duhet të vlerësohen gjatë intervistës, si dhe rritjen e objektivitetit të testeve dhe pasurimin e vazhdueshëm të bazës së të dhënave me pyetje të reja për testimet në grup. Një vëmendje e veçantë do t’i kushtohet rritjes së kapaciteteve të anëtarëve të Komiteteve të Pranimit në procedurat e pranimit në shërbimin civil, lëvizjeve paralele dhe të ngritjes në detyrë.

Ky Objektiv Specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme, teksa aktivitetet konkrete për periudhën e parë të zbatimit të SNRAP 2024-2030 mund të gjenden në Planin e Veprimit 2024-2026 (Aneksi nr. 1).

Objektivi Specifik B.1: Pranimi në institucionet e administratës publike bazuar në konkurs të hapur, në parimin e meritës dhe duke siguruar përzgjedhjen e kandidatëve më të mirë.	
Masa B.1.1	Rishikimi i kuadrit ligjor për nëpunësin civil.
Masa B.1.2	Plotësimi i kuadrit nënligjor për garantimin e një procesi të përmirësuar, objektiv dhe meritokratik rekrutimi.
Masa B.1.3	Miratimi i kornizës së kompetencave për shërbimin civil dhe përshtatja e procedurave të rekrutimit me kompetencat e reja.
Masa B.1.4	Rritja e kapaciteteve të anëtarëve të Komiteteve të Pranimit në shërbimin civil dhe për lëvizjet në karrierë, dhe përditësimi i vazhdueshëm i databazës elektronike të pyetjeve.
Masa B.1.5	Zbatimi i një programi të dedikuar për përshtatjen e nëpunësve të rinj me institucionin punëmarrës dhe pozicionin e punës gjatë periudhës së provës apo në rastet e ngritjes në detyrë.

Masa	Treguesi	Aktorët bashkëpërgjegjës
-------------	-----------------	---------------------------------

B.1.1 - Rishikimi i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” me qëllim saktësimin e procedurës së rekrutimit të TND, dhe rishikimin e strukturës së pagave të nëpunësve civilë.	B.1.1 Projektligji me ndryshimet i miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe përcjellë në Kuvend.	Njësitë përgjegjëse: DAP
B.1.2 – Plotësimi i kuadrit nënligjor për garantimin e një procesi të përmirësuar, objektiv dhe meritokratik rekrutimi.	B.1.2 Aktet nënligjore në vijim të ndryshimit të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” të hartuara dhe të miratuara nga Këshilli i Ministrave.	Njësitë përgjegjëse: DAP
B.1.3 - Miratimi i kornizës së kompetencave për shërbimin civil dhe përshtatja e procedurave të rekrutimit me kompetencat e reja.	B.1.3.a Korniza e Kompetencave është miratuar dhe publikuar.	Njësitë përgjegjëse: DAP
B.1.4 - Rritja e kapaciteteve të anëtarëve të Komisioneve të Pranimit në rastet e lëvizjeve në karrierë dhe përditësimi i vazhdueshëm i databazës elektronike të pyetjeve.	B.1.4.a Kapacitetet e anëtarëve të Komisioneve të Pranimit të rritura - 30% e anëtarëve të komiteteve të trajnuar. B.1.4.b Baza e të dhënave elektronike përditësohet 20% çdo 2 vjet.	Njësitë përgjegjëse: DAP
B.1.5 - Zbatimi i një programi të dedikuar për përshtatjen e nëpunësve të rinj me institucionin punëmarrës dhe pozicionin e punës gjatë periudhës së provës apo në rastet e ngritjes në detyrë.	B.1.5. Numri total i sesioneve të organizuara dhe numri i nëpunësve të rinj dhe të promovuar që marrin mentorim.	Njësitë përgjegjëse: ASPA Partnerët: DAP

Komponenti 2.2 Pozicionimi i administratës publike si një punëdhënës i besueshëm, tërheqës dhe konkurrues në tregun e punës.

Objektivi Specifik B.2: Investimi në motivimin dhe mirëqenien e nëpunësve publikë, me synim rritjen e atraksionit dhe forcimin e pozitës së sektorit publik si punëmarrës i besueshëm, tërheqës dhe konkurrues në tregun e punës.

Prioritetet

Rritja e nivelit të motivimit, tërheqja dhe mbajtja e nëpunësve publikë në administratën publike përbëjnë një parakusht jetik për suksesin e përgjithshëm të reformës në administratën publike, duke qenë kështu një prioritet i vazhdueshëm për Qeverinë Shqiptare. Integrimi evropian i vendit kërkon një administratë publike të motivuar në të cilën investohet vazhdimisht në drejtim të përmirësimit të kushteve të punës. Për pasojë, është thelbësore që administrata publike të tërheqë punëmarrës të kualifikuar dhe të mbajë të angazhuar pranë vetes punëmarrësit aktualë, duke konkurruar bindshëm në një treg pune gjithnjë e më agresiv në kërkimin e kandidatëve të përshtatshëm. Krahas angazhimit për të rekrutuar talente të reja, është po aq

prioritare rritja e nivelit të motivimit të nëpunësve ekzistues, me synim fuqizimin e tyre për përballimin me sukses të përgjegjësive dhe intensitetit që sjell procesi i anëtarësimit në BE.

Në drejtim të përmirësimit të shpërblimit financiar, do të vijojë adresimi i elementeve të tjera të reformës së pagave. Krahas rritjes së pagave në vlerë tashmë të realizuar, do të ndryshohet edhe struktura e pagës përmes ndryshimit të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, duke integruar në shpërblimin financiar edhe kritereve motivuese të performancës në punë. Në përputhje me këtë qasje, procesi i vlerësimit të performancës individuale të nëpunësve do të rishikohet dhe do të zbatohet praktikisht, duke u harmonizuar me objektivat e përgjithshme të performancës institucionale.

Përmirësimi i transparencës në shpërblimin financiar të nëpunësve publikë do të jetë një tjetër drejtim i rëndësishëm i masave drejt ndërtimit të një administrate të drejtë dhe të besueshme. Ndërhyrjet do të përfshijnë jo vetëm komunikimin e qartë dhe të detajuar të pagave dhe përfitimeve periodikisht për secilin punonjës, por edhe përfshirjen e informacionit të saktë mbi pagën e pritshme në njoftimet për aplikimet për vendet vakante. Kjo masë do të ndihmojë në tërheqjen e kandidatëve më të mirëinformuar për pozicionin e punës, do të rrisë besimin në procesin e rekrutimit dhe do të promovojë edhe më tej kulturën e transparencës dhe llogaridhënies në administratën publike.

Për të vijuar rritjen e motivimit të nëpunësve publikë, do të zbatohet një model i punës hibride (mes punës në zyrë dhe asaj në distancë), me modalitete të mirëpërcaktuara për të garantuar zbatimin e tij efikas. Gjithashtu, do të vijohet me konsolidimin e punës fleksibël që është në zbatim prej gushtit 2024, si një mekanizëm i rregullt dhe lehtësisht i aplikueshëm që synon balancën më të mirë mes jetës profesionale dhe asaj personale për nëpunësit publikë. Në po të njëjtin drejtim, do të vlerësohet edhe mundësia për të minimizuar orarin e punës për disa institucione/pozicione specifike, me qëllim tërheqjen e personave nga sektori privat që nuk mund të punësohen me kohë të plotë në administratë, si dhe të kategorive të tjera të personave që nuk mund të angazhohen sipas orarit standard.

Me synim tërheqjen e talenteve të reja në administratën publike, do të vijohet me zbatimin me prioritet të programeve për tërheqjen e kandidatëve të rinj të kualifikuar, përfshirë këtu Programin e Ekselencës dhe Programin “Qelizat e Reja”. Paralelisht, në kuadër të përpjekjeve për rritjen e besueshmërisë në profesionalizmin dhe integritetin e stafeve dhe procese institucionale, janë planifikuar masa të rëndësishme që synojnë përmirësimin e kuadrit rregullator dhe fuqizimin e kapaciteteve institucionale për zbatimin praktik të rregullave etike. Si pjesë e këtyre përpjekjeve, do të plotësohet kuadri rregullator për etikën në përputhje me ligjin nr. 152/2013 dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 874/2021. Kjo përfshin miratimin e Manualit të Rregullave Etike për Punonjësit e Administratës Publike, i cili do të shërbejë si një dokument orientues i detajuar për sjelljen etike të punonjësve. Për të garantuar një qasje unifikuese dhe transparente ndaj rasteve të shkeljeve disiplinore, do të hartohet dhe miratohet një udhëzues i ri mbi elementet kryesore procedurale dhe materiale për shqyrtimin e tyre. Gjithashtu, do të zhvillohet një metodologji për monitorimin e zbatimit të rregullave etike në institucionet publike, e cila do të mundësojë vlerësimin e efektivitetit të rregullave ekzistuese dhe identifikimin e hapësirave për përmirësim në zbatimin e tyre brenda institucioneve.

Për të mbështetur zbatimin praktik të rregullave të etikës, Departamenti i Administratës Publike (DAP) dhe institucionet publike do të fuqizojnë kapacitetet e tyre për monitorim, përmes rritjes së ndërgjegjësimit dhe aftësive të nëpunësve për të vepruar në përputhje me detyrimet ligjore dhe rregullatore për etikën dhe integritetin. Paralelisht, në zbatim të Udhërrëfyesit për Reformën e Administratës Publike, këshilltarë të dedikuar për etikën do të caktohen në të gjitha institucionet publike, duke ofruar mbështetje dhe mbikëqyrje të vazhdueshme për promovimin e standardeve etike, duke reflektuar më tej përkushtimin ndaj një administrate publike me integritet të lartë. Këto masa janë të orientuara drejt forcimit të një kulture etike

dhe transparente në administratën publike, duke përmirësuar jo vetëm menaxhimin e burimeve njerëzore, por edhe perceptimin e institucioneve publike nga qytetarët dhe partnerët ndërkombëtarë.

Një nga prioritetet kryesore për forcimin e administratës publike është krijimi i mekanizmave të qëndrueshëm për promovimin e kapitalit njerëzor profesional dhe me integritet. Përmes masave të parashikuara, do të institucionalizohen praktikatat e rregullta që garantojnë vlerësimin dhe avancimin në karrierë të nëpunësve publikë të cilët shquhen për aftësitë, përkushtimin dhe etikën e tyre profesionale. Këto praktika do të ndihmojnë ndërtimin e mëtejshëm të një sistemi meritokratik dhe transparent, ku përforma e lartë dhe integriteti shpërblehen dhe motivojnë zhvillimin profesional të të gjithë nëpunësve.

Gjithashtu, në kuadër të zbatimit vijues të Paketës së Motivimit me synim tërheqjen e talentëve më të mira dhe mbajtjen e burimeve njerëzore ekzistuese në administratën publike, do të sigurohet akses preferencial në shërbime dhe aktivitete për nëpunësit, përfshirë përfitime sociale, profesionale dhe kulturore. Këto masa do të rrisin motivimin, kënaqësinë në punë dhe ndjenjën e përkatësisë, duke forcuar vlerësimin për rolin e administratës publike në shërbimin cilësor ndaj qytetarëve.

Vizioni madhor i të gjitha këtyre masave është pozicionimi i administratës publike si një punëdhënës i besueshëm, tërheqës dhe konkurrues. Për këtë qëllim, do të punohet në mënyrë të dedikuar për promovimin e saj, duke ndërmarrë një sërë nismash konkrete që përfshijnë organizimin e rregullt të Javës së Administratës Publike njëherësh si një mundësi për të treguar vlerësim për punën e përditshme të nëpunësve publike, si edhe për t'i sjellë institucionet më pranë publikut. Në të njëjtën linjë pune, do të rritet prezenca e DAP dhe institucioneve publike në panairët kombëtarë të punës, si dhe bashkëpunimi me partnerë akademikë dhe jo vetëm. Këto masa do të garantojnë pozitën gjithnjë e më të fuqishme dhe dinamike të administratës publike si një zgjedhje e mirë karriere për talentet, duke forcuar imazhin e saj si një strukturë moderne, efikase dhe të orientuar drejt rezultateve.

Ky Objektiv Specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme, teksa aktivitetet konkrete për periudhën e parë të zbatimit të SNRAP 2024-2030 mund të gjenden në Planin e Veprimit 2024-2026 (Aneksi nr. 1).

<i>Objektivi Specifik B.2: Investimi në motivimin dhe mirëqenien e nëpunësve publikë, me synim rritjen e atraksionit dhe forcimin e pozitës së sektorit publik si punëmarrës i besueshëm, tërheqës dhe konkurrues në tregun e punës.</i>	
Masa B.2.1	Ndryshimi i strukturës së pagave, duke synuar thjeshtëzimin e saj dhe rritjen e elementeve motivuese në shpërblimin financiar.
Masa B.2.2	Rritja e transparencës së pagave për nëpunësit publikë, përfshirë edhe në njoftimet për aplikime për vendet vakante.
Masa B.2.3	Miratimi dhe zbatimi i metodologjisë së re për vlerësimin e pozicioneve të punës në administratën publike.
Masa B.2.4	Rishikimi dhe zbatimi praktik i procesit të vlerësimit të performancës individuale, duke garantuar harmonizim me performancën institucionale.
Masa B.2.5	Plotësimi i kuadrit rregullator për etikën, në zbatim të ligjit nr. 152/2013 dhe VKM nr. 874/2021.
Masa B.2.6	Përmirësimi i kapaciteteve të DAP dhe institucioneve publike për monitorimin e zbatimit në praktikë të rregullave të etikës nga nëpunësit e administratës publike.
Masa B.2.7	Zbatimi i programeve të posaçme me synim tërheqjen e nëpunësve civilë të kualifikuar.

Masa B.2.8	Konsolidimi i praktikave të rregullta promovuese të kapitalit njerëzor profesional dhe me integritet të administratës publike.
Masa B.2.9	Zbatimi gradual i modalitetit të punës hibride në institucionet publike, në përputhje me standardet evropiane dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.
Masa B.2.10	Rritja e atraksionit të shërbimit në sektorin publik, përmes garantimit të aksesit preferencial në shërbime dhe aktivitete për nëpunësit e administratës publike.
Masa B.2.11	Promovimi i shërbimit civil dhe administratës publike si punëdhënës i besueshëm, tërheqës dhe konkurrues.

Masa	Treguesi	Aktorët bashkëpërgjegjës
<p>Masa B.2.1 – Aplikimi i strukturës së thjeshtëzuar të pagave dhe rritjes së elementeve motivuese në shpërblimin financiar, përfshirë bonusin për performancën në punë.</p>	<p>B.2.1 Ndryshimet në ligjin nr. 152/2013 për Shërbimin Civil të miratuara.</p> <p>B.2.1 Shpërblimi për performancën në punë i aplikuar në praktikë.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse: DAP</p>
<p>Masa B.2.2 - Rritja e transparencës së pagave për nëpunësit publikë, përfshirë edhe në njoftimet për aplikime për vendet vakante.</p>	<p>B.2.2 Njoftimet për aplikim për vende vakante në shërbimin civil përmbajnë informacion të plotë mbi pagën e pozicioneve vakante.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse: DAP</p>
<p>Masa B.2.3 - Miratimi dhe zbatimi i metodologjisë së re për vlerësimin e pozicioneve të punës në administratën publike.</p>	<p>B.2.3.a VKM për klasifikimin e pozicioneve të punës, i ndryshuar.</p> <p>B.2.3.b Numri i punonjësve të Njësive të Burimeve Njerëzore të Trajnuar për zbatimin e metodologjisë së re.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse: DAP</p> <p>Partnerët: ASPAA</p>
<p>Masa B.2.4 - Rishikimi dhe zbatimi praktik i procesit të vlerësimit të performancës individuale, duke garantuar harmonizim me performancën institucionale.</p>	<p>B.2.4.a Akti për vlerësimin e rezultateve në punë i ndryshuar dhe miratuar.</p> <p>B.2.4.b Metodologjia e re zbatohet në të gjitha sistemet ministrore.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse: DAP</p>
<p>Masa B.2.5 - Plotësimi i kuadrit rregullator për etikën, në zbatim të ligjit nr. 152/2013 dhe VKM nr. 874/2021.</p>	<p>B.2.5.a Manuali praktik i Rregullave të Etikës për Nëpunësit e Administratës Publike i miratuar .</p> <p>B.3.5.b Udhëzimi i ri për “Organet Disiplinore dhe procedurën e shqyrtimit të shkeljeve disiplinore i miratuar .</p> <p>B.3.5.c Udhëzimi për “Rolin e njësive të burimeve njerëzore në zbatimin e legjislacionit për etikën dhe përcaktimin e procedurave të mbikëqyrjes nga Departamenti i Administratës Publike”, i miratuar .</p>	<p>Njësitë përgjegjëse: DAP</p>
<p>Masa B.2.6 - Përmirësimi i kapaciteteve të DAP dhe institucioneve publike për monitorimin e zbatimit në praktikë të rregullave të etikës nga nëpunësit e administratës publike.</p>	<p>B.2.6.a Nëpunësit e njësive të burimeve njerëzore të institucioneve të administratës publike, të trajnuar.</p> <p>B.2.6.b Këshilltarët e Etikës janë caktuar në të gjitha institucionet publike.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse: DAP</p>
<p>Masa B.2.7 – Zbatimi i programeve të posaçme me synim tërheqjen e nëpunësve civilë të kualifikuar.</p>	<p>B.2.7.a Kuadri i ri ligjor i programit të ekselencës i miratuar.</p> <p>B.2.7.b Fushatë <i>branding</i> për administratën publike me qëllim</p>	<p>Njësitë përgjegjëse: DAP</p>

	rekrutimin e kandidatëve të kualifikuar për pozicionet në shërbimin civil.	
Masa B.2.8 – Konsolidimi i praktikave të rregullta promovuese të kapitalit njerëzor profesional dhe me integritet të administratës publike.	B.2.8.a Udhëzues Orientues i miratuar me kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve dhe fituesve, si dhe organizimi i procedurës. B.2.8.b Numri i çmimeve të ndara çdo vit.	Njësitë përgjegjëse: MAPA, DAP
Masa B.2.9 - Zbatimi gradual i modalitetit të punës hibride në institucionet publike, në përputhje me standardet evropiane dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare.	B.2.9.a Manual Orientues i miratuar. B.2.9.b Puna hibride aplikohet dhe pilotohet në institucionet e administratës publike.	Njësitë përgjegjëse: DAP Partnerët: AKSHI
Masa B.2.10 - Rritja e atraksionit të shërbimit në sektorin publik, përmes garantimit të aksesit preferencial në shërbime dhe aktivitete për nëpunësit e administratës publike.	B.2.10.a Tarifat preferenciale për përdorimin e hapësirave sportive publike të miratuara.	Njësitë përgjegjëse: MAPA Partnerët: MIE, MEKI, MAS
Masa B.2.11 - Promovimi i rolit të shërbimit civil dhe administratës publike si punëdhënës i besueshëm, tërheqës dhe konkurrues.	B.2.11.a 1 Javë e Administratës Publike e organizuar çdo vit (periodicitet vjetor). B.2.11.b Pjesëmarrje e DAP në panairët kombëtare të punës. B.2.11.c Marrëveshje Bashkëpunimi të nënshkruara me IAL-të dhe partnerë të tjerë.	Njësitë përgjegjëse: DAP

Komponenti 2.3 Rritja e kapaciteteve të administratës publike

Objektivi Specifik B.3: Investimi në zhvillimin profesional dhe rritjen e kapaciteteve të nëpunësve të administratës publike, për të mbështetur dhe avancuar agjendën kombëtare të integritit evropian të Shqipërisë.

Përmbushja e këtij Qëllimi Politik synon zhvillimin e aftësive profesionale në të gjitha nivelet e administratës publike, me synim krijimin e kapaciteteve administrative të afta për të përmbushur dhe përparuar procesin e integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Në këtë drejtim, ridimensionimi i Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) do të jetë në fokus të veçantë, paralelisht me garantimin e infrastrukturës bashkëkohore dhe efikase të trajnimit, teksa ato ekzistueset u dëmtojnë nga tërmeti i fundit të vitit 2019, duke e bërë të nevojshme zhvillimin e trajnimeve në rrugë digjitale ose në hapësira të marra me qera apo të mundësuar nga institucione të tjera.

Me adresimin e nevojës për infrastrukturë të qëndrueshme të ASPA-s, kjo e fundit do të vijojë të jetë institucioni udhëheqës në trajnimin e sektorit publik në Shqipëri dhe do të mundësojë rritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve të nëpunësve publikë, në bashkëpunim me ofrues të tjerë të trajnimeve për fusha specifike. Përgjatë zbatimit të SNRAP 2024-2030, do të jetëzohet vizioni për ASPA-n si një qendër ekselence e

formimit profesional publik. Modeli i saj i ristrukturuar organizativ do të mundësojë ndërveprim të shtuar dhe të përmirësuar me DAP, si dhe koordinim më të mirë në zhvillimin e rregullt të Vlerësimit të Nevojave për Trajnime (VNT) dhe ofrimin e tyre të dobishëm për nëpunësit publikë. Kjo qasje synon rritjen e efikasitetit të ASPA-s në ndërlidhjen e kërkesave për trajnime me politikën përkatëse të hartuara dhe zbatuara. Gjithashtu, për të garantuar vetëqëndrueshmërinë financiare të ASPA-s, do të zbatohet një model i dedikuar ekonomik që mundëson ofrimin e trajnimeve për palë të treta kundrejt pagesës, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Modulet e trajnimit për të tretët do të hartohen dhe zbatohen në dialog të vazhdueshëm me të tretët.

Gjithashtu, rishikimi i planifikuar i VKM-së nr. 138/2014 “Për rregullat e organizimit e të funksionimit të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike dhe trajnimin e nëpunësve civilë”, i ndryshuar, do të targetojë edhe reformimin e sistemit të trajnimit të ofruar nga ASPA. Në këtë kuadër, do të rishikohen kriteret për përzgjedhjen e trajnerëve dhe përcaktimin e masës së pagesës së tyre, me qëllim tërheqjen e ekspertëve më të mirë (ku prioritet do të ketë trupa ekzistuese e ekspertizës sektoriale brenda administratës publike), si dhe rritjen e cilësisë dhe atraktivitetit të ofertës trajnuese të ASPA-s.

Krahas pasurimit të fokusit të ofertës trajnuese, rritja e kapaciteteve administrative në drejtim të thellimit të përgatitjeve për zbatimin e suksesshëm të agjendës kombëtare për integrimin evropian mbetet thelbësore. Forcimi i kapaciteteve administrative do të prioritetizohet në përputhje me zotimet e parashikuara në Udhërrëfyesin për Reformën në Administratën Publike 2023-2030. Në zbatim të këtyre angazhimeve, ASPA, në bashkëpunim me DAP, do të zhvillojë një Vlerësim të Nevojave për Trajnim (VNT), pasuar nga hartimi i një Plani të detajuar Trajnimi për adresimin e këtyre nevojave. Prioritetet kryesore të trajnimit do të targetojnë (i) nevojat për rritje kapacitetesh për t’iu përgjigjur kërkesave dhe intensivitetit që sjell procesi negociues dhe (ii) përshtatjen e aftësive digjitale të administratës publike shqiptare për digjitalizimin e mëtejshëm me sukses të proceseve të punës dhe ofrimin e shërbimeve.

Etika në administratë dhe zhvillimi i aftësive analitike dhe planifikuese do të jenë fusha të tjera ku procesi i rritjes së kapaciteteve administrative do të marrë vëmendje të shtuar. Gjithashtu, me synimin për të përmirësuar menaxhimin efikas të burimeve njerëzore dhe proceseve institucionale, do të organizohen trajnime të rregullta dhe të dedikuara për drejtuesit e nivelit të mesëm dhe të lartë, me qëllim përmirësimin e aftësive të tyre udhëheqëse dhe menaxheriale.

Përpjekje të dedikuara do të fokusohen edhe në thellimin e bashkëpunimit të ASPA-s me institucionet homologe, autoritetet e tjera dhe rrjetet me ekspertizë në trajnimin e sektorit publik, si në BE, ashtu edhe më gjerë, me synim shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira. Ky angazhim do të forcojë kapacitetet e institucionit dhe do të promovojë përafrimin e standardeve të administratës publike shqiptare me ato evropiane.

Të gjitha masat e mësipërme, si dhe ato të parashikuara nën komponentët e tjerë përgjatë të gjitha Qëllimeve të Politikës së SNRAP 2024-2030 kanë një mision të dyfishtë: ato do të zbatohen në funksion të një vizioni afatgjatë për përgatitjen e administratës publike shqiptare jo vetëm për të përballuar me sukses procesin e negociatave të anëtarësimit, por mbi të gjitha për të konsoliduar një strukturë institucionale që do të kryejë detyrat e saj denjësisht edhe pas aderimit të Shqipërisë në BE. Në këtë kuadër të punës për Kapitullin 22 të *acquis*-së “Politika rajonale” dhe nën drejtimin e Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, do të hartohet, miratohet dhe zbatohet një Udhërrëfyes i dedikuar për Ndërtimin e Kapaciteteve Administrative. Teksa fokusi i Udhërrëfyesit do të jetë rritja e kapaciteteve të të gjithë ekosistemit të aktorëve që ndajnë kompetenca dhe detyra për zbatimin e *acquis*-së dhe menaxhimin efikas të fondeve evropiane, ai do të shërbejë si instrumenti kryesor për përgatitjen e administratës publike për kryerjen e suksesshme të këtyre detyrave, veçanërisht në drejtim të zbatimit efikas të politikës së kohezionit në të gjithë territorin e vendit që nga momenti i anëtarësimit të Shqipërisë në BE e në vijim.

Objekti i Specifik B.3: Investimi në zhvillimin profesional të nëpunësve të të gjitha niveleve të administratës publike për të mbështetur dhe avancuar agjendën kombëtare të integritit evropian të Shqipërisë.

Masa B.3.1	Hartimi dhe zbatimi efikas i modelit ekonomik të ASPA-s në ofrimin e trajnimeve për të tretët, në përputhje me kuadrin ligjor dhe atë rregullator.
Masa B.3.2	Rishikimi i kriterëve për përzgjedhjen e trajnerëve dhe masës së pagesës së tyre, me synim tërheqjen e ekspertëve më të mirë në fushat përkatëse, si dhe rritjen e atraksionit të ofertës së trajnimit pranë ASPA-s.
Masa B.3.3	Rishikimi i fondit të trajnimeve të ofruara nga ASPA, me fokus forcimin e kapaciteteve analitike, planifikuese dhe digjitale të nëpunësve, si dhe njohurive për procesin e integritit evropian.
Masa B.3.4	Trajnim i dedikuar dhe periodik për përmirësimin e aftësive udhëheqëse dhe menaxheriale të drejtuesve të nivelit të mesëm dhe të lartë, me synim menaxhimin efikas të proceseve dhe burimeve njerëzore.
Masa B.3.5	Thellimi i bashkëpunimit të ASPA-s me institucionet homologe, autoritete të tjera dhe rrjete me ekspertizë në fushën e trajnimit të sektorit publik në BE dhe më gjerë.
Masa B.3.6	Hartimi, miratimi dhe zbatimi i Udhërrëfyesit për Ndërtimin e Kapaciteteve Administrative, me synim garantimin e menaxhimit efikas të fondeve të BE-së nga momenti i aderimit të vendit në BE e në vijim.
Masa B.3.7	Zbatimi i modelit të rishikuar dhe të përmirësuar të trajnimit fillestar.

Masa	Treguesi	Aktorët bashkëpërgjegjës
<p>Masa B.3.1 - Hartimi dhe zbatimi efikas i modelit ekonomik të ASPA-s në ofrimin e trajnimeve për të tretët, në përputhje me kuadrin ligjor dhe atë rregullator.</p>	<p>B.3.1.a Ndryshimet në VKM nr. 138, datë 12.03.2014 “Për rregullat e organizimit e të funksionimit të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike dhe trajnimin e nëpunësve civilë”, i ndryshuar, të miratuara.</p> <p>B.3.1.b Të paktën 3 paketa trajnimi mbi kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi konsolidohen dhe ofrohen rregullisht në fushat me interes të lartë për të tretët.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse: ASPA</p>
<p>Masa B.3.2 - Rishikimi i kriterëve për përzgjedhjen e trajnerëve dhe masës së pagesës së tyre, me synim tërheqjen e ekspertëve më të mirë në fushat përkatëse, si dhe rritjen e atraksionit të ofertës së trajnimit pranë ASPA-s.</p>	<p>B.2.2.a Ndryshimet në VKM nr. 138, datë 12.03.2014 “Për rregullat e organizimit e të funksionimit të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike dhe trajnimin e nëpunësve civilë”, i ndryshuar, të miratuara.</p> <p>B.2.2.b Numri rritës i trajnerëve të rinj të emëruar sipas procedurës së rishikuar.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse: ASPA, DAP</p>
<p>Masa B.3.3 - Rishikimi i fondit të trajnimeve të ofruara nga ASPA, me fokus forcimin e kapaciteteve analitike, planifikuese dhe digjitale të nëpunësve, si dhe njohurive për procesin e integritimit evropian.</p>	<p>B.3.3.a Vlerësimi i Nevojave për Trajnim kryhet periodikisht mbi baza vjetore.</p> <p>B.3.3.b Numri i nëpunësve të Njësive të Burimeve Njerëzore të Trajnuar për zbatimin e metodologjisë së re.</p> <p>B.3.3.c 1 paketë trajnimi e hartuar për anglishten ligjore sektoriale të lidhur me procesin e integritimit evropian.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse: ASPA</p> <p>Partnerët: DAP</p>
<p>Masa B.3.4 - Trajnim i dedikuar dhe periodik për përmirësimin e aftësive udhëheqëse dhe menaxheriale të drejtuesve të nivelit të mesëm dhe të lartë, me synim menaxhimin efikas të proceseve dhe burimeve njerëzore.</p>	<p>B.3.4.a Paketa e trajnimit për zhvillimin e lidhshëm të konsoliduar dhe bërë pjesë e fondit të trajnimeve të ASPA-s.</p> <p>B.3.4.b 267 drejtues të mesëm dhe të lartë të trajnuar çdo vit.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse: ASPA</p> <p>Partnerët: DAP</p>
<p>Masa B.3.5 – Thellimi i bashkëpunimit të ASPA-s me institucionet homologe, autoritete të tjera dhe rrjete me ekspertizë në fushën e trajnimit të sektorit publik në BE dhe më gjerë.</p>	<p>B.3.5.a Numër marrëveshjesh të reja bashkëpunimi të nënshkruara.</p> <p>B.3.5.b Numri i forumeve/shkëmbimeve/vizitave</p>	<p>Njësitë përgjegjëse: ASPA</p>

	studimore me institucione homologe jashtë vendit.	
Masa B.3.6 - Hartimi, miratimi dhe zbatimi i Udhërrëfyesit për Ndërtimin e Kapaciteteve Administrative, me synim garantimin e menaxhimit efikas të fondeve të BE-së nga momenti i aderimit të vendit në BE e në vijim.	B.3.7.a 1 Udhërrëfyes për Kapacitetet Administrative i miratuar. B.3.7.b 100% e punonjësve të angazhuar me menaxhimin e fondeve strukturore të BE-së (në të ardhmen) të trajnuar.	Njësitë përgjegjëse: MAPA Partnerët: SASPAC MSHPV AMSHC
Masa B.3.8 – Zbatimi i modelit të rishikuar dhe të përmirësuar të trajnimit fillestar.	B.3.8.a Hartimi i kurrikulës së rishikuar të trajnimit fillestar B.3.8.b Numër nëpunësish në periudhë prove që i nënshtrohen trajnimit fillestar.	Njësitë përgjegjëse: MAPA ASPА

Komponenti 2.4 *Sistemet elektronike për menaxhimin e burimeve njerëzore*

Objektivi specifik B.4: Procedurat e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore facilitohen nga sistemet e gjenerimit të të dhënave të sakta dhe përdorimi i plotë i teknologjisë për thjeshtimin e proceseve të punës në fushën e MBNJ.

Prioritetet

Sistemet elektronike përdoren gjerësisht për të ndihmuar në menaxhimin e proceseve të ndryshme të punës. Përdorimi i këtyre sistemeve për të lehtësuar dhe përmirësuar procedurat ekzistuese të menaxhimit të burimeve njerëzore do të ndihmojnë jo vetëm në rritjen e efikasitetit dhe shpejtësisë së këtyre proceseve, por do të kontribuojnë edhe në ndërtimin dhe konsolidimin e një administrate të gjelbër, ku përdorimi i letrave dhe shkresave do të reduktohet maksimalisht.

Pas sulmit kibernetik të vitit 2022, Regjistri Qendror i Personelit ka hyrë në një fazë rishikimi tërësor në drejtim të organizimit të sistemit teknologjik mbështetës, ashtu edhe në drejtim të proceseve të punës që mbështet. Ky proces përditësimi i sistemit ka për qëllim thjeshtësimin e përdorimit, ashtu edhe rritjen e sigurisë ndaj sulmeve të mundshme kibernetike. Zbatimi i procesit të rishikimit të sistemit do të zhvillohet në disa faza, në përfundim të të cilave parashikohet që sistemi të jetë operativ me të gjitha funksionalitetet në vitin 2028.

Një ndër funksionet kryesore që do të zhvillohet përmes përditësimit të sistemit është gjenerimi automatik i listës së pagave të institucioneve, duke mundësuar llogaritjen elektronike të pagave dhe të kostos së tyre për institucionet publike. Kjo do të lehtësojë gjithashtu edhe kryerjen e skenarëve për ndërmarrjen e politikave të caktuara në këtë fushë.

Në përputhje me iniciativat e Qeverisë Shqiptare për digjitalizimin e mëtejshëm të proceseve të punës, do të zhvillohen formate dhe modele të veçanta elektronike, mes të tjerash, edhe për kryerjen e një serie procesesh për menaxhimin e burimeve njerëzore. Këto formate do të ndihmojnë institucionet që të standardizojnë komunikimin dhe të përmirësojnë efikasitetin e proceseve të ndryshme të punës, duke

reduktuar ndjeshëm gabimet. Procesi do të mbështetet nga trajnime të dedikuara për nëpunësit e përfshirë dhe do të shoqërohet nga Raporte të posaçme Monitorimi për të siguruar funksionimin efikas të sistemeve dhe përdorimin e tyre optimal.

Ky Objektiv Specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme, teksa aktivitetet konkrete për periudhën e parë të zbatimit të SNRAP 2024-2030 mund të gjenden në Planin e Veprimit 2024-2026 (Aneksi nr. 1).

Objekivi Specifik B.4: Procedurat e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore facilitohen nga sistemet e gjenerimit të të dhënave të sakta dhe përdorimi i plotë i teknologjisë për thjeshtimin e proceseve të punës në fushën e MBNJ.	
Masa B.4.1	Rishikimi i Regjistrit Qendror të Personelit dhe përmirësimi i mëtejshëm i funksionaliteteve të tij.
Masa B.4.2	Gjenerimi automatik në faza i listës së pagave për institucionet publike.
Masa B.4.3	Rritja e ndërveprimit virtual mes institucioneve publike, përmes përdorimit të platformave të dedikuara dhe modeleve të miratuara për këtë qëllim.
Masa B.4.4	Përgatitja dhe zhvillimi i një pakete të plotë trajnime për të gjitha modulet e HRMIS për Drejtorinë e Burimeve Njerëzore në institucionet e administratës publike.

Masa	Treguesi	Aktorët bashkëpërgjegjës
Masa B.4.1 – Rishikimi i Regjistrit Qendror të Personelit dhe përmirësimi i mëtejshëm i funksionaliteteve të tij.	B.4.1 Regjistri Qendror i Personelit është i përditësuar dhe me funksionalitete të përmirësuara vazhdimisht.	Njësitë përgjegjëse: DAP Partnerët: AKSHI
Masa B.4.2 – Gjenerimi automatik në faza i listës së pagave për institucionet publike.	B.4.2 Lista e pagave e gjeneruar automatikisht për të gjitha institucionet publike.	Njësitë përgjegjëse: DAP Partnerët: AKSHI, MF
Masa B.4.3 – Rritja e ndërveprimit virtual mes institucioneve publike, përmes përdorimit të platformave të dedikuara dhe modeleve të miratuara për këtë qëllim.	B.4.3 Ndërveprimi efikas i institucioneve publike përmes përdorimit të platformave të dedikuara.	Njësitë përgjegjëse: DAP Partnerët: AKSHI

<p>Masa B.4.4 – Përgatitja dhe zhvillimi i një pakete të plotë trajnimi për të gjitha modulet e HRMIS për Drejtoritë e Burimeve Njerëzore në institucionet e administratës publike.</p>	<p>B.4.3.a Paketa e trajnimit mbi modulet e HRMIS e finalizuar.</p> <p>B.4.3.b Të gjithë nëpunësit e Burimeve Njerëzore në të gjitha institucionet publike të trajnuar për përdorimin e HRMIS.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse: DAP</p> <p>Partnerët: ASPA, AKSHI</p>
--	--	---

Qëllimi i Politikës 3: Ofrimi i Shërbimeve dhe Digjitalizimi

Qëllimi i Politikës 3 për ofrimin e shërbimeve publike për qytetarët dhe bizneset përmes një portali të vetëm synon përmirësimin e vazhdueshëm të aksesit në to dhe efikasitetit të tyre. Kjo qasje synon të thjeshtojë proceset, të reduktojë burokracinë dhe të ofrojë një përvojë më të mirë përdoruesish, duke lehtësuar ndërveprimin mes qytetarëve, bizneseve dhe administratës publike. Impakti fundor i kësaj qasjeje targeton forcimin e besimit në institucionet publike, duke ndikuar edhe në nxitjen e zhvillimit ekonomik.

Teksa teknologjia ndryshon me ritme të shpejta dhe sfidat e sigurisë rriten në mënyrë eksponenciale në ekosisteme gjithnjë e më komplekse, përshtatja dhe zbatimi i teknologjive të reja mbetet një sfidë e vazhdueshme për individët, bizneset dhe qeveritë në epokën e qeverisjes elektronike. Në këtë kontekst, si një platformë kyçe për shërbimet publike, portal e-albania duhet të jetë fleksibël dhe të adaptohet me teknologjitë e reja, me qëllim si ruajtjen e standardit të vendosur për qeverisjen digjitale, ashtu edhe për të përmirësuar më tej ofrimin e shërbimeve publike. Duke qenë pika e vetme e kontaktit të qytetarëve dhe bizneseve për marrjen e shërbimeve publike sfida e viteve të fundit ka qenë përballja me rritjen e përdoruesmerisë dhe trafikut në mënyrë eksponenciale si dhe garantimin e performancës së këtyre infrastrukturave ekzistuese të implementuara me teknologjitë e fundit.

Komponentët e kësaj shtylle adresojnë përmirësimin e platformës e-Albania, ri-inxhinierimin e shërbimeve përmes thjeshtimit të procedurave administrative, si dhe ndërtimin dhe përsosjen e aftësive digjitale të shoqërisë së gjerë. Masat që do të ndërmerren nën këtë shtyllë të Strategjisë synojnë të ofrojnë shërbime digjitale gjithëpërfshirëse dhe pa kufi, për qytetarët dhe bizneset.

Vizioni është i qartë dhe ambicioz sa i përket vijimit të punës për transformimin digjital, të mbështetur nga Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2022 – 2026, e cila ka synimin të inkurajojë investimet në fushat kyçe të teknologjisë, siç janë informatika e avancuar, përpunimi i të dhënave, inteligjenca artificiale, siguria kibernetike dhe aftësitë digjitale të avancuara, të cilat janë thelbësore për zhvillimin e vendit. Synimi është: të lidhim bizneset, administratën publike dhe qytetarët me teknologjinë dhe burimet më të fundit të saj, duke siguruar njëkohësisht që këto shërbime të jenë të aksesueshme edhe për personat me njohuri digjitale të limituar apo mungesë në mjetet teknologjike që i nevojiten.

Në kuadër të këtij vizioni, do të punohet për të zhvilluar më tej qeverisjen elektronike dhe proceset e digjitalizimit të administratës publike. Synohet të përmirësohet qasja e qytetarëve dhe bizneseve ndaj shërbimeve, duke u ofruar atyre mundësi më të lehta dhe të shpejta për të përfituar shërbimet publike. Ky përmirësim do të shoqërohet me një rritje të ndjeshme të cilësisë së shërbimeve elektronike, duke i bërë ato më efikase dhe transparente.

Objektivat e mëposhtëm Specifikë dhe masat e renditura për secilin Objektiv do t'i shërbejnë arritjes së Qëllimit të Politikës.

Përmbledhje e Qëllimit të Politikës 3 – Ofrimi i Shërbimeve dhe Digjitalizimi

Komponenti 3.1 Ri-inxhinierimi i shërbimeve dhe thjeshtimi i procedurave administrative

OBJEKTIVI SPECIFIK C1: Ri-inxhinierimi dhe optimizimi i shërbimeve publike elektronike, duke rritur aksesin për qytetarët dhe bizneset, si dhe duke efikasitetin përmes teknologjisë së avancuar dhe thjeshtimit të proceseve me fokus te përdoruesi.

Masat për vitet 2024-2030:

- **Masa C.1.1** – Ri-inxhinierimi i portalit e-Albania bazuar në Aksesueshmërinë dhe Përvojën e Përdoruesit (UX).
- **Masa C.1.2** – Riorganizimi i shërbimeve elektronike me standarde të larta, të personalizuar dhe të bazuara në ngjarje proaktive.
- **Masa C.1.3** – Përditësimi i Infrastrukturës bazë të shërbimeve elektronike dhe Platformës Qeveritare të Ndërveprimit (GG).

Komponenti 3.2 Aftësitë digjitale

OBJEKTIVI SPECIFIK C2: Rritja e aftësive dhe gjithëpërfshirjes digjitale

Masat për vitet 2024-2030:

- **Masa C.2.1** – Forcimi i kompetencave bazë minimale të aftësive digjitale në arsimin parauniversitar.
- **Masa C.2.2** – Përmirësimi i aksesueshmërisë së shërbimeve për qytetarët dhe bizneset.
- **Masa C.2.3** – Përmirësimi i aksesit në shërbimet elektronike për target-grupet e caktuara.
- **Masa C.2.4** – Forcimi i mundësuesve parësorë të GovTech-ut: Data Governance.
- **Masa C.2.5** – Përmirësimi i mundësuesve parësorë të GovTech-ut: Institucionet publike.

Komponenti 3.1 Ri-inxhinierimi i shërbimeve dhe thjeshtimi i procedurave administrative

Objektivi specifik C.1: Ri-inxhinierimi dhe optimizimi i shërbimeve publike elektronike, duke rritur aksesin për qytetarët dhe bizneset, si dhe efikasitetin përmes teknologjisë së avancuar dhe thjeshtimit të proceseve me fokus te përdoruesi.

Prioritetet

Në kuadër të nismës së qeverisë, çdo shërbim publik tashmë ofrohet online përmes platformës e-albania për qytetarët dhe bizneset, dhe jo më në sportele si një hap i rëndësishëm i epokës së re të Revolucionit Digjital, me përjashtim të rasteve kur prania fizike e qytetarit është e domosdoshme.

Një nismë e rëndësishme është vijimi i suksesshëm i procesit të ri-inxhinierimit të shërbimeve dhe thjeshtimi i mëtejshëm i procedurave administrative, për të lehtësuar marrjen e tyre nga qytetarët dhe bizneset, si dhe për të ulur kohën e nevojshme për të marrë shërbimin. Realizimi i procesit të riinxhinierimit dhe derregullimit do kalojë nëpër disa faza dhe më në detaje përfshin:

- inventarizimin e të gjithë shërbimeve online dhe offline, nga konsultimi i bazës ligjore mbi të cilën rregullohen;
- reduktimin dhe thjeshtëzimin e kritereve thelbësore për përfitimin e shërbimit;
- eliminimin e dokumenteve që mund të administrohen përmes ndërveprimit të institucioneve publike;
- uljen e afateve për përfitimin e aktit administrativ, përmes ndryshime ligjore përkatëse.

Shërbimet do të mund të organizohen sipas modelit ‘life events’ për të unifikuar të gjitha shërbimet e nevojshme për qytetarët, nga momenti që lindin (certifikata e lindjes) e duke e ndjekur në të gjitha hapat e jetës. Rëndësi të veçantë në të gjitha këto nisma do të kenë edhe personat me nevoja të veçanta, duke punuar për ta bërë e-Albania të aksesueshme për të gjithë.

Ky Objektiv Specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme, teksa aktivitetet konkrete për periudhën e parë të zbatimit të SNRAP 2024-2030 mund të gjenden në Planin e Veprimit 2024-2026 (Aneksi nr. 1).

<i>Objektivi Specifik C.1: Ri-inxhinierimi dhe optimizimi i shërbimeve publike elektronike, duke rritur aksesin për qytetarët dhe bizneset, si dhe efikasitetin përmes teknologjisë së avancuar dhe thjeshtimit të proceseve me fokus te përdoruesi.</i>	
Masa C.1.1	Ri-inxhinierimi i portalit e-Albania bazuar në Aksesueshmërinë dhe Përvojën e Përdoruesit (UX).
Masa C.1.2	Riorganizimi i shërbimeve elektronike me standarde të larta, të personalizuar dhe të bazuara në ngjarje proaktive.
Masa C.1.3	Përditësimi i Infrastrukturës bazë të shërbimeve elektronike dhe Platformës Qeveritare të Ndërveprimit (GG).

Masa	Treguesi	Aktorët bashkëpërgjegjës
Masa C.1.1 – Ri-inxhinierimi i portalit e-Albania bazuar në Aksesueshmërinë dhe	C.1.1.a Portali <i>e-Albania</i> (web dhe mobile) i përmirësuar, me funksionalitete të reja dhe në përputhje me standardet e pranueshme të aksesueshmërisë.	Njësitë përgjegjëse: AKSHI

Përvojën e Përdoruesit (UX).		Partnerët:
Masa C.1.2 – Riorganizimi i shërbimeve elektronike me standarde të larta, të personalizuara dhe të bazuara në ngjarje proaktive.	C.1.2.a 6 life events të implementuara në nivelin 4. C.1.2.b Mekanizmi i përshtypjeve dhe opinioneve të përdoruesit për shërbimet elektronike plotësisht funksional (përdorimi i teknologjive të reja për mbledhjen dhe analizimin automatik të përgjigjeve).	Njësitë përgjegjëse: AKSHI Partnerët:
Masa C.1.3 – Përditësimi i Infrastrukturës bazë të shërbimeve elektronike dhe Platformës Qeveritare të Ndërveprimit (GG).	C.1.5.a 20% rritje në rastet e përdorimit dhe 15% rritje në transaksionet e Platformës së Ndërveprimit.	Njësitë përgjegjëse: AKSHI

Komponenti 3.2 *Aftësitë digjitale të shoqërisë së gjerë*

Objektivi specifik C.2: Rritja e aftësive dhe gjithëpërfshirjes digjitale përmes zbatimit të masave që sigurojnë arritjen e kompetencave bazë digjitale për nxënësit, përmirësojnë aksesin dhe cilësinë e shërbimeve elektronike për qytetarët, dhe fuqizojnë mundësitë teknologjike në sektorin publik.

Prioritetet

Nevoja për të rritur nivelin e aftësive digjitale të popullatës do të zërë një vend të vecantë në objektivat strategjike nën këtë shtyllë. Përmes investimeve në trajnime dhe kurse, synohet përfitimi i njohurive bazë dhe të avancuara në fushën e teknologjisë nga qytetarët, duke i bërë ata pjesë e kësaj rrugëtimi transformues.

Një prej synimeve kryesore është përmirësimi i platformës e-Albania dhe infrastrukturave të saj korresponduese. Kjo do të realizohet përmes shtimit të funksionaliteteve të reja që do të japin mundësi më të gjerë për qytetarët dhe bizneset për të përfituar shërbimet publike. Duke marrë parasysh se tashmë 95% e shërbimeve ofrohen online në platformën e-Albania, kjo përpjekje do të ndikojë shumë në përmirësimin e përfshirjes digjitale.

Ky Objektivi Specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme, teksa aktivitetet konkrete për periudhën e parë të zbatimit të SNRAP 2024-2030 mund të gjenden në Planin e Veprimit 2024-2026 (Aneksi nr. 1).

Objektivi Specifik C.2: Rritja e aftësive dhe gjithëpërfshirjes digjitale përmes zbatimit të masave që sigurojnë arritjen e kompetencave bazë digjitale për nxënësit, përmirësojnë aksesin dhe cilësinë e shërbimeve elektronike për qytetarët, dhe fuqizojnë mundësitë teknologjike në sektorin publik.

Masa C.2.1	Forcimi i kompetencave bazë minimale të aftësive digjitale në arsimin parauniversitar.
Masa C.2.2	Përmirësimi i aksesueshmërisë së shërbimeve për qytetarët dhe bizneset
Masa C.2.3	Përmirësimi i aksesit në shërbimet elektronike për target grup të caktuar
Masa C.2.4	Forcimi i mundësuesve parësorë të GovTech-ut: Data Governance
Masa C.2.5	Përmirësimi i mundësuesve parësorë të GovTech-ut: Institucionet publike.

Masa	Treguesi	Aktorët bashkëpërgjegjës
Masa C.2.1 – Forcimi i kompetencave bazë minimale të aftësive digjitale në arsimin parauniversitar.	C.2.1.a Numri i laboratorëve Smart funksionalë në shkollat e arsimit parauniversitar publik.	Njësitë përgjegjëse: AKSHI, MAS Partnerët: Banka Botërore, CEB, WBIF
Masa C.2.2 – Përmirësimi i aksesueshmërisë së shërbimeve për qytetarët dhe bizneset	C.2.2.a 9 Qendra Rinore të Inovacionit të Ngritura dhe Funksionale. C.2.2.b Kanal i Integruar i Asistencës ndaj qytetarit plotësisht funksional (Omni-Channel contact center). C.2.2.c Asistenti Virtual (AVA) 2.0 funksional dhe sistemi i dedikuar <i>helpdesk</i> funksional për t’iu përgjigjur pyetjeve të përdoruesve.	Njësitë përgjegjëse: AKSHI Banka Botërore
Masa C.2.3 – Përmirësimi i aksesit në shërbimet elektronike për target-grupe të caktuara.	C.2.3.a Direktiva (BE) 2016/2102 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 26 tetor 2016 mbi aksesin në faqet e internetit dhe aplikacionet mobile të institucioneve publike e transpozuar. C.2.3.b Portali <i>e-Albania</i> i përmirësuar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare për aksesueshmërinë e përmbajtjes së web-it (WCAG 2.1). C.2.3.c Standardet Teknike të Aksesueshmërisë bazuar në WCAG të përgatitura dhe miratuara.	Njësitë përgjegjëse: AKSHI
Masa C.2.4 – Forcimi i mundësuesve parësorë të GovTech-ut: Data Governance	C.2.5.a Implementimi i Platformës Qeveritare të Ndërveprimt 2.0 C.2.5.b Shërbime elektronike të përmirësuara me teknologji mikrosërbimi në përputhje me standardet e të dhënave të hapura (open data).	Njësitë përgjegjëse: AKSHI

Masa C.2.5 – Përmirësimi i mundësuesve parësorë të GovTech-ut: Institucionet publike	C.2.6.a Sistemi i Qendëruar i Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik (SQDNE) dhe Moduli i Administratës Publike - të përmirësuar dhe zgjeruar - Rritje në % e shërbimeve elektronike të lidhura me sistemin e përmirësuar të monitorimit SQDNE.	Njësitë përgjegjëse: AKSHI

Qëllimi i Politikës 4: Organizimi, llogaridhënia dhe mbikëqyrja e administratës

Qëllimi i Politikës 4 synon konsolidimin e një administrate publike efikase dhe të përgjegjshme përmes forcimit të strukturave organizative, promovimit të llogaridhënies dhe krijimit të mekanizmave të mbikëqyrjes së brendshme dhe të jashtme. Ky Qëllim fokusohet në menaxhimin e mirë të burimeve njerëzore, transparencën në vendimmarrje dhe fuqizimin e proceseve të llogaridhënies dhe mbikëqyrjes, me qëllim final rritjen e besueshmërisë së qytetareve tek institucionet publike dhe përmirësimin e efikasitetit të administratës.

Qëllimi i Politikës 4 do të arrihet përmes këtyre Objektivave Specifikë:

- 1. Forcimi i organizimit institucional:** Zhvillimi i strukturave organizative të qarta dhe të përshtatshme për të përmbushur detyrat e administratës publike në mënyrë efektive dhe optimale.
- 2. Rritja e llogaridhënies:** Krijimi i mekanizmave për të garantuar llogaridhënien e punonjësve dhe drejtuesve të administratës publike për performancën dhe vendimmarrjen e tyre.
- 3. Transparenca dhe pjesëmarrja publike:** Promovimi i një administrate të hapur që angazhon qytetarët dhe palët e tjera të interesuara në proceset e vendimmarrjes, duke rritur aksesin në informacion dhe duke përmirësuar dialogun ndërmjet administratës dhe publikut.

Kjo shtyllë mbulon komponentet e organizimit të administratës, rritjes së llogaridhënies dhe mbikëqyrjes në administratën publike, harmonizimit të dispozitave të legjislacionit sektorial me dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative, dhe krijimin e institucioneve të administratës publike transparente.

Objektivat e mëposhtëm specifikë dhe masat e renditura për secilin Objektiv do t'i shërbejnë arritjes së këtij Qëllimi të Politikës.

PËRMBLEDHJE E QËLLIMIT TË POLITIKËS 4 – ORGANIZIMI, LLOGARIDHËNIA DHE MBIKËQYRJA E ADMINISTRATËS

Komponenti 4.1 *Mirëorganizimi i administratës publike, me institucione që performojnë mbështetur në kritere të qarta organizative dhe në përputhje me kuadrin ligjor ekzistues.*

OBJEKTIVI SPECIFIK D.1: Zhvillimi i strukturave organizative të qarta dhe të përshtatshme për të përmbushur detyrat e administratës publike në mënyrë efektive dhe efikase.

Masat për vitet 2024-2030:

- **Masa D.1.1** - Rishikimi i ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të administratës shtetërore” dhe përcaktimi i kritereve të qarta për secilën tipologji të institucioneve të varësisë.
- **Masa D.1.2** – Plotësimi i kuadrit rregullator në zbatim të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të administratës shtetërore”, të rishikuar.

Komponenti 4.2 *Rritja e llogaridhënies së brendshme në administratën publike*

Objektivi specifik D.2: Krijimi i mekanizmeve të qartë të brendshëm që garantojnë llogaridhënien e punonjësve dhe drejtuesve të administratës publike për performancën dhe vendimmarrjen e tyre.

Masat për vitet 2024-2030:

- **Masa D.2.1** – Krijimi i një kornize të qartë monitorimi dhe funksionimi të institucioneve të varësisë përmes rishikimit të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të administratës shtetërore”.
- **Masa D.2.2** – Monitorimi i funksionimit të plotë dhe të rregullt të Sistemit të Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik (SQDNE).
- **Masa D.2.3** – Garantimi i ofrimit të të njëjtave standarde cilësie në ofrimin e shërbimeve edhe në nivel vendor.
- **Masa D.2.4** – Harmonizimi i legjislacionit sektorial me dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative, në ofrim të standardeve më të mira për publikun.
- **Masa D.2.5** - Rritja e efikasitetit në zbatimin e Ligjit nr. 107/2021 “Për bashkëqeverisjen”.

Komponenti 4.3 *Institucione publike transparente*

OBJEKTIVI SPECIFIK D.3: Promovimi i një administrate të hapur dhe transparente që angazhon qytetarët dhe palët e tjera të interesuara në proceset e vendimmarrjes, duke rritur aksesin në informacion dhe duke përmirësuar dialogun ndërmjet administratës dhe publikut.

Masat për vitet 2024-2030:

- **Masa D.3.1** - Miratimi i legjislacionit dytësor në zbatim të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”.
- **Masa D.3.2** - Raportimi lidhur me veprimtarinë për zbatimin e kërkesave të kuadrit ligjor për të drejtën e informimit dhe kuadrit ligjor për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik nga institucionet kryesore.
- **Masa D.3.3** - Krijimi i një platforme unike digjitale “Transparent Albania” për ofrimin e informacionit publik dhe që mundëson lidhjen e përdoruesit me faqet e tjera zyrtare.
- **Masa D.3.4** - Nxitja e partneritetit dhe dialogut të vazhdueshëm me organizatat e shoqërisë civile si monitorues të pavarur të transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike.
- **Masa D.3.5** - Zhvillimi i fushatave informuese për edukimin ligjor të qytetarëve mbi të drejtën e tyre për të kërkuar dhe marrë informacion nga institucionet.

Komponenti 4.4 *Fuqizimi i llogaridhënies së jashtme të administratës publike*

Objektivi specifik D.4: Fuqizimi i mbikëqyrjes së jashtme të administratës publike në mënyrë proaktive nga Kuvendi dhe institucionet e pavarura mbi zbatimin e politikave dhe detyrimeve nga ana e qeverisë.

- **Masa D.4.1** - Përmirësimi i dialogut të rregullt institucional mes Kuvendit, Qeverisë dhe institucioneve të pavarura me synim rritjen e adresimit të rekomandimeve të këtyre të fundit për institucionet e administratës publike - Duhet parashikuar nje mase per permiresimin e zbatimeve te rekomandimeve te institucioneve te pavarura te Mekanizmit te Mbiqyrtjes se Zbatimit te Institucioneve te Pavarura (duhet konsultuar me MSHMParlamentin që drejton Mekanizmin).
- **Masa D.4.2** - Fuqizimi i rolit proaktiv të Kuvendit në ushtrimin sistematik të funksionit mbikëqyrës ndaj veprimtarisë së qeverisë, duke rritur përdorimin e instrumenteve të kontrollit nga deputetët (pyetje, interpelanca, seancat e komisioneve hetimore, mocionet, vizitat etj.)
- **Masa D.4.3** - Forcimi i rolit mbikëqyrës të Kuvendit ndaj institucioneve të pavarura.
- **Masa D.4.4** - Zbatimi i kontrollit post-legjislativ nga Kuvendi jo vetëm mbi ligjet e përafuara me acquis-në e BE-së, por edhe në aktet e tjera (si aktet normative që kanë fuqinë e ligjit).
- **Masa D.4.5** - Thellimi proaktiv i mbikëqyrjes së angazhimeve të autoriteteve publike të ndërmarrë në kuadër të procesit të integritetit evropian përmes veprimtarisë dhe rolit të shtuar të Komisionit të Posaçëm Parlamentar mbi Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Shtetin e së Drejtës në zbatimin e tyre.
- **Masa D.4.6** - Fuqizimi i rolit mbikëqyrës së Avokatit të Popullit, përmes rishikimit të ligjit nr. 8454/1999 “Për Avokatin e Popullit” për shfuqizimin e detyrimit për publikimin e raportit vjetor të Avokatit të Popullit vetëm pas paraqitjes së tij në Kuvend.

Komponenti 4.1 Mirëorganizimi i administratës publike, me institucione që performojnë mbështetur në kritere të qarta organizative dhe në përputhje me kuadrin ligjor ekzistues

Objektivi Specifik D.1: Zhvillimi i strukturave organizative të qarta dhe të përshtatshme për të përmbushur detyrat e administratës publike në mënyrë efektive dhe efikase.

Prioritetet

Objektivi afatgjatë në këtë fushë është mirëpërcaktimi i tipologjisë së institucioneve të varësisë dhe shmangia e krijimit të institucioneve që qëndrojnë në kufijtë e dy apo më shumë tipologjive. Kjo sfidë e evidentuar më herët synohet të adresohet përmes rishikimit të kuadrit ligjor dhe përkatësisht ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të administratës shtetërore”, dhe përcaktimin e kritereve të qarta për secilën tipologji të institucioneve të varësisë.

Ky Objektivi Specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme, teksa aktivitetet konkrete për periudhën e parë të zbatimit të SNRAP 2024-2030 mund të gjenden në Planin e Veprimit 2024-2026 (Aneksi nr. 1).

Objektivi Specifik D.1: Zhvillimi i strukturave organizative të qarta dhe të përshtatshme për të përmbushur detyrat e administratës publike në mënyrë efektive dhe efikase.	
Masa D.1.1	Rishikimi i ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me qëllim përcaktimin e kritereve të qarta për secilën tipologji të institucioneve të varësisë.
Masa D.1.2	Plotësimi i kuadrit rregullator në zbatim të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të rishikuar.

Masa	Treguesi	Aktorët bashkëpërgjegjës
Masa D.1.1 - Rishikimi i ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me qëllim përcaktimin e kritereve të sakta për secilën tipologji të institucioneve të varësisë.	D.1.1 Projektligji me ndryshimet ligjore i miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe dërguar në Kuvend.	Njësitë përgjegjëse: DAP
Masa D.1.2 - Plotësimi i kuadrit rregullator në zbatim të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të rishikuar.	D.1.2 Aktet nënligjore janë miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe publikuar në Fletoren Zyrtare.	Njësitë përgjegjëse: DAP

Komponenti 4.2 Rritja e llogaridhënies së brendshme në administratën publike

Objektivi specifik D.2: Krijimi i mekanizmave të qartë të brendshëm që garantojnë llogaridhënien e punonjësve dhe drejtuesve të administratës publike për performancën dhe vendimmarrjen e tyre.

Prioritetet

Qëllimi i politikave në këtë fushë synon krijimin e strukturave eficiente dhe të përgjegjshme të administratës publike, përmes minimizimit të riskut për praktika abuzive dhe shkelje të integritetit. Krahas saktësisë të kritereve për tipologjinë e institucioneve që do të mundësohet përmes rishikimit të ligjit nr. 90/2012, synohet gjithashtu të rritet niveli i llogaridhënies dhe të përmirësohet korniza e monitorimit të ushtruar nga ministrinë përgjegjëse për institucionet përkatëse të varësisë. Rritja e efektivitetit të këtij monitorimi do të realizohet përmes krijimit të një kornize të unifikuar të mbikëqyrjes nga ministrinë e linjës dhe përcaktimit të qartë të modaliteteve dhe procedurave të qarta për metodologjinë dhe periodicitetin e raportimit, si dhe vendosjen e indikatorëve kryesorë të performancës dhe raportimet periodike. Në vijim të ndërhyrjeve ligjore, kjo procedurë do të pilotohet fillimisht në një grup të zgjedhur institucioneve. Pas vlerësimit të rezultateve, kjo qasje do të zgjerohet për t'u zbatuar në të gjitha institucionet e varësisë.

Një aspekt kyç për organizimin, llogaridhënien dhe mbikëqyrjen e administratës është zhvillimi dhe monitorimi i mekanizmave që nxisin përfshirjen gjithëpërfshirëse të qytetarëve në procesin e politikëbërjes. Këto mekanizma garantojnë pjesëmarrjen e qytetarëve në procedurat administrative vendimmarrëse, duke rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e administratës shtetërore. Përmes mekanizmave të posaçëm institucionalë, administrata do të përforcojë përpjekjet për zhvillimin dhe zbatimin e praktikave më të mira, duke siguruar përdorimin e tyre në mënyrë të njëtrajtshme në të gjitha institucionet, me synim garantimin e përfshirjes aktive të çdo qytetari në hartimin dhe zbatimin e politikave.

Me qëllim nxitjen e ndarjes së praktikave më të mira ndërmjet qeverisjes qendrore dhe asaj vendore, masat në këtë shtyllë do të përfshijnë hapa të qartë për bashkëpunim të ndërsjellë në krijimin e kushteve që favorizojnë ndërveprimin ndërmjet Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje (ADB) dhe bashkive, për ndjekjen dhe trajtimin e ankesave të paraqitura në platformën “Shqipëria që duam”. Kjo rritje e bashkëpunimit synon të garantojë që standardet e larta të cilësisë në ofrimin e shërbimeve publike, të vendosura nga institucionet qendrore, të zbatohen në mënyrë të njëtrajtshme edhe nga institucionet vendore.

Gjithashtu, Në zbatim të ligjit nr. 107/2021 “Për bashkëqeverisjen, në zbatim të ligjit nr. 107/2021 “Për bashkëqeverisjen”, çdo qytetar mund të denoncojë korrupsionin nëpërmjet platformës “Shqipëria që Duam”, në rubrikën e dedikuar "Denonco Korrupsionin".

Në drejtim të menaxhimit të procedurave administrative, Kodi i Procedurave Administrative ofron një kuadër modern për trajtimin e akteve administrative dhe përcakton standardet më të larta për mbrojtjen e qytetarëve në proceset administrative. Ministria e Drejtësisë ka hartuar tashmë metodologjinë e harmonizimit të legjislacionit sektorial me dispozitat e Kodit dhe ka përpiluar inventarin e akteve që kërkojnë ndryshim. Në periudhën në vijim mbetet prioritar harmonizimi i 65 akteve të identifikuara nënligjore për të mundësuar që publiku të përfitojë nga një legjislacion i përditësuar dhe modern në këtë fushë.

Ky Objektiv Specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme, teksa aktivitetet konkrete për periudhën e parë të zbatimit të SNRAP 2024-2030 mund të gjenden në Planin e Veprimit 2024-2026 (Aneksi nr. 1).

Objektivi Specifik D.2: Krijimi i mekanizmave të qartë të brendshëm që garantojnë llogaridhënien e punonjësve dhe drejtuesve të administratës publike për performancën dhe vendimmarrjen e tyre.

Masa D.2.1	Krijimi dhe zbatimi i një kornize të qartë monitorimi dhe funksionimi të institucioneve të varësisë, përmes rishikimit të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”.
Masa D.2.2	Monitorimi i funksionimit të plotë dhe të rregullt të Sistemit të Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik (SQDNE).
Masa D.2.3	Garantimi i ofrimit të të njëjtave standarde cilësie në ofrimin e shërbimeve edhe në nivel vendor.
Masa D.2.4	Harmonizimi i legjislacionit sektorial me dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative, në ofrim të standardeve më të mira për publikun.
Masa D.2.5	Rritja e efikasitetit në zbatimin e Ligjit nr. 107/2021 “Për bashkëqeverisjen”.

Masa	Treguesi	Aktorët bashkëpërgjegjës
Masa D.2.1 - Krijimi dhe zbatimi i një kornize të qartë monitorimi dhe funksionimi të institucioneve të varësisë, përmes rishikimit të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”.	<p>D.2.1.a Raportet e monitorimit të hartuara dhe miratuara pas pilotimit të kornizës në 5 sisteme ministrore;</p> <p>D.2.1.b Raportet e monitorimit të hartuara dhe miratuara për të gjitha institucionet e administratës shtetërore.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse: DAP</p>
Masa D.2.2 – Monitorimi i funksionimit të plotë dhe të rregullt të Sistemit të Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik (SQDNE).	<p>D.2.2.a Numri i dokumentave të përpunuara dhe të shkëmbyera brenda afatit të caktuar ligjor.</p> <p>D.2.2.b Numri i aplikimeve të lëvruara në afat.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse: ADB</p> <p>Partnerët: Të gjitha institucionet</p>
Masa D.2.3 – Garantimi i ofrimit të të njëjtave standarde cilësie në ofrimin e shërbimeve edhe në nivel vendor.	<p>D.2.3.a Numri i marrëveshjeve të nënshkruara.</p> <p>D.2.3.b Numri i ankesave të trajtuara dhe numri i raporteve mujore dhe vjetore të përgatitura për vlerësimin e performancës.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse: ADB</p> <p>Partnerët: Bashkitë</p>

	D.2.3.c Numri i seancave të trajnimit të zhvilluara dhe numri i nëpunësve publikë të trajnuar.	
Masa D.2.4 – Harmonizimi i legjislacionit sektorial me dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative, në ofrim të standardeve më të mira për publikun.	D.2.4.a 65 akte të rishikuara nënligjore të miratuara nga Këshilli i Ministrave.	Njësitë përgjegjëse: Të gjitha Ministrinë e
Masa D.2.5 - Rritja e efikasitetit në zbatimin e ligjit nr. 107/2021 “Për bashkëqeverisjen”.	D.2.5.a Numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkruara me bashkitë për trajtimin e ankesave të adresuara në platformën “Shqiperia që Duam”.	Njësitë përgjegjëse: ADB Partnerët: Bashkitë

Komponenti 4.3 *Institucione publike transparente*

Objektivi Specifik D.3: Promovimi i një administrate të hapur dhe transparente që angazhon qytetarët dhe palët e tjera të interesuara në proceset e vendimmarrjes, duke rritur aksesin në informacion dhe duke përmirësuar dialogun ndërmjet administratës dhe publikut.

Prioritetet

Për të përmbushur Objektivin Specifik D.3, autoritetet shqiptare do të fokusohen në disa prioritetet kyçe, të cilat synojnë forcimin e aksesit të publikut në informacion dhe përmirësimin e dialogut midis administratës dhe qytetarëve. Këto prioritetet janë të rëndësishme për krijimin e një administrate publike të hapur dhe llogaridhënëse, që jo vetëm ofron informacionin në mënyrë të shpejtë dhe transparente, por edhe inkurajon një dialog të vazhdueshëm me qytetarët dhe aktorët e tjerë të interesuar.

Në këtë drejtim, përpjekjet nën këtë Objektiv Specifik do të fokusohen veçanërisht në zbatimin efikas të ligjit për të drejtën e informimit nga administrata publike, përmes trajnimeve të dedikuara të nëpunësve mbi këtë ligj me synim respektimin e afateve ligjore dhe përmes konsolidimit të procedurave të qarta për trajtimin e kërkesave për informacion. Gjithashtu, parashikohet zhvillimi i fushatave informuese me qëllim ndërgjegjësimin e qytetarëve rreth të drejtës së tyre për të kërkuar dhe marrë informacion nga institucionet publike.

Në drejtim të garantimit të zbatimit të legjislacionit për të dhënat e hapura, fokusi do të jetë në publikimin e vazhdueshëm nga administrata publike të të dhënave të hapura, lehtësisht të aksesueshme dhe të përditësuara periodikisht. Këto përpjekje synojnë t’u mundësojnë qytetarëve dhe bizneseve të përdorin informacionin publik në mënyrë të lehtë dhe të dobishme përmes platformave digjitale, në përputhje me kuadrin ligjor për të dhënat e hapura.

Gjithashtu, përmes ndërhyrjeve të parashikuara nën këtë Objektiv Specifik, do të promovohet angazhimi i qytetarëve dhe grupeve të interesit në vendimmarrje përmes konsultimeve publike dhe publikimit proaktiv të rezultateve të procesit vendimmarrës, duke mundësuar qasje të gjerë dhe një proces më gjithëpërfshirës për publikun e gjerë. Një tjetër prioritet është edhe krijimi i mekanizmave për mbikëqyrjen dhe llogaridhënien efikase të institucioneve dhe zyrtarëve publikë. Për këtë qëllim, institucionet publike do të fuqizojnë mekanizmat e mbikëqyrjes së brendshme dhe të raportimit, duke përfshirë platforma për ankesat dhe raportime vjetore mbi transparencën. Këto mekanizma do të sigurojnë monitorim të vazhdueshëm dhe llogaridhënie efektive për qytetarët.

Një aleat i fuqishëm në këtë drejtim do të jetë infrastruktura digjitale dhe teknologjia e informacionit, fuqizimi i të cilave do të mundësojë qeverisjen e hapur digjitale përmes platformave që mundësojnë komunikimin interaktiv mes qytetarëve dhe administratës publike. Njëherësh, fokus të veçantë do të ketë investimi për modernizimin e sistemeve të brendshme të menaxhimit të të dhënave, me qëllimin për të siguruar menaxhim efikas të të dhënave dhe akses të shpejtë në informacion në përgjigje të kërkesave të qytetarëve.

Partneriteti i intensifikuar me organizatat e shoqërisë civile mbetet prioritet kyç për realizimin e këtyre synimeve. Institucionet publike do të nxisin në mënyrë proaktive dialog të vazhdueshëm me shoqërinë civile për të identifikuar dhe adresuar sfidat në qasjen dhe përdorimin e informacionit publik, si dhe për rritjen e angazhimit të tyre si monitorues të pavarur të performancës së institucioneve publike konform detyrimeve ligjore në fuqi për transparencën dhe llogaridhënien.

Ky Objektiv Specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme, teksa aktivitetet konkrete për periudhën e parë të zbatimit të SNRAP 2024-2030 mund të gjenden në Planin e Veprimit 2024-2026 (Aneksi nr. 1).

<i>Objektivi Specifik D.3: Promovimi i një administrate të hapur dhe transparente që angazhon qytetarët dhe palët e tjera të interesuara në proceset e vendimmarrjes, duke rritur aksesin në informacion dhe duke përmirësuar dialogun ndërmjet administratës dhe publikut.</i>	
Masa D.3.1	Miratimi i legjislacionit dytësor në zbatim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”.
Masa D.3.2	Forcimi i kapaciteteve të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe të institucioneve të administratës publike për zbatimin efikas të kuadrit ligjor për të drejtën e informimit, të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik nga institucionet kryesore.
Masa D.3.3	Krijimi i një platforme unike digjitale “Transparent Albania” për ofrimin e informacionit publik dhe që mundëson lidhjen e përdoruesit me faqet e tjera zyrtare.
Masa D.3.4	Nxitja e partneritetit dhe dialogut të vazhdueshëm me organizatat e shoqërisë civile si monitorues të pavarur të transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike.
Masa D.3.5	Zhvillimi i fushatave informuese për edukimin ligjor të qytetarëve mbi të drejtën e tyre për të kërkuar dhe marrë informacion nga institucionet.

Masa	Treguesit	Aktorët bashkëpërgjegjës
<p>Masa D.3.1 - Miratimi i legjislacionit dytësor në zbatim të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”.</p>	<p>D.3.1.a 1 format i raportimit të autoriteteve publike lidhur me veprimtarinë për zbatimin e kërkesave të legjislacionit për të drejtën e informimit – i miratuar.</p> <p>D.3.1.b VKM që përcakton masën e shtesës për natyrë të veçantë pune dhe kriteret për përcaktimin e saj për koordinatorët e autoriteteve publike, struktura dhe niveli i pagave të nëpunësve të cilëve përcaktohen nga Këshilli i Ministrave, sipas legjislacionit në fuqi – e miratuar.</p> <p>D.3.1.c Udhëzimi i Përbashkët i Ministrisë përgjegjëse dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mbi modelin për Licencën Standarde të Ripërdorimit të Dokumenteve, i miratuar.</p> <p>D.3.1.d Miratuar në Këshillin e Ministrave 4 aktet nënligjore në zbatim të ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse:</p> <p>Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale</p> <p>Institucionet e përfshira:</p> <p>Këshilli i Ministrave; Ministria për Ekonominë, Kulturën dhe Inovacionin; Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit; Ministrinë e tjera propozuese</p>
<p>Masa D.3.2 - Forcimi i kapaciteteve të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe të institucioneve të administratës publike për zbatimin efikas të kuadrit ligjor për të drejtën e informimit, të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik nga institucionet kryesore.</p>	<p>D.3.2.a 150 Koordinatorë për të Drejtën e Informimit të trajnuar dhe të certifikuar.</p> <p>D.3.2.b 30 menaxherë të Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues të trajnuar dhe të certifikuar.</p> <p>D.3.2.c Trend rritës i numrit të përgjigjeve të dhëna nga autoritetet publike ndaj kërkesave për akses në informacionin publik..</p>	<p>Njësitë përgjegjëse:</p> <p>Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale</p> <p>Partnerët: ASP</p>

<p>Masa D.3.3 - Krijimi i një platforme unike digjitale “Transparent Albania” për ofrimin e informacionit publik dhe që mundëson lidhjen e përdoruesit me faqet e tjera zyrtare.</p>	<p>D.3.3.a Platforma e krijuar dhe seksionet për të adresuar të gjitha nevojat për transparencë proaktive, të parashikuara</p>	<p>Njësitë përgjegjëse: MAPA</p> <p>Partnerët: Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale; Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.</p>
<p>Masa D.3.4 - Nxitja e partneritetit dhe dialogut të vazhdueshëm me organizatat e shoqërisë civile si monitorues të pavarur të transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike.</p>	<p>D.3.4 Trend rritës i numrit të institucioneve publike që raportojnë periodikisht për partneritetin me OSHC-të.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse: Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.</p>
<p>Masa D.3.5 - Zhvillimi i fushatave informuese për edukimin ligjor të qytetarëve mbi të drejtën e tyre për të kërkuar dhe marrë informacion nga institucionet.</p>	<p>D.3.5.a Numri i fushatave të informimit të organizuara në nivel kombëtar dhe lokal.</p> <p>D.3.5.b Trend rritës i numrit të kërkesave për informacion të paraqitura nga qytetarët.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse: Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.</p>

Komponenti 4.4 *Fuqizimi i llogaridhënies së jashtme të administratës publike*

Objektivi specifik D.4: Fuqizimi i mbikëqyrjes së jashtme të administratës publike në mënyrë proaktive nga Kuvendi dhe institucionet e pavarura mbi zbatimin e politikave dhe detyrimeve nga ana e qeverisë.

Kuvendi ka një rol thelbësor në procesin e politikëbërjes dhe mbikëqyrjes së punës së qeverisë. Për të përmirësuar efektivitetin e tij në mbikëqyrje, është e nevojshme që Kuvendi të përdorë të gjithë mekanizmat që ka në dispozicion, si dhe të zhvillojë bashkëpunimin me qeverinë dhe institucionet e pavarura. Në këtë kuadër, Kuvendi duhet të ketë një rol proaktiv dhe të përmirësuar për të monitoruar zbatimin e rekomandimeve të institucioneve të pavarura dhe për të garantuar llogaridhënie të qeverisë.

Prioritetet

Ky Objektivi Specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme, teksa aktivitetet konkrete për periudhën e parë të zbatimit të SNRAP 2024-2030 mund të gjenden në Planin e Veprimit 2024-2026 (Aneksi nr. 1).

Objektivi Specifik D.4: Fuqizimi i mbikëqyrjes së jashtme të administratës publike nga Kuvendi dhe institucionet e pavarura mbi zbatimin e politikave dhe detyrimeve nga ana e qeverisë	
Masa D.4.1	Përmirësimi i dialogut të rregullt institucional mes Kuvendit, Qeverisë dhe institucioneve të pavarura.
Masa D.4.2	Fuqizimi i rolit proaktiv të Kuvendit në ushtrimin sistematik të funksionit mbikëqyrës ndaj veprimtarisë së Qeverisë.
Masa D.4.3	Forcimi i rolit mbikëqyrës të Kuvendit ndaj institucioneve të pavarura.
Masa D.4.4	Zbatimi i kontrollit post-legjislativ nga Kuvendi jo vetëm mbi ligjet e përafuara me acquis-në e BE-së, por edhe mbi aktet e tjera.
Masa D.4.5	Thellimi proaktiv i mbikëqyrjes së angazhimeve të autoriteteve publike të ndërmarra në kuadër të procesit të integritimit evropian nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.
Masa D.4.6	Fuqizimi i rolit mbikëqyrës së Avokatit të Popullit, përmes rishikimit të ligjit nr. 8454/1999 “Për Avokatin e Popullit” për shfuqizimin e detyrimit për publikimin e raportit vjetor të Avokatit të Popullit vetëm pas paraqitjes së tij në Kuvend dhe rishikimin e mandatit.

Masa	Treguesit	Aktorët bashkëpërgjegjës
Masa D.4.1 - Përmirësimi i dialogut të rregullt institucional mes Kuvendit, Qeverisë dhe institucioneve të pavarura përmes Ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin.	<p>D.4.1.a 1 Metodologji më e qartë e hartuar për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura.</p> <p>D.4.1.b Numri i takimeve periodike të organizuara mes Kuvendit, Qeverisë (përmes MSHMP) dhe institucioneve të pavarura mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve.</p> <p>D.4.1.c Përqindja e rekomandimeve të zbatuara të organeve të pavarura.</p> <p>D.4.1.d Numri i seancave dëgjimore në Komisionet përgjegjëse me institucionet e pavarura që adresojnë rekomandime ndaj Qeverisë dhe institucioneve të tjera ekzekutive;</p> <p>D.4.1.e Platforma Ndërinstitucionale virtuale e përditësuar.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse: Kuvendi, Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin</p> <p>Partnerët: Institucionet e pavarura</p>

<p>Masa D.4.2 - Fuqizimi i rolit proaktiv të Kuvendit në ushtrimin sistematik të funksionit mbikëqyrës ndaj veprimtarisë së Qeverisë.</p>	<p>D.4.2 Numri i pyetjeve të paraqitura nga deputetët e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;</p> <p>D.4.2.b Numri i interpelancave;</p> <p>D.4.2.c Numri i mocioneve;</p> <p>D.4.2.d Numri i seancave dëgjimore në komisionet parlamentare me përfaqësues të Qeverisë.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse: Kuvendi</p> <p>Partnerët: Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Institucionet e pavarura, Ministrinë e linjës, Institucionet ekzekutive</p>
<p>Masa D.4.3 - Forcimi i rolit mbikëqyrës të Kuvendit ndaj institucioneve të pavarura.</p>	<p>D.4.3.a Numri i seancave dëgjimore në komisionet parlamentare.</p> <p>D.4.3.b Numri i raporteve vjetore dhe të veçanta të shqyrtuara nga komisionet parlamentare.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse: Kuvendi</p> <p>Partnerët: Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Institucionet e pavarura</p>
<p>Masa D.4.4 - Zbatimi i kontrollit post-legjislativ nga Kuvendi jo vetëm mbi ligjet e përafuara me acquis-në e BE-së, por edhe mbi aktet e tjera.</p>	<p>D.4.3.a Rregullorja e Kuvendit e ndryshuar dhe e zbatuar për sa i përket kontrollit post-legjislativ jo vetëm për ligjet e përafuara me acquis-in e BE-së, por edhe për aktet normative që kanë fuqinë e ligjit.</p> <p>D.4.3.b Metodologjia për kontrollin post-legjislativ e miratuar.</p> <p>D.4.3.c Numri i nëpunësve të Kuvendit të trajnuar për zbatimin e Metodologjisë.</p> <p>D.4.3.d Numri i vlerësimeve post-legjislative të realizuara nga komisionet parlamentare.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse: Kuvendi</p> <p>Partnerët: Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Ministrinë e linjës, Institucionet ekzekutive, Westminster Foundation for Democracy (WFD)</p>

<p>Masa D.4.5 - Thellimi proaktiv i mbikëqyrjes së angazhimeve të autoriteteve publike të ndërmarra në kuadër të procesit të integrimit evropian nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.</p>	<p>D.4.4.a Numri i seancave dëgjimore për kontrollin mbi qeverinë dhe monitorimin e institucioneve të pavarura nga Komisioni për Çështjet Europiane;</p> <p>D.4.5.b Numri i takimeve të Këshillit Kombëtar për Integrimin Evropian sa i përket kontrollit ndaj qeverisë dhe monitorimit të institucioneve të pavarura;</p> <p>D.4.5.c Dokumenti Analitik i miratuar nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar mbi Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Shtetin e së Drejtës;</p>	<p>Njësitë përgjegjëse: Kuvendi</p> <p>Partnerët: Ministritë e linjës, Organizatave e Shoqërisë Civile</p>
<p>Masa D.4.6 - Fuqizimi i rolit mbikëqyrës së Avokatit të Popullit, përmes rishikimit të ligjit nr. 8454/1999 “Për Avokatin e Popullit” për shfuqizimin e detyrimit për publikimin e raportit vjetor të Avokatit të Popullit vetëm pas paraqitjes së tij në Kuvend dhe rishikimin e mandatit.</p>	<p>D.4.6.a Neni 28 i ligjit nr. 8454/1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar.</p> <p>D.4.6.b Raporti vjetor i Avokatit të Popullit i publikuar përpara se Kuvendi të mbaje debat për të.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse Kuvendi, Avokati i Popullit</p>

Qëllimi i Politikës 5: Administrata e gjelbër

Qëllimi i Politikës 5 synon ndërtimin e një administratë publike që ndjek praktika të qëndrueshme mjedisore, duke minimizuar ndikimet negative në mjedis dhe duke promovuar politika dhe nisma të gjelbra. Kjo shtyllë përfshin komponentët e ndërgjegjësimit të punonjësve mbi administratën e gjelbër, si dhe krijimin e një administrate që vepron në harmoni me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.

Një administratë e gjelbër synon optimizimin e përdorimit të burimeve natyrore, reduktimin e ndotjes dhe emetimeve të karbonit, si dhe promovimin e kulturës së qëndrueshmërisë brenda sektorit publik.

Objektivat e mëposhtëm specifikë dhe masat e renditura për secilin objektiv do t'i shërbejnë arritjes së Qëllimit të Politikës.

PËRMBLEDHJE E QËLLIMIT TË POLITIKËS 5 – ADMINISTRATA E GJELBËR

Komponenti 5.1 - Angazhimi i administratës publike drejt dimensionit të gjelbër të veprimtarisë institucionale

OBJEKTIVI SPECIFIK E.1: Rritja e angazhimit të administratës publike mbi dimensionin e gjelbër të veprimtarisë institucionale.

Masat për vitet 2024-2030:

- **Masa E.1.1** - Garantimi i përdorimit efikas të burimeve natyrore në institucionet e administratës publike
- **Masa E.1.2** - Rritja e ndërgjegjësimit dhe njohurive të punonjësve publikë ndaj çështjeve mjedisore dhe ndërtimit të një administrate të gjelbër.

Komponenti 5.2 Partneriteti për administratën e gjelbër

OBJEKTIVI SPECIFIK E.2: Forcimi i partneritetit ndërsektorial për implementimin e nismave të gjelbra në administratën publike.

Masat për vitet 2024-2030:

- **Masa E.2.1** – Rritja e angazhimit komunitar për zbatimin e politikave të gjelbra në administratën publike.
- **Masa E.2.2** – Rritja e bashkëpunimit me administratat në rajon dhe Bashkimin Evropian për ndarjen e praktikave dhe përmirësimin e proceseve të gjelbra administrative.

Komponenti 5.1 Angazhimi i administratës publike drejt dimensionit të gjelbër të veprimtarisë institucionale

Objektivi specifik E.1: Rritja e angazhimit të administratës publike mbi dimensionin e gjelbër të veprimtarisë institucionale

Prioritetet

Mbështetja e rolit të administratës publike në udhëheqjen e përpjekjeve për të promovuar dhe zbatuar reduktimin e emetimeve të karbonit, mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin më të mirë të burimeve natyrore është një prioritet i Qeverisë Shqiptare në zbatimin e agjendës për zhvillim të qëndrueshëm. Veprimet e administratës publike kanë fuqinë të inkurajojnë individët, organizatat dhe bizneset të luajnë rolin e tyre aktiv në avancimin e këtyre përpjekjeve. Zhvillimi i qëndrueshëm dhe krijimi i një administrate të gjelbër publike mund të arrihen suksesshëm vetëm përmes institucioneve të forta, efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet.

Për këtë qëllim, Qeveria Shqiptare ka parashikuar nën këtë Objektiv Specifik një sërë masash për të forcuar angazhimin e administratës publike në promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe reduktimin e ndikimeve mjedisore. Kjo përfshin, ndër të tjera, një vlerësim të thelluar të situatës aktuale në çdo ministri për të identifikuar mundësitë e uljes së konsumit të burimeve natyrore dhe energjisë, dhe ndërmarrjen e masave konkrete që do të kontribuojnë në një administratë të gjelbër.

Në këtë kuadër, është parashikuar që të gjithë funksionarët e administratës të angazhohen aktivisht për të zbatuar masa që përfshijnë uljen e përdorimit të energjisë elektrike dhe të letrës, si dhe promovimin e praktikave të riciklimit brenda institucioneve. Po ashtu, një komponent kyç i kësaj strategjie është inkurajimi i komunikimit elektronik si alternativë për zëvendësimin e komunikimeve fizike, me qëllim uljen e përdorimit të materialeve dhe burimeve të mundshme që ndikojnë në mjedis.

Për të mbështetur këto nisma, do të prioritetizohet një proces trajnimi i vazhdueshëm për të gjithë punonjësit publikë, duke i përgatitur ata për sfidat mjedisore dhe për t'i ndihmuar në krijimin e një administrate të gjelbër, çka përbën gjithashtu një kërkesë për rritjen e përgjegjësisë dhe efikasitetit të administratës publike. Këto masa synojnë jo vetëm përmirësimin e performancës mjedisore të administratës, por gjithashtu krijimin e një kulture të re pune, që inkurajon dhe mbështet veprimet e qëndrueshme dhe inovative për një mjedis më të pastër dhe më të qëndrueshëm.

Ky Objektiv Specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme, teksa aktivitetet konkrete për periudhën e parë të zbatimit të SNRAP 2024-2030 mund të gjenden në Planin e Veprimit 2024-2026 (Aneksi nr. 1).

Objektivi specifik E.1: Rritja e angazhimit të administratës publike mbi dimensionin e gjelbër të veprimitarisë institucionale	
Masa E.1.1	Garantimi i përdorimit efikas të burimeve natyrore në institucionet e administratës publike.
Masa E.1.2	Rritja e ndërgjegjësimit dhe njohurive të punonjësve publikë ndaj çështjeve mjedisore dhe ndërtimit të një administrate të gjelbër.

Masa	Treguesit	Aktorët bashkëpërgjegjës
Masa E.1.1 - Garantimi i përdorimit efikas të burimeve natyrore në institucionet e administratës publike.	<p>E.1.1.a Grupi Ndërinstitucional i Punës për Administratën e Gjelbër Publike i ngritur.</p> <p>E.1.1.b 1 Analizë e kryer për situatën aktuale në institucionet e administratës publike.</p> <p>E.1.1.c 1 Plan Veprimi i hartuar me masa të dedikuara për të ulur nivelet e konsumit të burimeve natyrore në të gjithë sektorët e administratës publike.</p> <p>E.1.1.d 1 Udhëzues për prioritetizimin e komunikimit elektronik si komunikim zyrtar dhe uljen e komunikimeve shkresore me letra fizike i miratuar.</p> <p>E.1.1.e Trend ulës i përdorimit të letrës në institucionet e administratës publike.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse: DAP, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit</p> <p>Partnerët: Të gjitha institucionet e administratës publike</p>
Masa E.1.2 - Rritja e ndërgjegjësimit dhe njohurive të punonjësve publikë	<p>E.1.3.a Identifikimi i Nevojave të Trajnimit i kryer.</p> <p>E.1.3.b Numri i nëpunësve publikë të trajnuar periodikisht mbi administratën e gjelbër.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse: ASPА</p>

ndaj çështjeve mjedisore dhe ndërtimit të një administrate të gjelbër.		Partnerët: Të gjitha institucionet e administratës publike
--	--	--

Komponenti 5.2 Partneriteti për administratën e gjelbër

Objektivi specifik 5.2: Forcimi i partneritetit ndërsektorial për zbatimin e nismave të gjelbra në administratën publike.

Prioritetet

Ky Objektiv Specifik fokusohet në forcimin e partneriteteve ndërsektoriale për implementimin e nismave të gjelbra në administratën publike. Masat e parashikuara synojnë ndërtimin e bashkëpunimit midis administratës publike, sektorit privat, organizatave të shoqërisë civile (OSHC) dhe organizatave ndërkombëtare, me qëllim përshtetjen e integritit të praktikave të qëndrueshme në proceset administrative. Këto partneritete do të ndihmojnë në ndarjen e burimeve dhe eksperiencave më të mira, duke krijuar mundësi për përmirësimin e administratës së gjelbër dhe promovimin e qëndrueshmërisë në shërbimet publike.

Një aspekt kyç i këtij komponenti është angazhimi i komunitetit dhe përfshirja e qytetarëve, bizneseve dhe grupeve të interesit në proceset vendimmarrëse lidhur me politikën e gjelbra. Kjo do të realizohet përmes organizimit të aktiviteteve si ëorkshop-e, konferenca dhe seminare për ndarjen e njohurive dhe praktikave më të mira të administratës së gjelbër. Gjithashtu, do të shpërndahen materiale ndërgjegjësuëse për të rritur informimin dhe mbështetjen e nismave mjedisore.

Për më tepër, rritja e bashkëpunimit me administratat në rajon dhe Bashkimin Evropian do të luajë një rol të rëndësishëm. Kjo përfshin shkëmbimin e praktikave më të mira dhe përmirësimin e proceseve të gjelbra administrative, duke siguruar që administrata publike të adoptojë dhe zbatojë praktika të reja për menaxhimin e burimeve dhe energjisë në mënyrë më efektive dhe të qëndrueshme, veçanërisht në kuadër të rrugës së Shqipërisë drejt Bashkimit Evropian.

Këto masa do të mbështeten nga indikatorë të matshëm si numri i aktiviteteve të organizuara, përfshirja e palëve të interesuara në konsultime dhe përmirësimi i praktikave të gjelbra, për të siguruar që administrata publike të avancojë në rrugën drejt qëndrueshmërisë mjedisore dhe të angazhohet në mënyrë aktive në përbushjen e qëllimeve të saj.

Ky Objektiv Specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme, teksa aktivitetet konkrete për periudhën e parë të zbatimit të SNRAP 2024-2030 mund të gjenden në Planin e Veprimit 2024-2026 (Aneksi nr. 1).

Objektivi Specifik 5.2: Forcimi i partneritetit ndërsektorial për zbatimin e nismave të gjelbra në administratën publike.	
Masa E.2.1	Rritja e angazhimit komunitar për zbatimin e politikave të gjelbra në administratën publike.

Masa E.2.2	Rritja e bashkëpunimit me administratat në rajon dhe Bashkimin Evropian për ndarjen e praktikave dhe përmirësimin e proceseve të gjelbra administrative.
-------------------	--

Masa	Treguesit	Aktorët bashkëpërgjegjës
Masa E.2.1 – Rritja e angazhimit komunitar për zbatimin e politikave të gjelbra në administratën publike.	<p>E.2.1.a Numri i aktiviteteve të organizuara (ëorkshop-e, konferenca, seminare) për ndarjen e njohurive dhe praktikave më të mira të administratës së gjelbër, përfshirë pjesëmarrësit dhe përmbajtjen e temave të trajtuara.</p> <p>E.2.1.b Numri i qytetarëve, bizneseve dhe grupeve të interesit të përfshira aktivisht në proceset vendimmarrëse, konsultimet ose forume publike lidhur me nismat e gjelbra në administratën publike.</p> <p>E.2.1.c Numri i materialeve ndërgjegjësuese të shpërndara.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse:</p> <p>DAP</p> <p>Partnerët:</p> <p>Të gjitha institucionet e administratës publike</p>
Masa E.2.2 - Rritja e bashkëpunimit me administratat në rajon dhe Bashkimin Evropian për ndarjen e praktikave dhe përmirësimin e proceseve të gjelbra administrative.	<p>E.2.2.a Numri i shkëmbimeve ndërkufitare/ndërkombëtare të nëpunësve/institucioneve publike me fokus përmirësimin e praktikave mjedisore në administratën publike.</p> <p>E.2.2.b Numri i praktikave të reja të gjelbra të adoptuara në administratën publike si rezultat i bashkëpunimit me administrata të tjera nga rajoni dhe BE.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse:</p> <p>MAPA</p> <p>Partnerët:</p> <p>Të gjitha institucionet e administratës publike</p>

4. Zbatimi, Llogaridhënia, Monitorimi dhe Analiza

Korniza institucionale ekzistuese për RAP

Korniza institucionale për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2024–2030 përfshin një numër institucionesh bashkëpërgjegjëse të qeverisjes qendrore, të listuara si më poshtë:

- Ministri i Shtetit për Reformën në Administratën Publike dhe Antikorrupsionin;
- Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin;
- Ministria e Drejtësisë;
- Ministria e Brendshme;
- Ministria e Financave;
- Departamenti i Politikës dhe Integritimit Evropian pranë Kryeministrit;
- Departamenti përgjegjës për çështjet rregullatore dhe përputhshmërinë, në Kryeministri;
- Departamenti i Administratës Publike;
- Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës;
- Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje;
- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit;
- Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore;
- Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.

Krahas institucioneve të mësipërme qendrore, edhe një numër institucionesh të pavarura gëzojnë kompetenca dhe përgjegjësi në zbatimin e Strategjisë, ku përfshihen:

- Kuvendi i Republikës së Shqipërisë;
- Avokati i Popullit;
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil;
- Instituti i Statistikave (INSTAT).


Përgjegjësitë institucionale të lidhura me monitorimin dhe raportimin

Përgjegjësitë institucionale për monitorimin dhe raportimin mbi zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2024-2030 do të udhëhiqen nga Departamenti i Administratës Publike (DAP). DAP do të garantojë monitorimin efikas të zbatimit të Strategjisë në nivel teknik, përmes Drejtorisë së Programeve të Reformës në Administratën Publike në rolin e Sekretariatit Teknik në këtë proces.

Institucionet përgjegjëse për çdo masë sipas Objektivave Specifikë dhe Fushave të Politikës janë të përcaktuar në Planin e Veprimit të SNRAP, i cili i bashkëlidhet këtij dokumenti në Aneksin 1. Me qëllim zbatimin efikas të masave të përcaktuara në Strategji dhe në Planin e Veprimit, monitorimi i vazhdueshëm i punës së strukturave të angazhuara është thelbësor për të analizuar situatën përgjatë zbatimit dhe për të përmbushur objektivat në mënyrë efektive.

Në përputhje me VKM Nr. 290, datë 11.4.2020 “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS), i ndryshuar”, fazat për përgatitjen e raporteve të monitorimit do të jenë të mëposhtmet:

MONITORIMI I SNRAP



Institucionet bashkëpërgjegjëse do të raportojnë çdo 6-muaj për realizimin e masave, në zbatim të procedurave të monitorimit në fuqi, në kuadër të Sistemit Informativ për Planifikimin Strategjik të Integruar (IPSIS). Me qëllimin garantimin e cilësisë së të dhënave, përfaqësuesit në Ministrinë e Linjës do të bashkëpunojnë ngushtësisht me përfaqësuesit në nivel rajonal dhe vendor për monitorimin cilësor të progresit të Strategjisë. Në rolin e institucionit udhëheqës për monitorimin e zbatimit të Strategjisë, Departamenti i Administratës Publike do të mbledhë, përpunojë dhe analizojë në Raporte 6-mujore dhe 1-vjeçare Monitorimi të dhënat mbi ecurinë e zbatimit të Strategjisë. Raportet do të vijojnë të publikohen rregullisht për të garantuar transparencë dhe qasje të publikut të gjerë.

Në funksion të planifikimit efikas për periudhën e zbatimit të Strategjisë që pason Planin e Parë të Veprimit 2024-2026, SNRAP do t’i nënshtrohet edhe një procesi vlerësimi afatmesëm, i cili do të evidentojë arritjet e viteve të para të zbatimit të Strategjisë, përmes një metodologjie monitorimi që do të zhvillohet nga DAP. Vlerësimi do të shërbejë për përcaktimin e një Plani të qartë dhe të përshtatshëm të aktiviteteve për zbatim, si dhe për vlerësimin e nevojave financiare për zbatimin e Strategjisë për periudhën vijuese 2027-2030, në përputhje me Programin Buxhetor Afatmesëm.

5. Financimi i Strategjisë

Procesi i financimit të Strategjisë do të kryhet në bashkëpunim me të gjitha institucionet e përfshira në procesin e hartimit të këtij dokumenti, si edhe të Planit të Veprimit. Financimi përfshin të gjitha aktiviteteve që mbulohen përmes buxhetit të shtetit, financimet nga donatorë të huaj (aktuale apo të planifikuara) si edhe nxjerr në pah boshllëqet financiare për të cilat institucionet duhet të marrin masa për t’i mbuluar.

Përgjatë procesit të hartimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit, institucionet janë udhëzuar paraprakisht lidhur me rëndësinë e mbulimit të kostove financiare për secilin aktivitet, duke konsideruar si burimet e tyre të brendshme financiare, përfshirë këtu kostot kryesisht të natyrës administrative ose në investime, ashtu edhe projektet e financuara nga donatorë të huaj apo ato që priten të nisin, për të siguruar qendrueshmërinë financiare të të gjitha aktiviteteve të propozuara.